
**ANALIZA BUXHETORE-GJINORE E MBROJTJES SOCIALE
DHE E POLITIKAVE AKTIVE PËR PUNËSIM
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

Botues



Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
Rr. "Dame Gruev" nr. 14–1000 Shkup
Tel/faks 02 3129-308
www.mtsp.gov.mk
egrozdanova@mtsp.gov.mk

Botimi është realizuar me punë të përbashkët të katër eksperteve.

Ekipi i autorëve (sipas alfabetit)

Prof. dr. Amalija Jovanović
Vesna Jovanova
Neda Maleska–Saçmaroska
Prof. dr. Slobodanka Markovska


Koordinatorë e ekipit të autorëve Neda Maleska–Saçmaroska

Ky botim u përgatit me përkrahje të Fondit zhvillues për gra, pranë Kombeve të Bashkuara (UNIFEM), në kuadër të Programit nën-rajonal "Buxhetim gjinor përgjegjës në Evropën Juglindore: Avancimi i barazisë gjinore dhe sundimi demokratik, nëpërmjet transparencës dhe përgjegjësisë më të madhe". Programi u implementua me përkrahjen financiare të Bashkëpunimit Zhvillues Austriak.

Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë botim i paraqesin mendimet dhe qëndrimet e autorëve dhe të njëjtat nuk i paraqesin mendimet dhe qëndrimet e UNIFEM-it, Kombeve të Bashkuara, Bashkëpunimit Zhvillues Austriak ose organizatave të tjera shoqëruese.



financed by

Austrian
 Development Cooperation

Përgatitja dhe shtypja e këtij botimi është pjesë e projektit "Buxhetimi gjinor përgjegjës". Ky projekt është realizuar nga ana e Ministrisë së punës dhe politikës sociale–Sektori për mundësi të barabarta.

Ministria e punës dhe politikës sociale, Sektori për mundësi të barabarta, nga janari i vitit 2009 filloi me realizimin e programit njëvjeçar, i orientuar ndaj promovimit dhe implementimit të perspektivës gjinore në politikat dhe në proceset dhe politikat buxhetore. Programi është i përkrahur nga Fondi zhvillues për gra, pranë Kombeve të Bashkuara (UNIFEM), në kuadër të programit rajonal për Buxhetim gjinor, i financuar nga Bashkëpunimi Austriak Zhvillues.

Promovimi i buxhetimit gjinor si vegël për avancim të barazisë gjinore, është një nga rekomandimet e Komisionit Evropian, i propozuar në Rezolutën e Konferencës së 6-të evropiane të ministrave (2006) dhe i paraparë në Kartën për barazi gjinore 2006-2010.

Atë që dua ta theksoj është se çështja e barazisë dhe implementimit të perspektivave gjinore në rrjedhat kryesore, nuk është vetëm çështje e të drejtës sociale, por është çështje tepër e rëndësishme në luftimin e varfërisë dhe papunësisë, në sigurimin e mundësive të barabarta dhe të jetës kualitative për të gjithë.

Nga e sipërpërmendura del nevoja që të vërehet se sigurimi i barazisë gjinore më të madhe dhe ballafaqimi me pabarazitë ekzistuese, shumë shpesh nënkupton të punohet në mënyrë të ndryshme me gratë dhe burrat, të dallohen pengesat e ndryshme me të cilat ato ballafaqohen, por edhe nevojat, prioritetet dhe aspiratat e ndryshme.

Analiza e politikave dhe buxheteve nga aspekti gjinor, do t'u jap një dimension të ri kreatorëve të politikave në proceset e planifikimit, dimension i cili është i drejtuar jo vetëm drejt pabarazisë gjinore si pasojë, por do t'i identifikoj dhe do t'i adresoj shkaqet dhe proceset të cilët e krijuan këtë politikë.

Analizë e tillë duhet të na ndihmoj të kuptojmë se efektet dhe implikimet e politikave dhe programeve janë të ndryshme për grupe të ndryshme, ndërsa me qëllim që të sigurohen mundësi të njëjta për të gjithë përdoruesit përfundimtarë, intervenimet duhet t'i njohin këto dallime që në procesin e planifikimit të vet politikave dhe buxheteve.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, nëpërmjet Ministrisë së punës dhe politikës sociale, duke iu përkushtuar këtij koncepti, tregon vullnet politik dhe gatishmëri për avancimin e barazisë gjinore dhe përmirësimin e pozitës së grave.

Prandaj, analiza gjinore e buxheteve do t'i ndihmoj Qeverisë së Republikës së Maqedonisë të vendos rreth mënyrës me të cilën vendimet politike do t'i orientoj drejt arritjes së ndikimit maksimal dhe si duhet të ndahen resurset, që të arrihet nivel më i lart i zhvillimit njerëzor dhe barazisë gjinore. Nëpërmjet realizimit të këtij aktiviteti, Ministria e punës dhe politikës sociale do të kontribuoj për transparencë akoma më të madhe në punën e saj, para të gjithë qytetarëve.

Në përgatitjen e analizës morën pjesë: një ekspert ndërkombëtar, përvojën e të cilit e kanë shfrytëzuar shumica e vendeve anëtare të BE-së dhe vendet e rajonit, katër ekspertë vendas dhe përfaqësues të Ministrisë së punës dhe politikës sociale nga sektori për mundësi të barabarta, sektori për mbrojtje sociale, sektori për financim dhe buxhetim dhe sektori i punës.

Qëllimet specifike të këtij programi kanë për synim ta ngrenë vetëdijen lidhur me ndikimet gjinore të politikave dhe alokacionet buxhetore adekuate, theksimin e diferencës midis alokacioneve politike dhe buxhetore, obligimin e ministrive të jenë përgjegjëse lidhur me përcaktimet e tyre për barazinë gjinore dhe ndryshimet në politikat dhe buxhetet, gjë që mund të ndihmoj në avancimin e statusit të grave, si dhe në arritjen e barazisë gjinore.

Qëllimi i këtij programi është që të iniciohet procesi i implementimit të perspektivës gjinore në politikat buxhetore në nivel nacional, shpërndarja përgjegjëse e mjeteve financiare në mënyrë të drejtë dhe sipas aspektit gjinor, si dhe transparenca dhe përgjegjësia më e madhe të buxhetit qeveritar nga aspekti i barazisë gjinore.

Një nga rezultatet të cilin duam ta arrijmë me realizimin e këtij programi është përfshirja e aspekteve të buxhetimit gjinor në Cirkularin Buxhetor, të përgatitur nga ana e Ministrisë së financave për përgatitjet e buxhetit, cirkular i cili dorëzohet në të gjitha ministrinë dhe institucionet qeveritare.

Duke i ndjekur rekomandimet e Komisionit Evropian, të OKB-së dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare, Republika e Maqedonisë, me realizimin e aktiviteteve në kuadër të këtij programi, është vendi i parë në rajon i cili i zbaton aktivitetet e tilla në nivel nacional. Vendet e rajonit kanë ndërmarrë iniciativa për buxhetim gjinor, por ato iniciativa kryesisht realizohen në nivel lokal ose rajonal.

Së fundi, më lejoni t'u falënderohem UNIFEM-it dhe Agjencisë austriake për zhvillim, për përkrahjen e tyre financiare dhe ndihmën profesionale në realizimin e aktiviteteve për promovim të konceptit të buxhetimit gjinor dhe në përgatitjen e analizës.

Ministri

Xhelal Bajrami

PERMBAJTJA

SHKURTESA.....	6
PËRMBLEDHJE	7
HYRJJE.....	9
1. PËRFSHIRJA E BARAZISË GJINORE NË RRJEDHAT KRYESORE	10
1.1 POLITIKA DHE PRAKTIKA.....	10
1.2 BUXHETIMI GJINOR	11
1.3 PËRVOJA TË BUXHETIMIT GJINOR SENSITIV NË BOTË.....	13
2. KONTEKSTI SOCIAL DHE EKONOMIK NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË	14
3. AKSESI METODOLOGJIK	17
4. MBROJTJA SOCIALE	18
4.1 PËRSHKRIMI I TË DREJTËS SË NDIHMËS SË VAZHDUESHME NË TË HOLLA.....	22
4.2 E DREJTA E NDIHMËS SOCIALE NË TË HOLLA.....	28
5. POLITIKA AKTIVE PËR PUNËSIM	35
5.1 PROGRAMI PËR VETPUNËSIM.....	40
5.2 FORMALIZIMI I BIZNESEVE EKZISTUESE.....	50
5.3 PROGRAMI PËR SUBVENCIONIM TË PUNËSIMIT	56
5.4 PROGRAMI PËR PËRGATITJE PËR PUNËSIM.....	65
PËRMBLEDHJE TË KONSTATIMEVE, KONKLUZIONEVE DHE REKOMANDIMEVE KRYESORE.....	70
BIBLIOGRAFI.....	73

SHKURTESA

APRM	Agjencia e punësimit e Republikës së Maqedonisë
PAP	Politikat aktive për punësim
PAPTP	Politika aktive për punësim në tregun e punës
APSRM	Agjencia për përkrahje të sipërmarrjes në Republikën e Maqedonisë
AFP	Anketa e fuqisë punëtore
PVB	Prodhimi vendas bruto
ESHS	Enti shtetëror i statistikave
GTZ	Bashkëpunimi teknik gjerman
EVROSTAT	Byro evropiane për statistika-Luksemburg
KESKB	Këshilli ekonomik-social i Kombeve të Bashkuara
FSE	Fondi social evropian
SEP	Strategjia evropiane për punësim
BE	Bashkimi Evropian
EVS	Enti për veprimtari sociale
IPA	Instrument për ndihmë para anëtarësimit
KARDS	Ndihma e bashkësisë për rekonstruksion, zhvillim dhe stabilizim
ONP	Organizata ndërkombëtare e punës
MASH	Ministria e arsimit dhe shkencës
MPPS	Ministria e punës dhe politikës sociale
PNA	Plani nacional aksionar
PNAP	Plani nacional aksionar për punësim
OJQ	Organizata joqeveritare
KMP	Këshilli mbikëqyrës i projektit
NPAA	Plani nacional për miratim të të drejtës së Bashkimit Evropian (Acquis)
PNABGJ	Plani nacional aksionar për barazi gjinore
SNP	Strategjia nacionale për punësim
POZHRNJ	Programi operativ për zhvillim të resurseve njerëzore
IBGJ	Iniciativa buxhetore gjinore
UNIFEM	Fondi i Kombeve të Bashkuara për gra
UNDP	Fondi zhvillues i Kombeve të Bashkuara
RQ	Regjistri Qendror
QPS	Qendra e punëve sociale
QATP	Qendra për arsimim dhe trajnim profesional

Analiza gjinore-buxhetore e politikave aktive për punësim dhe mbrojtja sociale, si pjesë e projektit të parë pilot për buxhetim gjinor, që e realizon MPPS në nivel nacional, është e inspiruar me qëllim që të përcaktohet niveli i përfshirjes së aspekteve gjinore në politikat aktive për punësim dhe në mbrojtjen sociale, si dhe ndikimi i tyre në buxhetet.

Zgjedhja për analizim të një pjese të politikave për punësim (vetëpunësimi, formalizimi i bizneseve ekzistuese, subvencionimi i punësimit dhe përgatitja për punësim) dhe një pjese të të drejtave të përdoruesve të ndihmës sociale (ndihma e vazhdueshme financiare dhe ndihma sociale financiare) është bërë në bazë të prioritetëve, të cilat e përfshijnë dimensionin gjinor, vlerësimin të nivelit të aksesit deri tek të dhënat dhe kompatibilitetin të programeve, kohës dhe resurseve ekzistuese.

Nga aspekti metodologjik, politikat analizohen në katër nivele: në nivelin e përgatitjes dhe sjelljes së akteve, në nivelin e proceseve të implementimit, në nivelin e përfshirjes së përdoruesve dhe në nivelin e vëzhgimit dhe vlerësimin të programeve.

Për arritje të qëllimeve dhe politikave të caktuara, u analizuan politikat e definuara në dokumente të veçanta strategjike, programe të cilët dalin nga ligjet e sjella, plane aksionare, programe operative dhe në buxhetet që janë pjesë të këtyre politikave, për një periudhë 2-vjeçare, me qëllim që të konstatohet sa dhe si janë përfshirë çështjet gjinore në të njëjtat. Analiza e të dhënave është plotësuar me shumë intervista me persona të institucioneve kompetente.

Pyetjet kryesore për të cilët dëshironim të fitonim përgjigje ishin: a janë programet të arritshme në mënyrë të barabartë për burrat dhe për gratë dhe a i plotësojnë ato qëllimet për të cilat janë dedikuar; cilat janë përfitimet, efektet dhe ndikimi i programeve për burrat dhe për gratë, duke i marrë parasysh edhe karakteristikat e tjera, siç janë: përkatësia etnike, mosha, vendbanimi; në cilën mënyrë mund të arrihet avancimi i politikave dhe programeve nga aspekti i implementimit të perspektivës gjinore dhe cilat janë mekanizmat nëpërmjet të cilave mund të arrihet ky avancim, si është shpërndarja e buxheteve në krahasim me përdoruesit e tyre, burrat dhe gratë.

Vështirësia kryesore me të cilën u ballafaquan ekspertët gjatë analizës ishte grumbullimi i të dhënave. Metodologjia e ndryshme e grumbullimit të të dhënave midis institucioneve kryesore të obliguara për evidentimin e përdoruesve të këtyre politikave, si dhe mungesa e statistikave të ndara sipas gjinive, akoma paraqesin problem i madh dhe pa to nuk është e mundur të bëhet vlerësimi i ndikimeve të politikave dhe programeve nga aspekti gjinor. Vështirësi plotësuese paraqiste edhe numri i vogël i hulumtimeve dhe vlerësimeve për efektet nga realizimi i politikave, të cilat do t'i merrnin parasysh aspektet gjinore.

Konstatimet që dolën nga analiza janë shoqëruar me rekomandime, se si të avancohen përpjekjet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për avancim të mëtejshëm të suksesshëm të perspektivës gjinore, në krijimin ose implementimin e politikave, me qëllim që të arrihet barazi thelbësore midis burrave dhe grave.

Është evidente se Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe të gjitha institucionet relevante, të përfshira në procesin e krijimit dhe implementimit të politikave aktive për punësim dhe programeve për mbrojtje sociale, demonstrojnë vullnet politik, mirëkuptim dhe gatishmëri për përfshirje të grupeve të ndryshme të kategorive sociale dhe përdoruesve të tregut të punës, në mënyrë e cila do të ndikoj në zvogëlimin e

varfërisë, papunësisë, në sigurimin e kohezionit më të madh social dhe në jetesën më të mirë dhe më kualitative për të gjithë.

MPPS, Sektori për mundësi të barabarta, në drejtim të përkrahjes së politikave, të cilat do ta avancojnë barazinë gjinore, demonstroi gatishmëri të bëjë analizë buxhetore gjinore të politikave (politikat aktive për punësim dhe ndihma sociale) dhe buxheteve të tyre, si hap i parë i një aksesit sistematik drejt çështjeve për barazi dhe për mundësi të njëjta për burrat dhe gratë.

Megjithatë, në bazë të analizës buxhetore-gjinore të politikave aktive për punësim, mund të konstatojmë se ekzistojnë dallime të konsiderueshme midis planeve strategjike ambicioze dhe zbatimit të tyre operativ, lidhur me çështjet gjinore dhe prandaj nuk mund ta konfirmojmë sensibilizimin gjinor të masave. Aksesit gjinor është i rastësishëm dhe i njëjti nuk është i përkrahur me masa dhe mekanizma plotësuese, duke i përfshirë edhe ato programe në të cilat gratë janë përcaktuar si grup specifik qëllimor.

Në mungesë të kriterëve thelbësorë, masave inkurajuese dhe mekanizmave të tjera për përkrahje dhe përfshirje të grupit të caktuar të përdoruesve (të rriturit, gratë e papunësuara për një afat më të gjatë kohor, gratë e bashkësive etnike, të rinjtë etj.), politikat aktive për punësim nuk do t'i arrijnë qëllimet e dëshiruara, të përcaktuara në dokumentet strategjike.

Për sa i përket ndihmës sociale, e cila paraqet aspekt shumë i rëndësishëm në sistemin e mbrojtjes sociale, nëpërmjet të cilës shteti e shpreh kujdesin dhe ndihmën për kategoritë më të rrezikuara të qytetarëve, nuk janë marrë parasysh në mënyrë të mjaftueshme prioritetet dhe interesat e ndryshme midis grave dhe burrave, të cilat kanë implikime të thella në statusin social të qytetarëve.

Prandaj, sugjerohet që proceset e planifikimit dhe implementimit të politikave, strategjitë dhe analizat, si dhe mekanizmat për vëzhgimin dhe vlerësimin e tyre të mos jenë neutrale nga aspekti gjinor. Nevojitet që ato të përmbajnë të dhëna statistikore të ndara sipas gjinive dhe të dhëna të kryqëzuara sipas parametrave të ndryshëm, duke i përfshirë edhe informatat analitike-gjinore, të cilat i sqarojnë dallimet statistikore. Të ndara dhe të kryqëzuara në këtë mënyrë, të dhënat statistikore duhet të jenë rutinë e çdo iniciative qeveritare.

Gjithashtu, institucionet kompetente në të ardhmen duhet të krijojnë metodologji të cilat do të jenë në favor të qëllimeve dhe të grupeve qëllimore, si dhe të gjejnë mënyra për implementimin e mekanizmave, të cilat do t'u mundësojnë akses më të lehtë grupeve qëllimore në masat. Nga aspekti i përfshirjes së çështjeve gjinore në politikat për punësim, ato nuk duhet të jenë restriktive, por duhet të jenë të hapura për të gjithë qytetarët dhe në veçanti për qytetarët joaktivë, nëpërmjet implementimit të aktiviteteve për inkurajim dhe përfshirje, sidomos të grave, në tregun e punës. Në procesin e krijimit, implementimit dhe ndjekjes së politikave aktive për punësim, me rëndësi të veçantë është diskriminimi i dyfishtë dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen gratë nga rajonet rurale në tregun e punës, si dhe gratë e grupeve të caktuara etnike.

Duke e pasur parasysh faktin se politikat aktive për punësim në masë të madhe duhet t'u sigurojnë integrim sa më të shpejtë në tregun e punës edhe përdoruesve të ndihmës sociale në të holla, nevojitet bashkëpunim dhe koordinim më i madh midis të gjitha institucioneve kompetente që janë përfshirë në këtë proces, me qëllim që të sigurohet akses i balancuar për angazhim në punë të grave dhe burrave. Aktorët e inkuadruar në krijimin, zbatimin dhe vlerësimin e efekteve të politikave për ndihmë sociale, dhe në veçanti punonjësit e QPS, të cilët në mënyrë direkte punojnë me përdoruesit aktual dhe potencial të ndihmës së vazhdueshme në të holla, duhet të jenë

tepër të ndjeshëm rreth çështjeve gjinore, në secilën nga gjashtë kategoritë e ndryshme të përdoruesve. Në këtë drejtim, nevojitet trajnim të kuadrove, i cili do t'u përkushtohet nevojave specifike gjinore, me qëllim që të sigurohet akses i njëjtë në shërbimet dhe respektim të integritetit të të gjithë përdoruesve.

Është e dukshme nevoja për hulumtime të mëtejshme për vëzhgim të rezistimit të bizneseve të legalizuara dhe për hulumtime të veçanta për shkaqet që e mundësojnë ose e vështirësojnë rezistimin e biznesit në një afat më të gjatë kohor ose për zgjidhje të përhershme të papunësisë. Hulumtimet duhet të përfshijnë edhe vlerësime për efektet dhe ndikimet e politikave, strategjive dhe programeve ndaj burrave dhe grave, grupeve etnike dhe sociale, të rinjve dhe kategorive të tjera të përdoruesve sipas gjinisë, si dhe hulumtime të mëtejshme në sferën e efekteve nga zbatimi i politikave në sferën e ndihmës sociale.

Së fundi, nevojitet që buxheti gjinor të bëhet pjesë kryesore e planifikimit, implementimit dhe ndjekjes së politikave dhe strategjive të shtetit, nëpërmjet analizës solide të shpërndarjes së mjeteve financiare, në mënyrë e cila do të mundësojë që shpërndarja e mjeteve buxhetore të jetë e barabartë dhe t'u përgjigjet nevojave të kategorive të ndryshme të përdoruesve.

HYRJE

Analiza buxhetore-gjinore e politikave aktive për punësim dhe mbrojtja sociale paraqet pjesë e projektit të parë pilot për buxhetim gjinor në nivel nacional, të iniciuar nga Ministria e punës dhe politikës sociale dhe e njëjta është rezultat i përpjekjeve të Qeverisë së RM për përmirësim të efektivitetit të politikave dhe aktiviteteve për avancim të barazisë gjinore. Bëhet fjalë për detyra të cilat rrjedhin nga Kushtetuta e RM, Ligji për mundësi të barabarta të grave dhe burrave dhe nga Plani nacional aksionar për barazi gjinore 2007-2012 (PNABGJ), të cilat janë kompatible me parimet dhe përpjekjet ndërkombëtare për respektim të të drejtave njerëzore dhe janë formalizuar në më shumë dokumente obliguese. Barazia midis burrave dhe grave është pjesë e korpusit të të drejtave të njeriut dhe ka të bëjë me trajtimin e njëjtë nga aspekti i të drejtave të përcaktuara me legjislacionin dhe politikat, por edhe nga aspekti i sigurimit të qasjes së barabartë në mundësitë dhe përfitimet e shoqërisë.

Me këtë projekt pilot, Republika e Maqedonisë i bashkëngjitet familjes me më shumë se 60 vende në botë, të cilat e kanë filluar procesin e buxhetimit gjinor, në rrugën drejt sigurimit të mundësive të barabarta të qytetarëve dhe qytetareve të tyre. Duhet nënvizuar se ne e ndajmë historinë me pjesën më të madhe të vendeve të botës, ku hapat e para të iniciativave buxhetore gjinore i kanë ndërmarrë organizatat joqeveritare.

Analiza jonë, e cila ka të bëjë me politikat aktive lidhur me punësimin dhe me një pjesë të kategorive të të drejtave të përdoruesve nga sfera e ndihmës sociale, është vetëm një nga hapat të cilat duhet të ndihmojnë në procesin e gjatë të buxhetimit gjinor, për realizimin e të cilit nevojitet pjesëmarrja e një numri të madh të subjekteve të sektorit qeveritar dhe joqeveritar.

1. PËRFSHIRJA E BARAZISË GJINORE NË RRJEDHAT KRYESORE

1.1 POLITIKA DHE PRAKTIKA

Buxhetimi gjinor, si vegël relativisht e re, paraqet pjesë e *strategjisë për përfshirje të perspektivës gjinore në rrjedhat, politikat dhe praktikat kryesore, të orientuara drejt arritjes së barazisë gjinore (gender mainstreaming)*.

Ky aspekt strategjik për arritje të barazisë gjinore, për herë të parë është përmendur në Konferencën e tretë botërore të Kombeve të Bashkuara për gratë (e mbajtur në Najrobi, në vitin 1985). Një vit më vonë vijoi miratimi i Rezolutës për punën e Komisionit të Kombeve të Bashkuara për statusin e grave, e cila në vitin 1987 u bëri thirrje të gjithë trupave, në sistemin e Kombeve të Bashkuara, të përgatisin dhe të realizojnë në praktikë një politikë gjithëpërfshirëse për barazi të grave dhe të njëjtën ta implementojnë në planet e tyre afatmesme. Në realitet, kjo strategji fitoi rëndësi të madhe dhe u pranua në nivel global pas mbajtjes së Konferencës së katërt botërore të Kombeve të Bashkuara për gratë (e mbajtur në Peking, në vitin 1995). Në platformën për aksion thirren Qeveritë dhe faktorët e tjerë “të promovojnë politikë aktive dhe të dukshme të përfshirjes së *barazisë gjinore në rrjedhat, politikat dhe praktikat kryesore*, kështu që, para se të sillen vendimet, të bëhet analiza e efekteve ndaj burrave dhe grave”.

Për t’u kuptuar thelbi i kësaj strategjie, nevojitet një sqarim i shkurtër i kategorisë gjini, e cila si mjet analitik në disiplinat shoqërore i përfshin relacionet sociale midis burrave dhe grave.

Gjinia ka të bëjë me identitetet e ndryshme, rolet, përgjegjësitë dhe marrëdhëniet midis burrave dhe grave, të cilët janë krijuar në shoqëri dhe për të cilët shoqëria konsideron se janë adekuate për burrat dhe gratë. Në dallim nga dallimet biologjike, dallimet në gjini, me kalimin e kohës, ndryshohen dhe varen nga një shoqëri në një shoqëri tjetër.

Këto relacione në masë të madhe i përcaktojnë nevojat, interesat dhe prioritetet e ndryshme të burrave dhe grave në sferën ekonomike, politike dhe sociale në shoqëri.

Ky model vëren se dallohen nevoja dhe prioritetet e caktuara të burrave dhe grave dhe se të njëjtat duhet të trajtohen në mënyrë të ndryshme, që të kenë përfitim të njëjtë.

Nga këto arsye, gjithnjë e më shumë, anashkalohet bindja se programet e veçanta për përkrahje të grave mjaftojnë që të tejkalohen pabarazitë që ekzistojnë në shoqëri dhe të implementohen strategji për përfshirje të *perspektivës gjinore në rrjedhat kryesore të shoqërisë (gender mainstreaming)*.

Në këtë drejtim, në vitin 1997, Këshilli ekonomik-social i Kombeve të Bashkuara (ECOSOC) e përcaktoi përfshirjen e *perspektivës gjinore në rrjedhat kryesore të shoqërisë (gender mainstreaming)*, si “proces i cili do t’i adresoj pasojat ndaj burrave dhe grave nga çdo aksion i planifikuar, duke i përfshirë legjislativonin, politikat ose programet në çdo sferë dhe në të gjitha nivelet”.

Megjithatë, përkufizimi më i përdorur dhe më i pranuar është ai i Këshillit të Evropës (viti 1998) i cili thotë se: “përfshirja e perspektivës gjinore në rrjedhat kryesore

(gender mainstreaming) paraqet (ri)organizim, përmirësim, zhvillim dhe vlerësim të politikave të përgjithshme, strategjive dhe programeve, me qëllim që perspektiva gjinore të përfshihet në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat, nga ana e aktorëve të përfshirë në krijimin e këtyre politikave”.

Në dallim nga përkufizimet e tjera, ky përkufizim e thekson barazinë gjinore si qëllim, ndërsa përfshirjen e perspektivës gjinore në rrjedhat kryesore e thekson si strategji.

Në thelb, përfshirja e perspektivës gjinore në rrjedhat kryesore (gender mainstreaming) ka për qëllim që nevojat dhe eksperiencat e burrave dhe grave të bëhen pjesë përbërëse gjatë konceptimit, realizimit, mbikëqyrjes dhe vlerësimit të të gjitha politikave dhe programeve në të gjitha sferat, me qëllim që gratë dhe burrat të kenë përfitim të barabartë. Prandaj, kjo strategji punon në drejtim të arritjes së drejtësisë dhe demokracisë sociale, si dhe të zhvillimit të drejtë dhe stabil.

Në këtë drejtim është edhe Plani nacional aksionar për barazi gjinore, si dokument strategjik i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, i orientuar drejt promovimit dhe sigurimit të barazisë gjinore dhe përfshirjes së saj në politikat, programet dhe projektet në sferat e ndryshme të veprimit shoqëror, në nivel nacional dhe lokal. Në këtë plan janë definuar dhjetë sferat strategjike, midis të cilave janë: gruaja dhe mbrojtja sociale, nëpërmjet masave për zvogëlim të varfërisë dhe zhvillimit të sistemit adekuat për mbrojtje sociale (sfera e katërt strategjike) dhe gruaja dhe punësimi, nëpërmjet përkrahjes dhe zbatimit të programeve për forcim ekonomik të grave (sfera e gjashtë strategjike) ¹.

Me rëndësi të veçantë është edhe Ligji për mundësi të barabarta, qëllimi i të cilit është promovimi i parimit për sigurim të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në sferën politike, ekonomike, sociale, në sferën e arsimit, si dhe në sferat e tjera të jetës shoqërore. Ky ligj e mundëson bazën për implementim të masave kryesore dhe të veçanta, si dhe të masave inkurajuese për inkurajim dhe realizim të parimit për mundësi të barabarta.²

1.2 BUXHETIMI GJINOR

Buxheti është instrumenti më i rëndësishëm i Qeverisë dhe paraqet vegël më e fuqishme në transformimin e shoqërisë, qëllimi i të cilës është që t'u përgjigjet nevojave të grupeve të ndryshme.

Me rëndësi të veçantë është të nënvizohet se buxhetet publike nuk janë vetëm vegël ekonomike, por ato i përmbledhin politikat qeveritare në terma monetare dhe i reflektojnë prioritetet e qeverive. Për këto arsye buxhetet nuk janë neutrale nga aspekti gjinor. Ato ndikojnë ndaj burrave dhe grave në mënyra të ndryshme, e reflektojnë shpërndarjen jo të drejtë të fuqisë në shoqëri, dallimet sociale dhe ekonomike dhe rolet e ndryshme sociale.

Nuk duhet anashkaluar fakti se politikat buxhetore mund të kenë dallime të rëndësishme lidhur me ndikimin ndaj burrave dhe grave, si dhe ndaj grupeve të ndryshme të burrave dhe grave. Ndonjëherë, këto dallime do të arsyetohen me shpjegimin se politikat dhe qëllimet e caktuara duhen arritur, pa dallim të ndikimit të tyre social dhe ekonomik ndaj këtyre grupeve.

Megjithatë, të anashkalohet fakti se politikat kanë ndikim të ndryshëm ndaj

1 Plani nacional për aksion për barazi gjinore, 2007-2012, Shkup, maj 2007

2 Ligji për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 66/06

burrave dhe grave në shoqëri, më shumë është në kufi me "verbërinë për çështjet gjinore" sesa me "neutralitetin" ndaj këtyre çështjeve.

Praktikat e mira paraqesin mirëkuptim për ndikimin e politikave dhe mënyrat në të cilat ato mund të formulohen më mirë, me qëllim që të arrihen rezultate dhe të plotësohen nevojat e burrave dhe grave, djemve dhe vajzave, si dhe grupeve të ndryshme të burrave, grave dhe fëmijëve.

Deri më tani, në teori dhe në praktikë, dallohen dy strategji në buxhetimin gjinor, aksesit tradicional dhe modern, nëpërmjet përfshirjes së perspektivave gjinore në proceset buxhetore.

Koncepti tradicional i buxhetimit gjinor nënkupton intervenime në politikat shtetërore, nëpërmjet mjeteve financiare plotësuese për programe të veçanta, të cilat u kushtohen avancimit të pozitës së gruas, trajnimeve të dedikuara për gratë ose eventualisht përkrahjeve për organizatat ose institucionet e veçanta (për shembull, Ministria për barazi gjinore).

Kritikuesit e aksesit tradicional theksojnë se masat e atilla nuk janë shumë efikase ose thjeshtë nuk janë të mjaftueshme në luftën për avancim të pozitës së gruas në shoqëri. Ato theksojnë se nevojitet që përveç ministrive, konceptet gjinore dhe buxhetimin gjinor, si vegël në krijimin e politikave dhe ndjekjen e efekteve të këtyre politikave, t'i inkuadrojnë të gjitha organet e tjera të administratës shtetërore dhe agjencitë, në kuadër të kompetencave të tyre,.

Pra, personat e teorisë dhe praktikës, të cilët merren me këtë problematikë, e hapin çështjen për shpenzimin e mjeteve publike. Pa dallim nëse bëhet fjalë për bujqësinë, shëndetësinë, arsimin ose politikën sociale, të gjitha ato në thelb e anashkalojnë çështjen e efekteve të këtyre politikave ndaj burrave dhe grave, nën hijen *egalite* ose ndarje e barabartë për të gjithë.

Megjithatë, është e qartë se programet qeveritare në sektorë të ndryshëm kanë efekte të ndryshme pozitive ose negative ndaj grave dhe burrave, fuqisë së tyre ekonomike dhe ndaj standardit të tyre jetësor.

Aksesi i ri ndaj buxhetimit gjinor është bazuar në platformën e përfshirjes së perspektivës gjinore në rrjedhat kryesore, i njëjti është i pranuar nga OKB-ja dhe është pjesë përbërëse e agjendës së UNIFEM.

Këshilli i Evropës e përcakton buxhetimin gjinor si "zbatimi i përfshirjes së perspektivave gjinore në përcaktimin e procesit buxhetor. Ai nënkupton vlerësim gjinor të buxhetit, përfshirje të perspektivave gjinore në të gjitha nivelet në procesin e përcaktimit të buxhetit dhe rishpërndarje të të hyrave dhe shpenzimeve, me qëllim që të avancohet barazia gjinore".

E ballafaquar me sfidat e procesit të pranimit dhe harmonizimit të legjisllacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, Republika e Maqedonisë ka për detyrë t'i marrë parasysh edhe rekomandimet për barazi gjinore dhe buxhetim gjinor, që janë përcaktuar në rezolutën e Bashkimit Evropian për buxhetim gjinor nga viti 2003.³

Në kuadër të PNABGJ janë përmbledhur qartë thelbi dhe qëllimet e buxhetimit gjinor dhe detyrimi i ndërmarrë për përfshirjen e tyre në politikat dhe praktikat. Duke e pasur parasysh faktin se buxhetimi nuk është vetëm vegël financiare për balancim të anës së të ardhurave dhe shpenzimeve, por edhe proces i vendosjes së prioriteteve dhe sjelljes së vendimeve për çështje që ndikojnë në situatën aktuale dhe të ardhshme të njerëzve dhe mjedisit të tyre, buxhetimi gjinor është definuar si *proces nëpërmjet të cilit buxhetet publike kontrollohen me qëllim që të vlerësohen nëse dhe sa e përfshijnë*

3 Rezoluta për buxhetim gjinor, P5_TA (2003) 0323

dhe/ose kontribuojnë për barazinë midis burrave dhe grave dhe në këtë mënyrë të propozojnë ndryshime në drejtim të arritjes së barazisë gjinore.

Përveç vullnetit politik, një nga parakushtet kryesore për zbatim të buxhetimit gjinor është ekzistimi i të dhënave statistikore të ndara sipas gjinive dhe indikatorët. Me to qeveritë mund t'i përmirësojnë proceset e programimit dhe planifikimit të shpenzimeve dhe të ardhurave. Kjo do t'u ndihmojë që pas zbatimit të buxhetit t'i vlerësojnë efektet që këto politika i kanë pasur ndaj përdoruesve të ndryshëm.

1.3 PËRVOJA TË BUXHETIMIT GJINOR SENSITIV NË BOTË

Buxheti gjinor paraqet vegël e rëndësishme antidiskriminuese dhe relativisht të re për arritje të barazisë gjinore, të cilën e përdorin më shumë se 60 vende në botë, ndërsa e njëjta inicohet dhe zbatohet në shumë mënyra të ndryshme.

Historia e buxhetimit gjinor sensitiv ka filluar me Deklaratën buxhetore femërore në Australi, në vitin 1984. Në deklaratën buxhetore australiane janë përpunuar indikatorët e barazisë gjinore dhe prandaj kjo iniciativë pioniere ka inspiruar shumë iniciativa të tjera.

Që atëherë dhe deri më sot, lidhur me praktikën e buxhetimit gjinor janë realizuar edhe një sërë hulumtimesh teorike, të cilat ofrojnë përkufizime për këtë vegël, analiza të praktikave ekzistuese dhe drejtime për zhvillim të metodologjive përkatëse për avancim të procesit të buxhetimit gjinor.

Deri në vitin 2007, në nivel global është regjistruar një numër i madh iniciativash lidhur me buxhetimin gjinor, pjesa më e madhe e të cilave është regjistruar në vendet në zhvillim. Vlejnë të përmenden iniciativat e Afrikës Jugore për buxhetimin gjinor (RBI), e iniciuar nga Këshilli parlamentar i financave dhe nga disa organizata joqeveritare, në vitin 1994. Pas analizimit të 27 sektorëve të buxhetit nacional dhe analizimit të 840 buxheteve lokale të Afrikës Jugore, janë ndryshuar prioritetet ekonomike dhe shoqërore dhe janë riorientuar mjetet buxhetore në favor të grave. Eksperiencia e Afrikës Jugore probleme të mëdha në sferën e barazisë gjinore.

Në Amerikën Latine dhe në vendet e Karaibeve gjatë dekadës së fundit të shekullit XX, janë ngritur një sërë iniciativash lidhur me buxhetet gjinore, si rezultat të aktiviteteve të organizatave femërore. Theksi i këtyre RBI është vendosur në zvogëlimin e varfërisë, përforsimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në përpilimin e buxhetit dhe në lidhjen e tij me çështjet ekologjike. RBI-ja meksikane, e cila paraqet koalicion të gjerë të sektorit civil, ka arritur para parlamentit.

Në kontinentin Aziatik, iniciativat për buxhetim gjinor janë më të zhvilluara në Indi, Bangladesh dhe në Filipinet dhe të njëjtat kryesisht janë të lidhura me zvogëlimin e varfërisë.

Pothuajse gjysma e këtyre iniciativave janë ndërmarrë në vendet e Komonveltit. Nga këto vende vjen përkrahja më aktive dhe ndihma gjatë implementimit të projekteve për buxhetim gjinor, nëpërmjet Sekretariatit të Komonveltit. Ky institucion e ka iniciuar projektin "Iniciativat për buxhetim gjinor" dhe e ka implementuar të njëjtin bashkë me UNIFEM, Institutin kanadez hulumtues, Fondacionin FORD, UNDP dhe GTZ.

Çështja e buxhetimit gjinor sensitiv është përmendur për herë të parë në Komisionin evropian në tetor të vitit 2001, kur kryesia belge, në bashkëpunim me Organizatën për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik, UNIFEM dhe me Këshillin nordik të ministrave, ka organizuar një konferencë në temë "Buxheti gjinor: vizioni global për përforsim të qeverisë ekonomike dhe financiare", me anë të të cilës u hap debati

lidhur me buxhetet publike nga aspekti i perspektivës gjinore. Konferenca e paraqet fillimin e pranimit të strategjisë për buxhetim gjinor. Në pranverën e vitit 2003, Këshillit këshillëdhënës për barazi gjinore i është parashtruar versioni punues i dokumentit, i cili Komisionit evropian i ka shërbyer si bazë për rekomandime të drejtuara ndaj vendeve anëtare dhe vendeve candidate për anëtarësim në BE. Gjithashtu, Këshilli i Evropës e miratoi përkufizimin sipas të cilit buxhetimi sensitiv gjinor nënkupton që perspektiva gjinore të përfshihet në procesin e buxhetimit (gendermainstreaming).

Që para sjelljes së këtyre rekomandimeve, pjesa më e madhe e vendeve anëtare të BE-së, në forma të ndryshme kanë inkuadruar elemente të buxhetimit gjinor: Në Britaninë e Madhe, në vitin 1989, analiza gjinore, e cila ka qenë e përqendruar ndaj të ardhurave të buxhetit dhe ndaj politikës tatimore, ka ndikuar në ndryshimin e pamjes tradicionale të buxhetit, lidhur me aspektin gjinor; në Zvicër, në vitin 1996, është publikuar studimi pilot për buxhetimin gjinor, në të cilin analiza gjinore nuk është e orientuar ndaj buxhetit si tërësi, por ndaj efekteve nga ndryshimi i politikës lidhur me gratë dhe burrat. Njëkohësisht janë iniciuar një sërë aktivitete në drejtim të rritjes së vetëdijes publike; në Francë, në vitin 2000, RBI rezultoi me obligim të qeverisë që në propozim-buxhetin të përgatis raport për rezultatet në sferën e barazisë gjinore; në Austri, buxhetimi gjinor është paraparë në nenin 13 të Kushtetutës, sipas të cilit buxhetimi në të gjitha nivelet e qeverisë duhet të ketë për qëllim sigurimin e barazisë gjinore. Së fundi, ta përmendim edhe përvojën e vendeve nordike. Ministria për barazi gjinore e Këshillit nordik, në vitin 2000 ka sjell program për inkurajim të barazisë gjinore, për periudhën e viteve 2001-2005, në të cilin dimensionin gjinor është i integruar në buxhetet nacionale, ndërsa si projekt pilot është përfshirë edhe buxheti i Këshillit nordik.

Duke i ndjekur eksperiencat e iniciativave të këtilla, me të cilat është përmirësuar barazia gjinore në institucionet politike, buxhetimin gjinor kanë filluar ta institucionalizojnë edhe institucionet ndërkombëtare, siç janë Banka botërore dhe OKB-ja.

Në vendet anëtare të BE-së, perspektiva gjinore gjithnjë e më shumë është duke u përfshirë në politikat dhe në programet publike, ekonomike dhe sociale dhe e njëjta ka përkrahje gjithnjë e më të madhe. Njëkohësisht është duke u rritur edhe vetëdija se efektet e këtij procesi do të jenë të kufizuara, nëse nuk do t'i përfshijnë edhe buxhetet - duke filluar nga buxheti i Bashkimit Evropian dhe vendeve anëtare, buxhetet rajonale, deri në buxhetet komunale dhe ato të institucioneve publike.

Përvoja botërore tregon se pjesa më e madhe e Iniciativave gjinore buxhetore e kanë ndërmarrë hapin e parë të analitikës, ndërsa qëllimi kryesor i RBI është koncepti gjinor të integrohet në kriteret që e përcaktojnë planifikimin, formulimin dhe zbatimin e buxhetit. E sipërpërmendura rezulton me marrjen e masave në vijim, të cilat do të mundësojnë që analiza gjinore e buxhetit të kalojë në përpilim gjinor sensitiv të buxhetit.

2. KONTEKSTI SOCIAL DHE EKONOMIK NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Procesi i tranzicionit në vendet e rajonit shkaktoi ndryshime të mëdha në sferën sociale dhe ekonomike, të cilat rezultuan me ndarje të dukshme në strukturën sociale të popullatës, me rritje të varfërisë, shkallë të lartë të papunësisë dhe me rritje të numrit të kategorive të ndryshme të popullatës që ballafaqohen me probleme sociale.

Ulja e të ardhurave nacionale shkaktoi zvogëlim të të drejtave sociale dhe keqësim të gjendjes sociale të pjesës më të madhe të popullatës. Për shkak të uljes së

numrit të personave të punësuar dhe të siguruar, të cilat i paguajnë kontributet, fondet sociale filluan të varfërohen, ndërsa shtetet për t'i zgjidhur problemet sociale janë të detyruara të ndajnë mjete që mbliidhen nga donacionet dhe nga tatimet. Në këtë mënyrë arrihet në fiskalizimin e ndihmave sociale, duke u rrezikuar në këtë mënyrë modeli i sigurisë sociale, i cili bazohet në kontributet dhe në fondet sociale individuale.⁴

Me gjendjen e atillë ballafaqohet edhe Republika e Maqedonisë.

Të dhënat tregojnë se prodhimi vendas bruto (PVB) për banor është sa një e katërta e mesatares së BE-së - 27.⁵

Shkaqet e gjendjes së këtyllë qëndrojnë në problemin më të madh me të cilin ballafaqohet vendi, më saktë në shkallën e papunësisë, e cila sipas parametrave evropiane është jashtëzakonisht e lartë (35%) dhe e cila është një ndër faktorët kryesorë të varfërisë dhe përjashtimit social.

Duke pasur parasysh se tregu i punës nuk e përfshin kapitalin njerëzor në tërësi, por vetëm qytetarët aktiv nga aspekti ekonomik (të punësuarit dhe ato që kërkojnë punë), kjo shkallë për Republikën e Maqedonisë në vitin 2007 ka qenë 62,8%, ndërsa në vitin 2008 ka shënuar rritje të vogël, duke arritur në 63,5%. Nga ana tjetër, shkalla e punësisë në vitin 2007 ka qenë 40,7%, që paraqet shkallë jashtëzakonisht të ulët, ndërsa në vitin 2008 e njëjta ka qenë 41,9%.

Tendencat e këtylla shkaktojnë rritje të numrit të personave të rrezikuar, të cilët nuk mund të sigurojnë mjete minimale për ekzistencë. Prandaj, në sistemin e mbrojtjes sociale u rrit numri i përdoruesve të ndihmave sociale. Sa për ilustrim, në vitin 1998 janë regjistruar 49.955 përdorues të ndihmave sociale, ndërsa në vitin 2007 ndihmë sociale në të holla kanë shfrytëzuar 64.143 persona. Në vitin 2008 numri i përdoruesve të ndihmës sociale u zvogëluar në 57.687 (shikoni tabelën nr. 6, ndihma sociale në të holla: nr. i përdoruesve).

Me këto probleme, në mënyrë të barabartë ballafaqohen burrat dhe gratë por nëse do të realizohet një kontroll i detajuar, dallimet bëhen të qarta.

Periodha e tranzicionit jo vetëm që e ndryshoi në mënyrë radikale gjendjen sociale të popullatës në tërësi, por ndikoi edhe në thellimin e dallimeve midis grave dhe burrave, si në statusin social ashtu edhe në aksesin dhe mundësitë për përdorim të resurseve shoqërore.

Dallimet mund të konstatohen në disa parametra socio-ekonomik.

Shkalla e papunësisë së burrave dhe grave në vitet 2007 dhe 2008 ka qenë përfaqësisht e njëjtë ose 35,8% dhe 34,3% për gratë, ndërsa 34,8% dhe 33,7% për burrat.

Por, nëse analizohen shkallët e punësisë dhe aktivitetit të popullsisë sipas gjinive, dallimet janë të qarta. Në numrin e përgjithshëm të popullatës së punësuar, burrat në vitin 2008 kanë marrë pjesë me 50,7%, ndërsa gratë me 32,9%. Dallimi është akoma më i madh në shkallën e aktivitetit të popullsisë. E njëjta për gratë aktive në tregun e punës gjatë vitit 2008 ka qenë 50,2%, ndërsa për burrat 76,6%. Arsyeet për pjesëmarrjen e madhe të grave në popullatën joaktive, zakonisht janë si pasojë të vlerave tradicionale dhe normave shoqërore, rolit të gruas në shtëpi dhe kujdesit për fëmijët, sidomos në mjediset rurale dhe suburbane dhe tek bashkësitë e caktuara

4 Puliz.V., "Politika sociale e vendeve të Ish Jugosllavisë-trashëgimi, kontinuitet dhe ndryshime (konteksti historik dhe politika sociale)" në Përgatitjen e politikës së re sociale: pjesëmarrës, dimensione dhe reforma, Universiteti Shën Kiril dhe Metodij, Fakulteti i filozofisë, Instituti i punës dhe politikës sociale, Fondacioni Fridrih Ebert, Zyra në Shkup, viti 2007.

5 Analiza civile, UNDP, 2008

etnike, para së gjithash, në bashkësitë shqiptare dhe rome.⁶

Pabarazitë specifike konstatohen edhe gjatë vlerësimit të punës së grave, sidomos në pjesën e punës së papaguar, e cila klasifikohet në ekonominë e zezë. Anëtarët që japin ndihmë brenda familjes, zakonisht janë gratë, të cilat njëkohësisht nuk sigurojnë të ardhura ose nuk ushtrojnë ndonjë aktivitet. Ato zakonisht nuk janë aktive dhe paraqesin fuqi punëtore potenciale, por e pashfrytëzuar për shkak të sjelljes tradicionale dhe konceptimit të rolit të gruas në familje dhe në shoqëri, të cilat ka shtrirje të gjerë edhe gjatë këtij shekulli. Sa për ilustrim, në pjesën e punësisë, sipas statusit ekonomik, në vitin 2006 pjesëmarrja e grave në rolin e punëdhënësit ka qenë 21%. Vetëm 17% të grave kanë qenë të vetëpunësuar, por 60% prej tyre kanë qenë punonjëse të papaguara familjare.⁷

Gratë janë më pak të pranishme për shkak të pjesëmarrjes së tyre më të vogël në popullatën aktive, sepse fuqia punëtore femërore është më e vogël për shkak të shkallës së ulët të popullsisë femërore aktive, sidomos tek bashkësitë etnike. Pjesëmarrja e tyre në ekonominë e zezë është e dukshme sidomos tek bashkësia etnike rome, si ndihmë për familjet (pastrim, ruajtje të fëmijëve etj), kujdes të fëmijëve dhe personave të moshuar dhe të sëmurë, si dhe ndihmë në bujqësi dhe zejtari.

Gratë zakonisht punojnë si punonjëse të papaguara (në bujqësi, zejtari, tregti), kështu që puna e tyre nga aspekti juridik-formal nuk ekziston.⁸ Meqë janë joaktive, gratë nuk marrin pjesë në tregun e punës. Prandaj, përdorimi i fuqisë punëtore femërore është i ulët, fakt që konstatohet nëpërmjet shkallës së ulët të punës së grave.

Siç mund të vërehet nga e sipërpërmendura, shkalla e grave joaktive është pothuajse dy herë më e madhe, krahasuar me atë të burrave.

Tek femrat, çdo e treta grua nga 25 deri në 49 vjet është joaktive, në dallim nga meshkujt e të njëjtës moshë, tek të cilët joaktiv është çdo i nënti burrë.⁹

Në literaturën empirike nga sfera e sociologjisë së familjes dhe demografisë sociale është konstatuar se specifikimet gjinore në veçanti theksohen tek gratë e martuara. Kur formojnë familje, dyfishohen angazhimet e tyre dhe mospërputhja e rolit familjar me atë shoqëror. Si rezultat i kësaj, zvogëlohet numri i fëmijëve. Në këtë kontekst shfaqet qartë lidhja e ngushtë midis produktivitetit material dhe biologjik, të cilit i duhet kushtuar vëmendje gjatë përgatitjes së strategjive dhe planeve aksionare, lidhur me zhvillimin demografik dhe ekonomik. Kjo gjë është e rëndësishme në mënyrë të barabartë si për rajonet rurale, ashtu edhe për rajonet urbane (emigrim të popullsisë së re).

Në sferën e mbrojtjes sociale, në pjesën e ndihmës sociale, të dhënat tregojnë se përdorues të ndihmave sociale zakonisht janë burrat. Përqindja e burrave që shfaqen si përdorues të kësaj të drejtë në vitin 2006 ka qenë 81%. (shikoni tabelën nr. 7, ndihma sociale në të holla: nr. i përdoruesve sipas gjinisë).

Një numër i madh i studimeve lidhur me varfërinë sociale, midis të cilave renditen studimet e Bankës Botërore, i përfshijnë relacionet komplekse të përjashtimit social, ndjeshmërinë e grupeve të caktuara, aksesin në resurset (arsimi, shëndetësia, ndihma sociale, trualli, financat) dhe mundësia për t'i administruar të njëjtat, tregon se pabarazitë gjinore janë më të mëdha midis të varfërve. Pikërisht, barazitë e atilla e zvogëlojnë modusin burrat dhe gratë ta tejkalojnë varfërinë. Pabarazia gjinore gjithashtu përmendet si një nga arsyet për rritje të varfërisë.

6 *Maqedonia e paraqitur në shifra*, Enti shtetëror i statistikave, Shkup, 2009.

7 *Gratë dhe burrat në Republikën e Maqedonisë*, Enti shtetëror i statistikave, 2008

8 Jovanoviq, A., *Lindjet dhe planifikimi i familjes në RM*, Metamorfoza Shkup, 1998

9 *Plani nacional aksionar për punësim i vitit 2009-2010*, MPPS, dhjetor i vitit 2008, faqja 23

Në kuadër të Strategjisë nacionale për punësim - viti 2010, theksohet se politika në sferën e mbrojtjes sociale duhet orientuar drejt zvogëlimit të varfërisë, kohezionit dhe inkluzionit social. Gjatë kësaj, si instrument kryesor në zvogëlimin e varfërisë, theksohet rritja e punësisë. Në këtë drejtim, Qeveria e Republikës së Maqedonisë shpreh vullnet dhe gatishmëri për promovim të standardeve dhe vlerave evropiane edhe në politikat aktive për punësim, nëpërmjet synimit për rritje të shkallës së punësisë së grave.

Në këtë drejtim, në dokumentet kryesore strategjike, siç janë Strategjia nacionale e punësimin (SNP) 2010 dhe Plani aksionar nacional për punësim (PANP) 2009-2010, midis qëllimeve gjendet edhe shkalla për rritje të punësisë së grave në Republikën e Maqedonisë, nga 31,1%, e cila është e regjistruar në vitin 2005, në 38% në vitin 2010, duke e theksuar në veçanti pasivitetin e grave të bashkësive etnike shqiptare, rome dhe turke.

Njëkohësisht, duhen theksuar përpjekjet sistematike të shtetit për avancim të barazisë gjinore dhe statusit të grave nëpërmjet rumbullakësimit të kornizës ligjore dhe strukturës së formuar gjinore. Duke ndërmarrë aktivitete të orientuara drejt analizës gjinore të programeve dhe buxhetit të saj, Ministria e punës dhe politikës sociale edhe njëherë e shpreh përcaktimin e saj serioz për të punuar në fushën e inkuadrimin të perspektivës gjinore, në të gjitha sferat e jetës shoqërore.

3. AKSESI METODOLOGJIK

Kjo analizë, e cila është pjesë përbërëse e projektit të parë pilot për buxhetim sensitiv gjinor në RM dhe e cila është duke u realizuar në nivel nacional, është e iniciuar me qëllim që të vërtetohet shkalla e përfshirjes së aspekteve gjinore në politikat aktive të punësimin dhe mbrojtjes sociale, si dhe ndikimi i tyre në buxhetet.

Objektin e analizës e përbëjnë politikat aktive për punësim dhe mbrojtje sociale, të cilat janë përcaktuar nga ana e Ministrisë së punës dhe politikës sociale.

Zgjedhja përfundimtare për analizë të një pjese të politikave për punësim (vetëpunësim, formalizim të bizneseve, subvencionim të punësimin dhe përgatitja për punësim) dhe një pjese të të drejtave të përdoruesve në sferën e ndihmës sociale (ndihma e vazhdueshme në të holla dhe ndihma sociale në të holla) u realizua në bazë të prioritetëve që e përfshijnë dimensionin gjinor, vlerësimin të pranisë së të dhënave dhe kompatibilitetit të programeve, kohës dhe resurseve në dispozicion.

Realizimi i këtyre politikave është nën kompetencat e Ministrisë së punës dhe politikës sociale, Qendrave të punës sociale, Agjencisë së punësimin të Republikës së Maqedonisë (APRM), Agjencisë për përkrahje të sipërmarrjes në RM (APSRM) etj. Në realizimin e programeve marrin pjesë edhe organizatat ndërkombëtare, të cilat ofrojnë përkrahje të karaktereve të ndryshme, financiare, organizative, konsultative, përkrahje për inicim të hulumtimeve, analizave dhe për vlerësim të realizimit të politikave.

Nga aspekti metodologjik, politikat analizohen në katër shkallë: (1) në nivelin e përgatitjes dhe sjelljes së akteve, (2) në nivelin e proceseve të implementimit, (3) në nivelin e përfshirjes së përdoruesve, (4) dhe në nivelin e vëzhgimit dhe vlerësimin të programeve.

Për plotësimin e detyrave dhe qëllimeve të caktuara, u analizuan politikat e përcaktuara në dokumente të veçanta strategjike, programet që dalin nga ligjet, planet aksionare, programet operative dhe nga buxhetet, të cilat i vëzhgojnë këto politika në periudhë 2-vjeçare, me qëllim që të vërtetohet nëse dhe sa janë të përfshira çështjet

gjinore brenda tyre. Analiza e të dhënave u plotësua me një sërë intervistash me persona të institucioneve kompetente (MPPS, UNDP, APRM, Enti për veprimtari sociale–EVS).

Për kontroll sa më të mirë të gjendjes së aspekteve gjinore në implementimin e politikave dhe programeve, në masë të madhe do të kontribuonin njohuritë dhe qëndrimet e përdoruesve të fundit, nëpërmjet një hulumtimi të veçantë, i cili nuk është parë në kuadër të këtij projekti (grupe qëllimore, hulumtim etj.)

Çështjet kryesore për të cilat dëshironim të fitonim përgjigje ishin: (1) A janë të hapura programet në mënyrë të barabartë për burrat dhe gratë? (2) A i arrijnë programet qëllimet për të cilat janë paraparë? (3) Cilat janë përfitimet dhe efektet dhe si ndikojnë programet ndaj burrave dhe grave? (4) Në cilën mënyrë mund të avancohen politikat dhe programet, nga aspekti i përfshirjes së perspektivës gjinore dhe cilat janë mekanizmat nëpërmjet të cilave mund të arrihet avancimi? (5) Si bëhet ndarja e buxheteve për gratë dhe burrat?

Rezultati i analizës ishte procedura metodologjike e përgatitur nga dr. Elizabet Klatcer, ekspert nga Austia, e cila u angazhua si konsulente e projektit për buxhetim gjinor. Në aksesin e saj janë sublimuar përvoja të suksesshme metodologjike dhe është synuar që rekomandimet të jenë të zbatueshme në kontekstin tonë shoqëror.

Duhet theksuar se ekipi që e realizoi analizën, në masën më të madhe i pranoi udhëzimet metodologjike, por nuk kishte mundësi t'i zbatoj të gjitha hapat e rekomanduara të procedurës së propozuar metodologjike dhe prandaj u realizuan modifikime të caktuara.

Sfida më e madhe me të cilën u ballafaquan ekspertët gjatë analizës dhe njëra nga arsyt kryesore për modifikim të metodologjisë ishte grumbullimi i të dhënave. Metodologjia e ndryshme për grumbullim të të dhënave midis institucioneve kryesore, të angazhuara për evidentim të përdoruesve të këtyre politikave si dhe mungesa e mbajtjes së statistikave të veçanta gjinore, mbetet problem i madh. Pa këtë metodologji nuk është e mundur të përgatitet praktikë për vlerësim të ndikimeve të politikave dhe programeve me aspekt gjinor.

Arsye tjetër për pamundësinë që të zbatohen këto etapa metodologjike është numri i vogël i hulumtimeve dhe vlerësimeve për efektet e realizimit të politikave, të cilat do t'i merrnin parasysh aspektet gjinore.

Për qëllimet e kësaj analize u formua ekip, në të cilin morën pjesë katër ekspertë të pavarur, punonjës zyrtarë të Ministrisë së Punës dhe Politikës sociale (Sektori për mundësi të barabarta, Sektori për financa dhe buxhet, Sektori i punës dhe Sektori i ndihmës sociale) dhe të Ministrisë së financave.

Shpresojmë se analiza e realizuar e një pjese të politikave të Ministrisë së Punës dhe politikës sociale, të cilat janë me rëndësi të madhe, do t'i hap çështjet, do të zhvilloj debate të mëtejshme dhe do të kontribuoj në “shtrimin e rrugëve” drejt implementimit të buxhetimit gjinor.

4. MBROJTJA SOCIALE

Sistemi i mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë

Mbrojtja sociale në Republikën e Maqedonisë bazohet në parimin e humanizmit, drejtësisë dhe solidaritetit social, të parapara në Kushtetutën e Republikës së

Maqedonisë. Sipas nenit 4 të Ligjit të Mbrojtjes sociale¹⁰, mbrojtja sociale përkufizohet si “veprimtari e organizuar nga ana e Republikës, për parandalim dhe tejkalim të rreziqeve kryesore sociale ndaj të cilëve është ekspozuar qytetari, familja dhe grupet e popullsisë, gjatë jetës së tyre”¹¹. Kujdesi për parandalim të rrezikut social realizohet edhe nëpërmjet marrjes së masave në politikën tatimore, punësimin, politikën e ndarjes së bursave, atë të ndarjes së banesave, në politikën për familje, shëndetësi, edukim dhe arsim, si dhe masave në sfera të tjera, në përputhje me ligjin¹².

Realizimi i mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë, përveç në Ligjin për mbrojtje sociale, bazohet edhe në: Ligjin për familje; Ligjin për punësim të personave me invaliditet; në rregullat juridiko-penale dhe në aktet dhe aktet nënligjore me të cilat janë rregulluar të drejtat dhe shërbimet e mbrojtjes sociale.

Organizimi dhe realizimi i mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë është nën kompetenca të Ministrisë së punës dhe politikës sociale (MPPS), nëpërmjet Sektorit për mbrojtje sociale, qendrave të punëve sociale (QPS) dhe institucioneve për mbrojtje sociale. Qendrat e punëve sociale, të cilat janë njësitë kryesore për realizim të mbrojtjes sociale, janë persona të veçantë juridik, ndërsa MPPS e kontrollon punën e tyre. Ligji i vetëqeverisjes lokale¹³ ofron bazë ligjore për zhvillimin e bashkëpunimit midis njësiteve të vetëqeverisjes lokale dhe qendrave të punës sociale, në pjesën e aktiviteteve, por jo edhe në pjesën e realizimit të masave, të cilat janë nën kompetent e Sektorit për mbrojtje sociale, pranë MPPS. Sot në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë gjithsej 30 QPS, 27 prej të cilave janë qendra ndër-komunale, ndërsa 3 të tjerat janë qendra komunale. Në këto qendra janë punësuar gjithsej 795 punonjës, 535 ose 67% prej të cilëve janë gra¹⁴.

Në bazë të Ligjit për mbrojtje sociale dhe Ligjit për realizim të buxhetit të Republikës së Maqedonisë¹⁵, Qeveria e RM. çdo vit sjell Program për realizim të mbrojtjes sociale, në të cilin i zbaton politikat dhe përcaktimet që dalin nga prioritetet strategjike për vitin aktual. Me anë të Programit, nga afër rregullohen sferat e punës sociale, nevojat specifike të popullatës dhe mënyra e realizimit të mbrojtjes sociale. Në këtë Program janë paraparë shërbime dhe masa për mbrojtje sociale, mbrojtje jashtë-institucionale dhe mbrojtje institucionale të qytetarëve që janë ekspozuar në rreziqet kryesore sociale, si dhe ndihma sociale e përdoruesve¹⁶.

Ndihma sociale paraqet aspekt shumë i rëndësishëm i sistemit të mbrojtjes sociale, nëpërmjet të cilit shteti e shpreh kujdesin dhe ndihmën e tij ndaj kategorive më të rrezikuara të qytetarëve. Qëllimet e qarta në sferën e ndihmës sociale kanë të bëjnë me zvogëlimin e varfërisë (mbrojtje të gupeve më të varfra dhe më të rrezikuara) dhe me rritjen e standardeve për realizim të të drejtës së ndihmës sociale, si preventivë nga përjashtimi social. Këto qëllime janë paraparë në Planin strategjik 2007-2009 të Ministrisë së punës dhe politikës sociale¹⁷, i cili parasheh edhe program të veçantë të quajtur Kompensime në bazë të të drejtave të mbrojtjes sociale dhe Nën-program për sigurim të të drejtave të mbrojtjes sociale. Kontrolli i dokumenteve të sferës së mbrojtjes

10 Ligji për mbrojtje sociale I

11 Me termin rreziqe sociale nënkuptohen: rreziqet ndaj shëndetit (sëmundje, lëndime dhe invaliditet); rreziqet nga mosha/vjetërsia (vjetërsia dhe mbijetesa); rreziqet e amësisë dhe familjes; rreziqet e papunësisë dhe mos-adaptimit profesional dhe rreziqet e mos-adaptimit ndaj mjedisit social.

12 Ligji për mbrojtje sociale I

13 Ligji i vetëqeverisjes lokale “Gazeta Zyrtare e RM”, nr. 5 nga 29.01.2002, neni 22, paragrafi 7

14 Paraqitje statistikore: popullata dhe statistikat sociale, Mbrojtja sociale e fëmijëve, të rinjve dhe personave të rritur në Republikën e Maqedonisë, 2007-2008, Enti shtetëror i statistikave, Shkup, tetor i vitit 2008

15 Ligji për mbrojtje sociale “Gazeta Zyrtare e RM” nr. 50/97, Ligji për realizim të buxhetit të RM “Gazeta Zyrtare e RM” nr. 166/8

16 Programi për realizim të mbrojtjes sociale për vitin 2009, MPPS, <http://mtsp.gov.mk/?ItemID=BD66FCC3A7FBCB47AB9150CBFECD2C96>

17 Plani strategjik i MPPS mund të gjendet në <http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/strateski.pdf>

sociale, ku renditet edhe ndihma sociale e përdoruesve, tregon se ky Program i veçantë akoma nuk është i përgatitur. Nga ana tjetër, në Programin për mbrojtje sociale të viteve 2008 dhe 2009, mungon çfarëdo lloj përkufizimi lidhur me qëllimet e ndihmës sociale.

Në përputhje me Ligjin për mbrojtje sociale, ndihma sociale për përdoruesit i përfshin kategoritë në vijim: (1) ndihmën e vazhdueshme në të holla për personat e paaftë për punë dhe për personat e pasiguruar nga aspekti social; (2) ndihmën sociale në të holla për personat të aftë për punë por të pasiguruar nga aspekti social; (3) kompensimin në të holla për ndihmën dhe për kujdesin e ndonjë personi të caktuar; (4) të drejtën e mbrojtjes shëndetësore; (5) kompensimin e rrogës për orar të shkurtuar të punës, për shkak të kujdesit për fëmijën me probleme fizike ose mendore¹⁸; (6) ndihmën e njëhershme në të holla ose ndihmën jomateriale; (7) të drejtën e strehimit dhe ndihmës sociale të personit, i cili deri në moshën 18-vjeçare e ka pasur statusin e fëmijës pa prindër dhe përkujdesje prindërore.

Objekti i analizës sonë janë dy kategoritë e para të ndihmës sociale të përdoruesve: e drejta e ndihmës së vazhdueshme në të holla dhe e drejta e ndihmës sociale në të holla për përdoruesit.

Buxheti për sistemin e mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë

Realizimi i Programit për mbrojtje sociale planifikohet nëpërmjet tre programeve buxhetore të MPPS: Programi 2-Mbrojtja sociale jashtë-institucionale, Programi 3-Mbrojtja sociale institucionale dhe Programi 4-Kompensime dhe të drejta në sferën sociale. Programi i fundit ndahet në dy pjesë: në dispozitën 433- Transferime në Fondin e shëndetësisë, të dedikuara për realizimin e të drejtës së mbrojtjes shëndetësore të përdoruesve të mbrojtjes sociale dhe në dispozitën 471-Kompensime sociale, në të cilat, përveç mjeteve për të drejta dhe shërbime të tjera, janë paraparë edhe mjete për ndihmë të vazhdueshme sociale në të holla.

Mjetet për kompensim të të drejtave për mbrojtje të popullatës së rrezikuar nga aspekti social, në buxhetin e RM parashihen nëpërmjet nën-programit buxhetor 41-Kompensime në bazë të të drejtave të mbrojtjes sociale, nën-program i cili ndahet në: a) Dispozita 471-Kompensime sociale të parapara për Ndihmë të vazhdueshme në të holla, Ndihmë sociale në të holla, Kompensim në të holla për ndihmë dhe kujdes të ndonjë personi tjetër, E drejta e kompensimit të rrogës për orar të shkurtuar pune, për shkak të kujdesit për fëmijën me invaliditet, Ndihmë e njëhershme në të holla ose ndihmë jomateriale, E drejta e strehimit, Ndihmë në të holla për personin i cili deri në moshën 18-vjeçare e ka pasur statusin e fëmijës pa prindër dhe përkujdesje prindërore, E drejta e kompensimit të shpenzimeve për akomodim dhe kompensim për përkujdesje të personit të akomoduar në familje përkujdesëse dhe akomodim në konviktet e nxënësve ose në institucione të tjera të fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, deri në aftësimin për jetë të pavarur dhe punë, por më së voni deri në përfundimin e arsimit të mesëm dhe b) Dispozita 433-Transferime në Fondin e shëndetësisë, të dedikuara për realizimin e të drejtës së mbrojtjes shëndetësore të përdoruesve të mbrojtjes sociale, në të cilën përfshihen: ndihma e vazhdueshme në të holla, akomodimi në familje përkujdesëse, kompensimi në të holla për ndihmë dhe kujdes për ndonjë person tjetër, akomodim në institucione për mbrojtje sociale, ndihmë në të holla për personin i cili deri në moshën 18-vjeçare e ka pasur statusin e fëmijës pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore.

Ndarja e mjeteve financiare të dedikuara për kompensime sociale, sipas llojeve të të drejtave dhe detyrimeve, bëhet në përputhje me buxhetin e Republikës së Maqedonisë me paralajmërim se këto mjete, në varësi të përfshirjes së të drejtave,

¹⁸ Në Ligjin për mbrojtje sociale, i sjellë në qershor të vitit 2009, kjo e drejtë përkufizohet si: "kompensim të rrogës për orar të shkurtuar pune, për shkak të kujdesit për fëmijën me pengesa fizike ose mendore gjatë zhvillimit"

mund të ndryshohen gjatë vitit në përputhje me ligjin, por vlera e përgjithshme e mjeteve nuk ndryshohet, përveç me ndryshime dhe plotësime me rebalancin e buxhetit (të sjella nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë).

Tabela 1. Buxheti i përgjithshëm i MPPS për kompensime sipas të drejtave të mbrojtjes sociale¹⁹ për vitet 2007, 2008 dhe 2009

		Buxheti i përgjithshëm i MPPS	Buxheti për kompensime sipas të drejtave të mbrojtjes sociale	Përqindja e pjesëmarrjes së buxhetit në kompensimet në bazë të të drejtave të mbrojtjes sociale në Buxhetin e përgjithshëm të MPPS
2007	Të planifikuara	19.575.720.000,00	2.882.000.000,00	14.72 %
2007	<i>Të realizuara</i>	17.936.474.671,00	2.799.139.410,00	15.6 %
2008	Të planifikuara	19.251.681.000,00	2.884.410.000,00	14.98 %
2008	<i>Të realizuara</i>	18.091.445.177,00	2.866.909.279,50	15.85 %
2009	Të planifikuara	23.962.659.000,00	2.846.000.000,00	11.89 %

* Sipas të dhënave të MPPS

Mund të vërehet se buxheti i paraparë për ndihmë sociale, në kuadër të buxhetit për kompensime në bazë të të drejtave të mbrojtjes sociale, gjatë tre viteve të fundit, në masën më të madhe, ka mbetur i pandryshuar. Edhe kundrejt ndryshimeve në buxhetin e përgjithshëm të Ministrisë së punës dhe politikës sociale (lidhur me mjetet e planifikuara dhe të realizuara), pagesat e përdoruesve në masën më të madhe kanë mbetur të njëjta. Zvogëlimi i pjesëmarrjes procentuale të buxhetit për ndihmë sociale të përdoruesve për vitin 2009 është si rezultat të zvogëlimit të buxhetit të përgjithshëm të MPPS.

Duhet theksuar edhe puna e Inspektionit social, nëpërmjet të cilit Ministria i realizon kontrollet mbi realizimin dhe ndryshimin e ligjeve dhe rregullave të tjera në sferën e mbrojtjes sociale. Në Raportin për punën e Sektorit për kontroll të zbatimit të ligjeve dhe rregullave të tjera në sferën e mbrojtjes sociale në vitin 2008²⁰, theksohet se është arritur zvogëlim të numrit të përgjithshëm të përdoruesve për 18.893 persona (ose në shifra absolute 8.767), nëpërmjet ndërprerjes së përdorimit të të drejtave nga të gjitha aspektet. Në këtë mënyrë u kursyen 48.611.185,00 denarë nga mjetet e përgjithshme buxhetore. Nga ana tjetër, në të njëjtin Raport sqarohet se si efekt i inspektionit u konstatua detyrimi për të kthyer 3.928.167,00 denarë. Këtë detyrim e kanë përdoruesit të cilët kanë fituar mjete financiare pa bazë ligjore ose në mënyrë kundërligjore kanë shfrytëzuar ndonjë të drejtë nga sfera e mbrojtjes sociale. Në këtë mënyrë konstatohet se kursimi i përgjithshëm i mjeteve buxhetore për vitin 2008 arrin në 55.399.393,00.

Në këtë raport theksohet se në periudhë afatgjate ky kursim do të ketë ndikim të madh, duke marrë parasysh se me sjelljen e vendimit për ndërprerje të të drejtës së mbrojtjes sociale, këtyre përdoruesve u shqiptohet masë, nëpërmjet të cilës përdoruesit, familjet-amvisëritë nuk mund ta gëzojnë të drejtën e ndihmës sociale në të holla, gjatë 6 ose 24 muajve të ardhshëm.

Duhet theksuar se edhe kundrejt këtyre kursimeve buxheti i realizuar në vitin 2008 ka mbetur në kuadër të mjeteve të dedikuara për këtë qëllim (Tabela 1). Vërehet se, edhe pse në vend të këtyre përdoruesve u paraqitën përdorues të rinj dhe u shënu

19 Buxheti i përgjithshëm, sipas Programit 41–Kompensime dhe të drejta në sferën sociale, në të cilën përfshihen edhe mjetet për ndihmë sociale të përdoruesve të të gjitha kategorive.

20 Raporti mund të gjendet në <http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/godisen.rtf>

rritje e numrit të përgjithshëm të përdoruesve të kategorive të ndryshme të ndihmave sociale, është siguruar kursimi i mjeteve të sipërpërmendura, por nuk ekzistojnë informata si janë shpenzuar ose janë ndarë mjetet.

Tabela 2. Buxheti i përgjithshëm për kompensime në bazë të të drejtave të mbrojtjes sociale, lidhur me buxhetet për Ndhimë të vazhdueshme në të holla dhe për Ndhimë sociale në të holla

		Buxheti për kompensime në bazë të të drejtave të mbrojtjes sociale	Ndhimja e vazhdueshme në të holla	% e ndihmës së vazhdueshme në të holla	Ndhimja sociale në të holla	% ndihmës sociale në të holla
2007	<i>Të realizuara</i>	2.799.139.410,00	197.763.713,00	7.06%	1.695.081.330,00	60.56 %
2008	<i>Të realizuara</i>	2.866.909.279,50	215.327.985,00	7.51%	1.594.948.709,00	55.63%
2009	Të planifikuara	2.846.000.000,00	200.000.000,00**	7.02%	1.638.000.000,00**	57.55%

* Sipas të dhënave të MPPS

** Të planifikuara me Programin për realizim të mbrojtjes sociale për vitin 2009, MPPS

Ndërkaq, konstante kanë qenë edhe shumtë që u janë ndarë përdoruesve, të cilat janë paraparë në pjesën e ndarjes së mjeteve buxhetore për kompensime në bazë të të drejtave të mbrojtjes sociale.

Sipas raportit në fjalë, ulje më e madhe në vitin 2008 është regjistruar tek përdoruesit e ndihmës sociale në të holla, e cila arrin në 13.958 në nivel vjetor (ose 8.767 përdorues nga numri i përgjithshëm i përdoruesve që e gëzojnë këtë të drejtë. Gjithashtu është theksuar se në fund të vitit 2007 janë regjistruar 62.295, ndërsa në fund të vitit 2008 numri i përdoruesve ka qenë 53.528). Lidhur me ndihmën e vazhdueshme në të holla është theksuar se numri i përgjithshëm i përdoruesve të kësaj të drejte është rritur për 204 (ose gjithsej 653 përdorues). Në këtë mënyrë, numri i përdoruesve në vitin 2008 ka qenë 5.198, ndërsa në vitin 2007 ndihmë të vazhdueshme në të holla kanë fituar 4.994 përdorues.

Gjithashtu është evidentuar dallim në numrin e përdoruesve të prezantuar në Raportin e punës së Sektorit për kontroll të zbatimit të ligjeve dhe rregullave të tjera të sferës së mbrojtjes sociale në vitin 2008. Raporti mundëson kontroll komparativ për vitet 2007 dhe 2008 dhe kontroll komparativ të të dhënave të fituara nga Ministria e punës dhe politikës sociale (të dhënat për numrin e përdoruesve të ndihmës së vazhdueshme në të holla janë dhënë në Tabelën 3, ndërsa ato për numrin e përdoruesve të ndihmës sociale në të holla, janë dhënë në Tabelën 6).

Në dallim nga sqarimet e arsyeve për ndërprerje të të drejtës së ndihmës sociale për përdoruesit, në Raport mungojnë të dhënat për strukturën, përfshirjen dhe strukturën gjinore të përdoruesve që në mënyrë kundërligjore kanë fituar të holla, nëpërmjet kategorive të ndryshme të ndihmës sociale.

4.1 PËRSHKRIMI I TË DREJTËS SË NDIHMËS SË VAZHDUESHME NË TË HOLLA

Emri i të drejtës së ndihmës sociale: E drejta e ndihmës së vazhdueshme në të holla

Institucioni kompetent për realizim të të drejtës së ndihmës sociale: MPPS dhe Qendrat e punëve sociale.

Qëllimet: Qëllimet e të gjitha të drejtave në sferën e ndihmës sociale kanë të bëjnë me zvogëlimin e varfërisë dhe mbrojtjen nga përjashtimi social. Ashtu si të

drejtat e tjera, e drejta e ndihmës së vazhdueshme në të holla definohet nëpërmjet përdoruesve, përkatësisht nëpërmjet grupeve qëllimore të përshkruara më poshtë.

Përshkrimi i shkurtër i të drejtës së ndihmës sociale: Duke e marrë parasysh karakterin social të vendit tonë dhe kujdesin e tij për realizim të parimeve të humanizmit dhe drejtësisë sociale, e drejta e ndihmës së vazhdueshme në të holla paraqet aktivitet permanent i institucioneve kompetente për realizim të mbrojtjes sociale, që nga pavarësia e vendit deri më sot. Kjo e drejtë nënkupton ndihmë në të holla për personat që nuk janë të aftë për punë dhe për personat që nuk janë të siguar nga aspekti social, të cilët nuk mund të sigurojnë mjete për ekzistencën e tyre në bazë të rregullave të tjera.

Grupet qëllimore: Në përputhje me Ligjin për mbrojtje sociale, si përdorues të këtij lloji të ndihmës shfaqen gjashtë kategori të caktuara të qytetarëve që nuk janë të aftë për punë dhe që nuk janë siguar nga aspekti social²¹. Bëhet fjalë për persona me probleme të lehta, të rënda dhe tepër të rënda mendore, persona me probleme fizike, grua kryefamiljare, një muaj para lindjes, prindër kryefamiljarë, deri në moshën trevjeçare të fëmijës, fëmijë deri në moshën 15-vjeçare ose 26-vjeçare, gjatë shkollimit të rregullt, dhe grua ose burrë mbi 65 vjet.

Paaftësia për punë vërtetohet nga organ kompetent, i cili i vlerëson nevojat specifike të personave me probleme intelektuale ose fizike, deri në moshën 26-vjeçe. Për personat mbi 26 vjet vlerësimi bëhet nga Komision profesional, i cili jep konstatim, vlerësim dhe mendim për vërtetim të paaftësisë për punë.

Si person i pasiguar nga aspekti social konsiderohet personi i cili nuk ka të ardhura ose të ardhurat e përgjithshme të të cilit, si të ardhura të familjes, janë më të vogla se ndihma e përhershme sociale, e paraparë me ligj.

Shuma e ndihmës së vazhdueshme në të holla përcaktohet sipas rrogës mujore mesatare neto për punonjësit në Republikën e Maqedonisë, që është ndarë gjatë vitit të kaluar. Sipas kësaj, ndihma sociale në të holla për përdorues-person që jeton vet është 20% ose 3.219,00 denarë, për personin i cili ndihmën e ndan me një tjetër person ajo është 28% ose 4.507,00 denarë, ndërsa për dy persona, të cilët ndihmën e ndajnë me persona të tjerë ajo është 40% ose 6.438,00 denarë²².

Aktivitete dhe masa (mënyra e realizimit të të drejtës dhe procedura)

Procedura për realizim të të drejtës së ndihmës së vazhdueshme në të holla është e njëjtë me të drejtat e tjera të ndihmës sociale. Ajo inicohet me kërkesë të personit ose përfaqësuesit e tij ligjor, tutorit ose nëpërmjet detyrimit ligjor. Vendim në shkallë të parë për kërkesën për realizim të të drejtës sjell Qendra e punës sociale, e cila është kompetente për rajonin në të cilin jeton parashtuesi i kërkesës.

Për ankesën kundër vendimit të Qendrës sociale vendos ministri edhe pse ankesa nuk e anulon realizimin e vendimit. Kundër vendimit të shkallës së dytë mund të ngrihet kontest administrativ para Gjykatës administrative të Republikës së Maqedonisë.

Gjatë shqyrtimit të dokumenteve nga sfera e ndihmës sociale të përdoruesve

21 Në Ligjin për mbrojtje sociale, i muajit qershor të vitit 2009, kategoritë e përdoruesve mbeten të pandryshuara, por janë bërë ndryshime në përkufizimin e tyre. Me ndryshimet, si person i paaftë për punë konsiderohet personi: me probleme të lehta, të rënda dhe tepër të rënda mendore, personi me probleme të kombinuara dhe probleme të tjera, i cili për shkak të shkallës së problemeve nuk mund të arsimohet, personi me probleme fizike, për shkak të të cilave nuk është i aftë për punë, personi me të meta mendore, personi me probleme të vazhdueshme shëndetësore, për shkak të të cilave nuk është i aftë për punë, grua kryefamiljare, një muaj para lindjes, prindi kryefamiljar, në përputhje me Ligjin për familje, deri në moshën 3-vjeçare të fëmijës, fëmija pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, të cilit nuk i mundësohet mbrojtje në bazë të të drejtës së akomodimit dhe i cili nuk ka të ardhura në bazë të pronësisë dhe të drejtave të pronësisë dhe nuk siguron mjete në bazë të rregullave të tjera, më së voni deri në moshën 18-vjeçare dhe në moshën 65-vjeçare për personat e moshuar.

22 Shuma e ndihmës sociale, MPPS, <http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/Visinata%20na%20pravata-za%202009g.doc>

konstatuam një sërë rregulloresh të cilët e rregullojnë realizimin e të drejtave të veçanta, por nuk gjetëm rregullore me të cilën rregullohet realizimi i të drejtës së ndihmës së vazhdueshme në të holla, gjatë periudhës e cila ka qenë objekt i analizës sonë. Realizimi i të drejtës së ndihmës së vazhdueshme në të holla është rregulluar vetëm më anë të Ligjit për mbrojtje sociale (nga viti 1997), në të cilin janë përcaktuar më saktë kriteret për realizim të të drejtës dhe shuma e ndihmës. Kjo gjendje është ndryshuar me sjelljen e Rregullores për mënyrën e realizimit të të drejtës së ndihmës së vazhdueshme në të holla²³, e cila është sjellë në shtator të vitit 2009 dhe me anë të të cilës në të ardhmen do të rregullohet kjo materie.

Njëkohësisht, duhet theksuar se në kuadër të realizimit të këtij lloji të ndihmës në të holla, nuk ekzistojnë prioritete midis kategorive të ndryshme të përdoruesve. Përkatësisht, të gjithë përdoruesit gjenden në rrezik social specifik dhe të gjithë kanë të drejtë të barabartë për realizimin e ndihmës, nëse i plotësojnë kriteret specifike të çdo grupi.

Përdoruesit potencial, në Qendrat e punëve sociale plotësojnë formular, kërkesë për realizimin/vazhdimin e të drejtës së ndihmës së vazhdueshme në të holla, në të cilin duhen përshkruar arsyet për shkak të të cilëve kërkohet ndihma. Bashkë me formularin/kërkesën duhen parashtruar edhe shumë dokumente të tjera, të cilat shkaktojnë vështirësi financiare ndaj përdoruesve potencial të kësaj të drejte dhe njëkohësisht shpenzojnë shumë kohë²⁴.

ANALIZA GJINORE E TË DREJTËS SË NDIHMËS SË VAZHDUESHME NË TË HOLLA DHE BUXHETI

Përdorues të ndihmës së vazhdueshme në të holla

Përdoruesit e ndihmës së vazhdueshme në të holla janë një ndër kategoritë më të rrezikuara të qytetarëve, të cilët për arsye të ndryshme nuk janë të aftë të punojnë dhe të sigurojnë mjete ekzistenciale. Gjatë kësaj vërehet diapazoni i gjerë i kategorive të ndryshme të përdoruesve, i cili përfshin gjashtë kategori të ndryshme të përdoruesve (të përmendura më sipër), duke filluar na personat me pengesa mendore ose fizike, deri tek gruaja kryefamiljare, një muaj para lindjes së fëmijës.

Sipas të gjitha gjasave, duke konsideruar se kjo gjendje do të vazhdojë për një kohë të shkurtër, përpiluesit e politikave të kësaj sfere kanë paraparë kufizime, pikërisht për gratë kryefamiljare në muajin e fundit të shtatzënisë dhe për prindërit kryefamiljarë, të cilët në pjesën më të madhe të rasteve janë gra. Për këto dy kategori të përdoruesve ekzistojnë kufizime në realizimin e të drejtës së ndihmës së vazhdueshme në të holla.

²³ Rregullore për mënyrën e realizimit të të drejtës së ndihmës së vazhdueshme në të holla ("Gazeta Zyrtare e RM", nr. 79/09)

²⁴ Në përputhje me nenin 4 të Rregullores për mënyrën e realizimit të të drejtës së ndihmës së vazhdueshme në të holla (muaji shtator i vitit 2009), gjatë parashtrimt të kërkesës për ndihmë të vazhdueshme në të holla, në varësi të gjendjes familjare/materiale, për vetveten dhe për anëtarët e tjerë të familjes, parashtruesi i dorëzon dokumentet në vijim: fotokopje të letërnjoftimit të vlefshëm për shtetasit e Republikës së Maqedonisë, fotokopje të leje-qëndrimit për personat e huaj, fotokopje e letërnjoftimit për refugjatin ose fotokopje e letërnjoftimit për personin që është në mbrojtje humanitare ose subsidiare, fotokopje e certifikatës së lindjes, fotokopje e certifikatës së martesës, fotokopje e certifikatës së vdekjes, vërtetim nga Drejtoria e të hyrave publike për të ardhurat neto të paraqitura ose të realizuara, fletë pronësie nga Kadastru, vërtetim për të ardhurat e siguruara nga rroga, vërtetim për përdorim të pensionit (të fituar në Republikën e Maqedonisë ose jashtë vendit); vërtetim nga Agjencia e punësimit të Republikës së Maqedonisë për anëtarët e papunë të familjes, personi i papunë, i cili nuk është i regjistruar në evidencat e Agjencisë së punësimit të Republikës së Maqedonisë parashtron listë me të dhënat e stazhit të punës, aktvendim se është person me përkujdesje. Sigurimi i një pjese të dokumenteve, zakonisht kushton nga 150 deri në 200 denarë. Në raste të caktuara nevojiten edhe shumë dokumente të të njëjtit lloj (për shembull, certifikatë lindje për të gjithë anëtarët e familjes), ndërsa një pjesë e dokumenteve janë falas ose sigurohen nëpërmjet detyrimeve ligjore. Nëse këtyre shpenzimeve i shtohen edhe shpenzimet e rrugës deri në institucionet përkatëse (për shembull, në Qendrën përkatëse të punëve sociale, në Agjencinë e punësimit, në Kadastër etj.), mund të konstatohet se të njëjtat në masë të madhe shkaktojnë vështirësi financiare ndaj përdoruesve.

Edhe pse objekt i kësaj analize janë politikat që janë përpiluar në bazë të Ligjit të vjetër për mbrojtje sociale, kufizimet vërehen edhe në Ligjin e ri për mbrojtje sociale²⁵. Prindi kryefamiljar mund ta shfrytëzoj ndihmën gjatë tre viteve të para pas lindjes së fëmijës dhe vetëm për tre fëmijë. Dispozita e këtyre paraqet restriktion si për prindërit kryefamiljarë ashtu edhe për fëmijët e tyre. Praktika në terren tregon se zakonisht pas përfundimit të këtyre tre viteve, prindërit kryefamiljarë transferohen nga ndihma e vazhdueshme në të holla në ndihmën sociale në të holla²⁶. Transferimi i prindërve kryefamiljarë nga një kategori në një kategori tjetër (nga ndihma e vazhdueshme në të holla në ndihmën sociale në të holla) nuk do të thotë se ato përjashtohen nga sistemi i mbrojtjes sociale. Transferimi nënkupton se arritjen e moshës 3-vjeçare të fëmijës, prindi kryefamiljar nuk e gëzon të drejtën e ndihmës së vazhdueshme në të holla, edhe pse nuk ka burim të hollash dhe transferohet në kategori tjetër, të përfshirë në sistemin e mbrojtjes sociale, përkatësisht bëhet përdorues i ndihmës sociale në të holla. Në këtë drejtim duhet theksuar se gjatë transferimit të tillë, prindërit kryefamiljarë shpenzojnë një pjesë të mjeteve që i fitojnë si përdorues të ndihmës së vazhdueshme në të holla, duke pasur parasysh se shuma e ndihmës sociale në të holla është shumë më e vogël. Për shembull, përdoruesi i ndihmës së vazhdueshme në të holla, i cili e ndan ndihmën me dy ose më shumë përdorues të tjerë, gjatë vitit 2009 ka fituar 6.438,00 denarë, ndërsa ndihma sociale në të holla për një familje/amvisëri me tre anëtarë ka qenë 3.578,00 denarë, me tendencë për zvogëlim të periudhës së përdorimit (Tabela nr. 6).

Këtu duhet të theksohen përpjekjet e shtetit dhe politikat aktive qeveritare për punësim, me të cilat prindërit kryefamiljarë përfshihen në një pjesë të masave, me qëllim që të tejkalohet varësia afatgjate e prindërve kryefamiljarë nga ndihma sociale dhe ato të përforcohen nga aspekti ekonomik.

Kur bëhet fjalë për prindërit kryefamiljar, të cilët zakonisht janë gra, në përputhje me Ligjin e vjetër për mbrojtje sociale, alimentacioni konsiderohet si e ardhur e familjes dhe prandaj, personat e kësaj kategorie nuk mund të fitojnë ndihmë të vazhdueshme në të holla, sepse sipas Ligjit “fitojnë” të ardhura. Edhe pse me ndryshimet e këtij Ligji në vitin 2008 u përcaktuan ndryshime në këtë drejtim, me dispozitat e Ligjit të ri për mbrojtje sociale (qershor i vitit 2009), me nenin 59, si person i pasiguar nga aspekti material konsiderohet personi që nuk ka të ardhura ose të ardhurat e të cilit, të siguruar në çfarëdo lloj mënyre për çdo anëtar të familjes, janë më të vogla se 4000,00 denarë. Me rregulloren për mënyrën e realizimit të të drejtës së ndihmës së vazhdueshme në të holla, rregullohet gjendja e të ardhurave të kërkuesit të ndihmës, në bazë të të ardhurave të realizuara nëpërmjet: rrogës së paguar gjatë tre muajve të fundit para parashtrimit të kërkesës, pensionit (të fituar në Republikën e Maqedonisë ose jashtë vendit), kompensimit në të holla për shkak të papunësisë, të ardhurave të realizuara neto të paraqitura në Drejtorinë e të hyrave publike, të ardhurave nga përkrahja financiare në sferën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, të realizuara gjatë vitit të kaluar, pensionit ushtarak ose invalid, kursimeve ose interesave nga kursimi, sigurimit ose zotërimit të të ardhurave nga letrat me vlerë, të ardhurave të fituara nga puna e përkohshme jashtë vendit dhe nëpërmjet përkujdesjes ligjore. Në të njëjtin nen, midis kompensimeve, shtesave dhe ndihmave që nuk konsiderohen si burim të ardhurash, përmendet edhe përkujdesi ligjor për fëmijën, ndihma për të cilin arrin në 5000,00 denarë, e cila përshtatet me rritjen e shpenzimeve të jetesës për vitin e kaluar, të publikuara nga ana e Entit shtetëror të statistikave, në muajin janar të vitit aktual. Për shkak të mungesës së sistemit për vëzhgim të plotësisht të detyrimit ligjor për përkujdesje të fëmijës, prindi

25 Ligji për mbrojtje sociale, “Gazeta Zyrtare e RM” nr. 79 nga 24 qershor i vitit 2009, Neni 66

26 Konstatimi bazohet në informatat praktike të fituara gjatë intervistave jo standarde me përfaqësuesit e Entit për veprimtari sociale, i cili është kompetent për ligjshmërinë e punës së punonjësve profesional të Qendrave të punëve sociale, të realizuar më 02 dhe 18 qershor të vitit 2009

kryefamiljar mund të gjendet në situatë dyfish më të vështirë. Nga njëra anë, ndihma për përkujdesjen ndoshta nuk paguhet në kohë ose nuk paguhet në tërësi, ndërsa nga ana tjetër, parashtruesi, në bazë të aktvendimit për përkujdesje ligjore, mund të pengohet gjatë realizimit të të drejtës.

Lidhur me këtë kategori të përdoruesve, indikative është edhe pyetja në Listën/formularin për prindin kryefamiljar, të cilën e lëshon Enti për veprimtari sociale²⁷. Midis pyetjeve të dedikuara për nënën kryefamiljare, gjatë kohës së shtatzënisë, një muaj para lindjes, ajo duhet t'i përgjigjet pyetjes: Kush është babai i fëmijës? Parashtrohet pyetja për rëndësinë e kësaj pyetjeje dhe për pasojat ndaj integritetit të përdorueses së ndihmës. Mund të supozohet se edhe këtu pyetja është në funksion në alimentacionit ose supozimit se, nëse dihet identiteti i babait, gruaja kryefamiljare në të ardhmen do të fitoj të ardhura nëpërmjet alimentacionit.

Numri i përdoruesve të të drejtës së ndihmës së vazhdueshme në të holla

Për shkak të mungesës së të dhënave të sistematizuara, në të cilat përdoruesit do të sistematizohen sipas arsyeve për fitim të këtij lloji të ndihmës, nuk mund të dihet se sa përdorues, për shembull, janë persona me probleme të lehta, të rënda dhe tepër të rënda në zhvillimin mendor ose gra kryefamiljare që janë një muaj para lindjes së fëmijës.

Gjithashtu, mungojnë të dhënat në të cilat përdoruesit janë të ndarë sipas gjinisë. Nga aspekti i strukturës gjinore vetëm mund të supozohet se midis prindërve kryefamiljarë përdorues të ndihmës gjenden më shumë gra, duke pasur parasysh praktikën, sipas të cilës në këtë kategori më të pranishme janë gratë²⁸. Gjithashtu mungojnë të dhëna për përdoruesit për të cilët është qartë se duhet të fitojnë ndihmë, siç janë gratë kryefamiljare që gjenden në muajin e fundit të shtatzënisë. Bëhet fjalë për mungesë të sistemit në të cilin të dhënat do të grumbullohen dhe azhurnohen rregullisht.

Megjithatë, nëpërmjet përvajave të punonjësve social që merren me këtë problematikë në Qendrat e punëve sociale, mund të arrihet në konkluzionin se burrat më shpesh kanë parashtruar kërkesa për realizimin e kësaj të drejte. Arsyet për situatën e atillë janë vlerat tradicionale, shkalla e arsimit, niveli i njohjes së institucioneve dhe të drejtave. Por gjithashtu, konstatohet edhe trendi i pranishëm që kohëve të fundit gratë të jenë parashtrues më të shpeshtë të kërkesave. Arsyet për një gjë të tillë mund të kërkojnë në faktin se burrat shkojnë në punë jashtë shtetit, ndërsa gratë largimin e tyre nuk e paraqesin në qendrat e punëve sociale²⁹.

Siç është përmendur më sipër, MPPS nuk ka siguruar statistika të ndara sipas gjinisë për përdoruesit e ndihmës së vazhdueshme në të holla. Në këtë mënyrë pengohet zhvillimi i një analize më të gjerë buxhetore lidhur me këtë çështje.

Tabelat në vijim ofrojnë paraqitje të numrit të përgjithshëm të përdoruesve, shpenzimeve të përgjithshme dhe shpenzimeve për përdoruesit, por për fat të keq, këto të dhëna nuk mundësojnë analizë gjinore buxhetore, në të cilën përveç gjinisë, si parametra të rëndësishëm do të përfshihen, baza ligjore për fitimin e ndihmës, vjetërsia, përkatësia etnike dhe vendbanimi.

27 Lista/formulari për prindin kryefamiljar, Ekzemplari K.L.–16

28 Sipas Regjistrimit të vitit 2002, në kategoritë nënë me fëmijë, janë numëruar 31.074 amvisëri (79,7% nga numri i përgjithshëm i amvisërive) dhe 7.914 amvisëri (20,3%) ku jetojnë baballarë me fëmijë, nga numri i përgjithshëm i amvisërive me një prindër me fëmijë, i cili arrin në 38.988. Gjendja e tillë reflektohet edhe tek prindërit kryefamiljarë që janë përdorues të ndihmës së vazhdueshme në të holla.

29 Konstatimi bazohet në njohuritë praktike, të fituara nëpërmjet intervistave jo-standard, të mbajtura më 2 dhe 18 qershor, të vitit 2009, me përfaqësuesit e Entit për veprimtari sociale, i cili është kompetent për ligjshmërinë e punës së punonjësve profesional të Qendrave të punëve sociale.

Tabela nr. 3 Ndhimja e vazhdueshme në të holla: Numri i përdoruesve

Viti	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Mesatarja	5879	4890	4913	4966	5129	5176	5016	4871	5016	5033	5140

Burimi: MPPS

Tabela nr. 4: Ndhimja e vazhdueshme në të holla: Shpenzimet (në milionë denarë)

Viti	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Mesatarja	12	11	12	13	14	14	15	16	15	16	18

Burimi: MPPS

Tabela nr. 5 Ndhimja e vazhdueshme në të holla: Shpenzimet sipas përdoruesve

Viti	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Mesatarja	2.019,00	2.280,00	2.425,00	2.636,00	2.819,00	2.770,00	3.034,00	3.308,00	3.048,00	3.195,00	3.513,00

Burimi: MPPS

Nëpërmjet Tabelës 3 mund të konstatohet se, nga viti në vit, ekziston ndryshim në numrin e përdoruesve. Ajo që vërehet më shumë është se brenda 10 viteve, numri i përgjithshëm i përdoruesve është i zvogëluar për 739 ose 12,6%. Nga ana tjetër vërehet se nga viti 2005 sërish shfaqet trendi i rritjes së numrit të përdoruesve. Mungojnë të dhëna analitike, nëpërmjet të cilave mund të mësohen shkaqet për situatën e atillë dhe nëse ajo e reflekton nevojën reale të përdoruesve të kësaj tre drejte.

Në Tabelat nr. 4 dhe 5 duket qartë rritja e shpenzimeve të përgjithshme për këtë lloj të ndihmës sociale, si dhe shpenzimet sipas përdoruesve. Rritja është konstatuar falë mënyrës së përlogaritjes së vlerave, të cilat vërtetohen nëpërmjet rrogës mujore mesatare neto për një punonjës në Republikën e Maqedonisë, gjatë tre muajve të fundit: për përdorues që jeton vetë është 20%, për përdorues që e ndan ndihmën me një person tjetër është 28% dhe për përdorues që e ndan ndihmën me më shumë përdorues të tjerë është 40%.

Për vitin 2009 janë paraparë shumat në vijim: 3.219,00 denarë për përdorues që jeton vetë, 4.507,00 denarë për përdorues që e ndan ndihmën me një person tjetër dhe 6.438,00 denarë për përdorues që e ndan ndihmën me më shumë përdorues të tjerë. Nëse do të përlogaritet shuma mesatare sipas përdoruesve, mund të fitohet shuma prej 4721 denarë, që deri më tani paraqet rritje më e madhe mesatare prej 1208 denarë.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- ◆ Nuk ekziston sistem për grumbullim, azhurnim dhe analizim të të dhënave për përdoruesit e të drejtës së ndihmës së vazhdueshme në të holla. Gjithashtu mungojnë edhe të dhënat e sistematizuara në të cilat përdoruesit do të ndahen sipas bazës ligjore për fitim të ndihmës së vazhdueshme në të holla, si dhe informata analitike për numrin e përdoruesve, të ndarë sipas indikatorëve të ndryshëm–gjinisë, moshës, arsimit, vendbanimit dhe përkatësisë etnike. Sigurimi i këtyre të dhënave për përdoruesit do t'u mundësoj pamje më të qartë përpiluesve të politikave, që ato t'i dimensionojnë drejt aktivitetet e parapara, të orientuara drejt kategorive të ndryshme të përdoruesve dhe do të shërbejnë si bazë për planifikim të buxhetit për këtë lloj ndihme.
- ◆ Prandaj rekomandojmë që gjatë krijimit të bazave të të dhënave, pjesë e tyre përbërëse të jenë: baza ligjore për realizimin e të drejtës së ndihmës së vazhdueshme në të holla, gjinia, moshë, arsimit, vendbanimi dhe përkatësia etnike e përdoruesve

të ndihmës së vazhdueshme në të holla, si dhe mundësia për kryqëzimin e tyre. Gjithashtu, këto baza me të dhëna duhen azhurnuar rregullisht, me qëllim që të bëhet i mundur kontrolli i gjendjes.

Politika sociale në sferën e mbrojtjes sociale nuk i merr parasysh sa duhet dallimet gjinore, të cilat vazhdojnë të kenë implikime të mëdha në statusin social të qytetarëve.

- ◆ Në këtë kontekst nevojitet përfshirje të dimensionit gjinor në përgatitjen, realizimin dhe vlerësimin e efekteve dhe në ndikimin e politikave të ndihmës sociale, me qëllim që të plotësohen nevojat dhe interesat e ndryshme të përdoruesve.

Prindërit kryefamiljarë janë kategori e ndjeshme, e cila mund ta përdor këtë të drejtë me kufizime, gjatë tre viteve pas lindjes së fëmijës dhe për tre fëmijë. Prandaj, e pranishme është praktika që prindërit kryefamiljarë, pas përfundimit të vitit të treta të transferohen nga ndihma e vazhdueshme në të holla në ndihmën sociale në të holla.

Nevojitet tejkalim të këtyre dispozitave, të cilat paraqesin restriksion si për prindërit kryefamiljarë, ashtu edhe për fëmijët e tyre. Gjithashtu, nevojitet implementimi i beneficioneve të caktuara, me të cilat do të lehtësohet aksesin në shërbime të caktuara (kopshtet e fëmijëve, çerdhet). Duhet të vazhdojnë përpjekjet nga ana e shtetit, për përfshirje aktive të prindërve kryefamiljarë në tregun e punës, nëpërmjet masave aktive për punësim.

- ◆ Alimentacioni, nëse është mbi 5000 denarë për fëmijë, akoma paraqet pengesë për realizimin e të drejtës së ndihmës së vazhdueshme në të holla për përdoruesit e kategorisë prindër kryefamiljar të fëmijës deri në moshën 3-vjeçare.

Në mënyrë decide rekomandojmë të shfuqizohet dispozita ligjore sipas të cilës, përkujdesi ligjor (alimentacioni) mbi 5000 denarë për fëmijë akoma merret parasysh gjatë përlogaritjes së të ardhurave të personave që kërkojnë të jenë përdorues të ndihmës së vazhdueshme në të holla.

- ◆ Pjesëmarrësit në krijimin, realizimin dhe vlerësimin e efekteve të politikave të ndihmës sociale, sidomos punonjësit e Qendrave të punëve sociale, të cilët punojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me përdoruesit potencial dhe aktual të ndihmës së vazhdueshme në të holla, duhet të jenë jashtëzakonisht sensitiv ndaj çështjeve gjinore që i tangojnë të gjashtë kategoritë e veçanta të përdoruesve.

Prandaj, nevojiten trajnime (masa dhe instrumente të tjera) të kuadrove, që do t'i përkushtohen nevojave gjinore specifike, me qëllim që të mundësohet aksesin në njëjtë në shërbimet dhe respektim të integritetit të përdoruesit.

4.2 E DREJTA E NDIHMËS SOCIALE NË TË HOLLA

Emri i të drejtës së ndihmës sociale: E drejta e ndihmës sociale në të holla

Institucioni kompetent për realizim të të drejtës së ndihmës sociale: MPPS dhe Qendrat e punëve sociale

Qëllimet: Ashtu siç është përmendur më sipër, qëllimet e të gjitha të drejtave në sferën e ndihmës sociale kanë të bëjnë me zvogëlimin e varfërisë dhe mbrojtjen nga përjashtimi social. Ashtu si të drejtat e tjera, e drejta e ndihmës sociale në të holla definohet nëpërmjet përdoruesve, përkatësisht nëpërmjet grupeve qëllimore të përshkuara më poshtë.

Përshkrimi i shkurtër i të drejtës së ndihmës sociale: Me thellimin e krizës socio-ekonomike, përpiluesit e politikës sociale e konstatuan nevojën e sjelljes së kategorisë së re të ndihmës sociale, e dedikuar për qytetarët e aftë për punë, por të

goditur nga pasojat e kapacitetit të zvogëluar të shoqërisë për ruajtje të vendeve aktuale të punës dhe për hapje të vendeve të reja të punës. Në rrethana të tilla, nga mesi i viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar, midis të drejtave të ndihmës sociale u përfshi edhe ndihma sociale në të holla.

Grupet qëllimore: Të drejtën e ndihmës sociale në të holla mund ta gëzojnë persona të aftë për punë por të pasiguar nga aspekti social, të cilët sipas rregullave të tjera nuk mund të sigurojnë mjete ekzistenciale.

Aktivitete dhe masa (mënyra e realizimit të të drejtës dhe procedura): Mënyra e përcaktimit të personit që ka të drejtë ta përdor ndihmën sociale në të holla është paraparë me Rregullore të veçantë. Në këtë Rregullore është paraparë mënyra e përcaktimit të përdoruesit të të drejtës së ndihmës sociale në të holla, paraqitja e të ardhurave të personit, familjes ose amëvisërisë, gjatë parashtrimit të kërkesës për realizimin e të drejtës dhe dokumentacioni i nevojshëm për vërtetimin e gjendjes së të ardhurave³⁰.

Në bazë të Rregullores, e cila është përgatitur në bazë të Ligjit të mëparshëm për mbrojtje sociale, përdoruesi i të drejtës së ndihmës sociale në të holla zgjidhet sipas kushteve në vijim: Nëse brenda familjes ka person të punësuar, përdorues i ndihmës do të jetë personi i punësuar; në familjet në të cilat nuk ka person të punësuar por ka përdorues të ndonjë pensioni–përdorues i ndihmës do të jetë përdoruesi i pensionit; në familjet në të cilat nuk ka person të punësuar ose përdorues pensioni–përdorues i ndihmës do të jetë personi i papunësuar; në familjet në të cilat nuk ka person të punësuar, përdorues pensioni ose person i papunësuar, por brenda tyre ka përdorues të ndihmës së vazhdueshme në të holla–përdorues i ndihmës do të jetë personi që përdor ndihmë të vazhdueshme në të holla; ndërsa për të gjitha familjet e tjera, Qendra përkatëse e punëve sociale e cakton përdoruesin e ndihmës sociale në të holla. Qendra e punëve sociale do të caktoj person të familjes ose amvisërisë në rastet kur përdoruesi i të drejtës nuk është në gjendje t'i plotësoj obligimet e tij (person joadekuat për shkak të analfabetizmit, alkoolizmit, narkomanisë, sjelljes së dhunshme, përfshirjes në aktivitetet kriminale etj).

Në të njëjtën Rregullore, shuma e ndihmës sociale në të holla, e shprehur në përqindje, përcaktohet në bazë të rrogës mujore mesatare neto për punëtor, të paguar në Republikën e Maqedonisë, gjatë vitit të kaluar. Ndhimja sociale në të holla për një person është 13,50%, për familjet dhe amvisëritë me dy anëtarë është 17,46%, për familjet dhe amvisëritë me tre anëtarë 22,23%, për familjet dhe amvisëritë me katër anëtarë 28,58% dhe për familjet dhe amvisëritë me pesë anëtarë e sipër, ajo është 33,34%. Nga ana tjetër, shuma e ndihmës sociale në të holla përcaktohet në varësi të periudhës së përdorimit: gjatë dy viteve të para ndihma fitohet në shumë të plotë, gjatë vitit të tretë, të katërt dhe të pestë paguhen 70% të shumës fillestare, ndërsa pas përfundimit të vitit të pestë e më tej, paguhen 50% të shumës fillestare.

Tabela nr. 6 Shuma e ndihmës sociale në të holla për vitin 2009

	100%	70%	50%
Një person	2.173,00 den.	1.521,00 den.	1.086,50 den.
Familje dhe amvisëri me dy anëtarë	2.810,50 den.	1.967,00 den.	1.405,00 den.
Familje dhe amvisëri me tre anëtarë	3.578,00 den.	2.505,50 den.	1.789,00 den.
Familje dhe amvisëri me katër anëtarë	4.600,00 den.	3.220,00 den.	2.300,50 den.
Familje dhe amvisëri me pesë anëtarë e sipër	5.366,50 den.	3.756,50 den.	2.683,00 den.

Burim MPPS

30 Rregullorja mund të gjendet në http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/pravilnik_soc.pdf

Me sjelljen e Ligjit për mbrojtje sociale, në qershor të vitit 2009, janë sjellë parametra të reja, si në përcaktimin e përdoruesit të ndihmës, ashtu edhe në përcaktimin e shumës së ndihmës sociale në të holla, sipas madhësisë së amvisërive dhe kohëzgjatjes së pranimit të ndihmës.

Në përputhje me këtë ligj, si person dhe familje e pasiguar konsiderohen ai person dhe familje të ardhurat e të cilave janë më të vogla se shumata e ndihmës sociale në të holla dhe ato të cilat nuk kanë pasuri dhe të drejta të lidhura me pasurinë, nga të cilat mund të ekzistojnë. Të ardhurat mujore të personit ose familjes përcaktohen sipas të ardhurave mesatare mujore të të gjithë anëtarëve, të siguruara në të gjitha mënyrat, gjatë tre muajve para parashtrimit të kërkesës për ta gëzuar të drejtën e ndihmës sociale në të holla. Përdoruesi i të drejtës së ndihmës sociale në të holla përcaktohet sipas kriterëve në vijim: për familjen në të cilën ka një person të punësuar–përdorues i ndihmës do të jetë personi i punësuar; në familjet në të cilat nuk ka person të punësuar por ka përdorues të ndonjë pensioni–përdorues i ndihmës do të jetë përdoruesi i pensionit; në familjet në të cilat nuk ka person të punësuar ose përdorues pensioni–përdorues i ndihmës do të jetë personi i papunësuar; ndërsa në të gjitha familjet e tjera Qendra përkatëse e punëve sociale e cakton përdoruesin e ndihmës sociale në të holla. Mbetet dispozita sipas të cilës Qendra e punëve sociale do të caktoj person të familjes ose amvisërisë në rastet kur përdoruesi i të drejtës nuk është në gjendje t'i plotësoj obligimet e tij (person joadekuat për shkak të analfabetizmit, alkoolizmit, narkomanisë, sjelljes së dhunshme, përfshirjes në aktivitetet kriminele etj).

Shumata e tanishme që ndahet si ndihmë sociale në të holla është 2.140 denarë dhe paraqet bazë e cila rritet me koeficient 0,37 për çdo anëtar të familjes, por më së shumti deri në pesë anëtarë. Ndihma sociale në të holla përshtatet me rritjen e shpenzimeve për jetesë gjatë vitit të kaluar, të publikuara nga ana e Entit shtetëror të statistikave, në janar të vitit aktual.

Lidhur me periudhën e përdorimit të ndihmës sociale në të holla, shumata e përcaktuar e ndihmës fitohet gjatë tre viteve të para, ndërsa më vonë fitohen vetëm 50% të së njëjtës. Me dispozitat e mëparshme ligjore ishte paraparë që 50% të fitohen pas vitit të pestë të pranimit të ndihmës sociale në të holla³¹.

ANALIZA GJINORE E TË DREJTËS SË NDIHMËS SOCIALE NË TË HOLLA DHE BUXHETI

Në politikën e mbrojtjes sociale vërehet trendi gjithnjë e më i madh i transferimit nga përdorimi pasiv i ndihmës sociale drejt aktivizimit të përdoruesve të ndihmës sociale. Në Ligjin për mbrojtje sociale, i sjell në qershor të vitit 2009, në nenin 55, parashihet që përdoruesit e ndihmës sociale në të holla të angazhohen në punë, për kryerje të punëve publike, deri në 5 ditë në muaj si dhe për realizim të punëve sezonale dhe punëve të tjera të përkohshme, nga ana e Kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes lokale, nga ana e ndërmarrjeve dhe institucioneve publike dhe gjatë kësaj të mos u ndalohej drejta e ndihmës sociale në të holla. Gjatë angazhimit të përdoruesve të ndihmës deri në 5 ditë brenda muajit, e drejta e ndihmës sociale në të holla nuk u ndërpritet, ndërsa përdoruesve që janë angazhuar në punë sezonale dhe në punë të tjera, mbi 5 ditë në muaj, e drejta e ndihmës sociale në të holla u ndërpritet gjatë kohës kur janë angazhuar në punë, ndërsa pas përfundimit të angazhimit punues, vazhdojnë të marrin ndihmë sociale në të holla. Këtu duhet theksuar se, sipas të njëjtit nen, kjo dispozitë vlen për të gjitha kategoritë e përdoruesve, përveç për pensionistët, gratë shtatzëna, nënat e reja, gjatë nëntë muajve të pushimit të lindjes, për personat e paaftë për punë për shkak të

31 Ligji për mbrojtje sociale, nenet 46, 47 dhe 48, "Gazeta Zyrtare e RM" nr. 79 nga 24 qershor i vitit 2009

moshës, invaliditetit ose sëmundjes dhe për personat në marrëdhënie pune, nxënësit dhe studentët.

Duhet të theksohet se bëhet fjalë për dispozitë pozitive, e orientuar drejt mbrojtjes së kategorive më të ndjeshme të përdoruesve dhe sensitive ndaj gjinive, sepse e merr parasysh gjendjen specifike të grave shtatzëna dhe nënave të reja që kanë leje lindje në kohëzgjatje prej 9 muajsh.

Mundësia ligjore për angazhim të përdoruesve të ndihmës sociale në të holla në kryerjen e punëve publike deri në 5 ditë në muaj dhe për realizim të punëve sezonale dhe punëve të tjera të përkohshme, jep mundësi për: së pari, për angazhimin e përdoruesve në punë, për të fituar më shumë të holla sesa ndihma sociale në të holla, së dyti, jepet mundësi për koordinim dhe bashkëpunim më të mirë midis Kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjeve publike dhe Qendrave të punëve sociale. Në këtë drejtim, për shembull, nëse subjektet që i kanë angazhuar përdoruesit e ndihmës kanë të dhëna të ndara sipas gjinisë, në spektrin e punëve sezonale dhe komunale, përveç angazhimit të meshkujve në punët tradicionale "mashkullore", mund të parashihet edhe angazhimi i grave. Në atë mënyrë, gratë përdoruese të ndihmës sociale në të holla, për të cilat nuk vlen lirimi nga angazhimi për shkak të shtatzënisë ose lejes së lindjes, nuk do të gjenden në pozitë për ta refuzuar angazhimin, duke e humbur të drejtën e ndihmës dhe mund t'i shfrytëzojnë dobitë eventuale nga angazhimi në punë.

Me qëllim që masat e ndërmarra për aktivizim të përdoruesve të përshtaten me nevojat dhe mundësitë e tyre, me rëndësi të madhe është njohja e profilin të përdoruesve. Nga ana tjetër nevojitet evidentimi i tyre i saktë dhe gjithëpërfshirës, duke e pasur parasysh faktin se bëhet fjalë për grupin më të madh të përdoruesve, për të cilët nga buxheti i përgjithshëm për ndihmë sociale, gjatë tre viteve të fundit, ndahen midis 55% dhe 60% (Shikoni Tabelën 2). Edhe pse në MPPS janë duke u mbajtur një sërë statistikash për përdoruesit e ndihmës sociale, si në rastin e ndihmës së vazhdueshme në të holla, statistikatat nuk janë ndarë sipas gjinisë. Prandaj, mund të fitohen të dhëna për parametrat e ndryshëm, të cilët janë me rëndësi të madhe për identifikimin e këtij grupi qëllimor dhe për aktivizimin e tij të mëtejshëm. Më saktë, mund të fitohen të dhëna për: përkatësinë etnike, statusin ekonomik të përdoruesit, arsimin, numrin e viteve gjatë të cilave e përdor ndihmën sociale, por jo edhe statistika të ndara sipas gjinisë, të cilat jo vetëm që janë të rëndësishme gjatë përpilimit të politikave të orientuara drejt përdoruesve, por paraqesin edhe detyrim ligjor³², duke u bërë aspekt i detyrueshëm gjatë grumbullimit të të dhënave. Këtu duhet theksuar se edhe kundrejt përpjekjeve të mëdha të Sektorit për mundësi të barabarta, këto të dhëna nuk u siguruan deri në përfundimin e kësaj analize!

Para se t'i prezantojmë statistikatat e MPPS, do t'i paraqesim të dhënat e Entit shtetëror të statistikave³³, në të cilat janë dhënë të dhënat për përdoruesit e ndihmës sociale në të holla, përkatësisht përdoruesit e familjeve, të ndarë sipas gjinisë. Të dhënat janë për vitet 2004, 2005 dhe 2006. Në vitin 2004, vetëm 21% të përdoruesve të familjeve kanë qenë gra ose 13.803, krahasuar me 53.457 burra. Në vitin 2005 kjo përqindje është zvogëluar në 19% përdorues të gjinisë femërore, të cilat kanë qenë në rolin e përdoruesve të ndihmës sociale ose 12.939 gra, krahasuar me 53.979 burra. Në vitin 2006 numri i grave ka qenë 13.011 ose 20%, krahasuar me 53.325 burra përdorues

32 Ligji për mundësi të barabarta, Gazeta Zyrtare e RM nr. 66/06 nga 29.05.2006, Neni 20, Kuvendi, Qeveria, Organet e administratës shtetërore, Organet gjyqësore dhe Organet e tjera shtetërore, Organet e njësisë së vetëqeverisjes lokale, Personat juridik, të cilëve me ligj u është besuar realizimi i veprimtarive me interes publik, Shoqatat civile, Fondacionet, Ndërmarrjet publike, Institucionet arsimore, Institucionet e sferës së mbrojtjes sociale, Institucionet shëndetësore, Partitë politike, Mjetet e informimit publik, Shoqëritë tregtare dhe Subjekte të tjera që janë obliguar të grumbullojnë, evidentojnë dhe përpunojnë të dhëna statistikore, janë të detyruara që këto të dhëna për resurset njerëzore t'i publikojnë sipas përkatësisë gjinore.

33 *Gratë dhe burrat në Maqedoni*, Enti shtetëror i statistikave, Shkup, viti 2008

të ndihmës në familjet³⁴.

Tabela nr. 6 Ndhma sociale në të holla: Numri i përdoruesve

Viti	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Mesatarja *	49.955	63.812	72.722	74.720	78.654	61.813	64.804	67.113	64.970	64.143	57.687
Mesatarja **							67.260	66.918	66.336		
Diferenca në numrin e përdoruesve ESHS-MPPS							2.456	-195	1.366		

*Burimi: MPPS **Burimi ESHS

Tabela nr. 7 Ndhma sociale në të holla: Numri i përdoruesve të ndarë sipas gjinisë

Viti	Numri i familjeve			Pjesëmarrja në përqindje	
	Gjithsej	Gra	Burra	Gra	Burra
2004	67.260	13.803	53.457	21%	79%
2005	66.918	12.939	53.979	19 %	81%
2006	66.336	13.011	53.325	20 %	80 %

Burimi: ESHS

Tabela nr. 8 Ndhma sociale në të holla: Shpenzimet e përgjithshme (në milionë denarë) dhe shpenzimet sipas përdoruesve (në mijë denarë)

Viti	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Mesatarja e shpenzimeve të përgjithshme	152	197	195	184	189	139	139	147	140	142	132
Shpenzimet sipas përdoruesve	3.048,00	3.094,00	2.677,00	2.457,00	2.403,00	2.246,00	2.149,00	2.186,00	2.158,00	2.207,00	/

Burimi: MPPS

Në dallim nga trendi i uljes së numrit të përdoruesve të ndihmës së vazhdueshme në të holla, gjatë dhjetë viteve të fundit, kur bëhet fjalë për numrin mesatar mujor të përdoruesve të ndihmës sociale në të holla, vërehet se në vitin 2008 numri i tyre është zvogëluar, si gjatë vitit të kaluar ashtu edhe gjatë viteve kur i njëjti ka qenë më i madh. Në vitin 2008 janë regjistruar 57.687 përdorues, ndërsa në vitin 1998 numri i përdoruesve ka qenë 49.955, që paraqet rritje prej 7.732 përdorues të ndihmës sociale në të holla ose 13.4 %. Me anë të këtyre të dhënave arrihet në konkluzionin se, nëse numrin e përdoruesve të ndihmës sociale në të holla do ta marrim si indikator të popullatës së rrezikuar dhe të aftë për punë, sot gjendja sociale është më e keqe se në vitin 1998.

Nga ana tjetër, vërehet se shpenzimet e përgjithshme mesatare, të cilat ndahen për ndihmë sociale në të holla si dhe shumat mesatare mujore për përdoruesit, janë duke u zvogëluar. Besohet se situata e tillë është si pasojë e numrit gjithnjë e më të madh të përdoruesve, të cilat të drejtën e ndihmës sociale në të holla e përdorin në një afat të gjatë kohor, gjatë të cilit është duke u zvogëluar shumë e ndihmës. Sipas të dhënave të MPPS, në vitin 2007, të drejtën e ndihmës sociale në të holla, më shumë se gjashtë vjet e kanë përdorur 35.7% të përdoruesve. Kjo gjë edhe më shumë tregon se përpjekjet për aktivizim të popullatës së aftë për punë dhe të pasiguar nga aspekti social duhen përforcuar dhe të njëjtat duhen orientuar në drejtim të përfshirjen e saj në tregun e punës.

Nga ana tjetër, nëse kjo gjë vendoset në kontekstin e çështjeve gjinore, është evident përfaqësimi më i vogël i grave përdoruese të kësaj të drejte.

34 Ky prezantim është dhënë në Tabelën nr. 6 (në të cilën është paraqitur dallimi në numrin e përdoruesve sipas të dhënave të ESHS dhe MPPS) dhe në Tabelën nr. 7

Sa për ilustrim i kryqëzuar të dhënat e Entit shtetëror të statistikave për përdoruesit, të ndarë sipas gjinisë (edhe pse ekziston dallim, krahasuar me të dhënat e MPPS të paraqitura në Tabelën 6, i cili mund të shkaktoj implikime në buxhetin e përgjithshëm për këtë lloj ndihme) me shumën mesatare të paguara gjatë viteve 2004, 2005 dhe 2006, të paraqitura në Tabelën 9.

Tabela 10 Paraqitje/Ilustrim të shumave mesatare të paguara si ndihma sociale në të holla, gjatë viteve 2004, 2005 dhe 2006, Ndarja gjinore

Viti	Shpenzimet sipas përdoruesve	Numri i familjeve / Shpenzimet e përgjithshme për përdoruesit sipas gjinisë					Pjesëmarrja në përqindje	
		Gjithsej	Gra	Shpenzime	Burra	Shpenzime	Gra	Burra
2004	2.149,00	67.260	13.803	29.662.647,00	53.457	114.879.093,00	21%	79%
2005	2.186,00	66.918	12.939	28.284.654,00	53.979	114.867.312,00	19 %	81%
2006	2.158,00	66.336	13.011	28.077.738,00	53.325	115.075.350,00	20 %	80 %

Edhe pse jemi të vetëdijshëm se paraqitja e këtyre shkakton ndryshime në shpenzimet e përgjithshme të paguara për këtë lloj ndihme (rreth 5.000.000 denarë, në vitin 2004, ulje rreth 1.000.000 denarë në vitin 2005 dhe rritje rreth 3 milion denarë, në vitin 2006), kjo paraqitje ka për qëllim ta prezantoj dallimin e madh të përdoruesve të ndihmës sociale në të holla, kur bëhet fjalë për strukturën gjinore.

Duke pasur parasysh se gratë dhe burrat e përjetojnë varfërinë në mënyrë të barabartë, duhet të na shqetësoj dallimi i madh, i cili e hap çështjen për praninë e vogël të grave përdoruese të ndihmës sociale në të holla. Më saktë, parashtrohen pyetjet: prania e vogël e grave si përdoruese të ndihmës sociale është si rezultat i rolit tradicional të burrave si persona që i sigurojnë të ardhurat e familjes ose gruaja nuk e pranon përgjegjësinë për të qenë përdoruese e ndihmës, për shkak të aktiviteteve të lidhura me shtëpinë dhe familjen. Kjo gjë mund të përkrahët edhe më një pjesë të analizës³⁵, e cila ka të bëjë me qëndrimet e burrave dhe grave në rastet e mungesës së të ardhurave. Popullata mashkullore, është e gatshme të angazhohet në punë plotësuese, në dallim nga gratë të cilat tradicionalisht janë të gatshme për t'i zvogëluar shpenzimet e tyre. Prandaj, besohet se në raste të caktuara gratë mund t'i menaxhojnë më mirë mjetet e vogla ekzistenciale. Këtu duhet theksuar edhe procedurata e ndërlikuar dhe dokumentacioni voluminoz, si dhe nevoja për vizita të shpeshta të Qendrave për punë sociale, të cilat përdoruesve u shpenzojnë shumë kohë. Në publikimin *Rrugës drejt BE-së*, procedura për marrje të ndihmës sociale në të holla në të gjitha vendet e rajonit është e përshkruar si jashtëzakonisht e ndërlikuar dhe e vështirë. "E ndërlikuar nga aspekti i dokumentacionit të nevojshëm i cili duhet të parashtrohet me qëllim që të fitohet ndihma sociale dhe e vështirë, për shkak të mjeteve materiale, të nevojshme për grumbullimin e dokumentacionit përkatës, të cilat shpesh konsiderohen si shpenzime ekuivalente me shumën e ndihmës sociale në të holla dhe me kushtet e parapara, siç janë: mungesa e automjetit, ngritja e procedurës së trashëgimisë, pranimi i alimentacionit etj.³⁶".

Për t'i zbuluar arsyet e disparitetit të qartë gjinor në numrin e përdoruesve të ndihmës, shkurtimisht do t'i rikthehemi Rregullores, sipas të cilës, në periudhën midis viteve 2004 dhe 2006, përcaktohej përdoruesi i të drejtës së ndihmës sociale në të holla dhe radhitja e tij. Qendra e punëve sociale përcakton përdorues vetëm për familjet në të cilat nuk ka person të punësuar; person që është përdorues pensioni; person i papunësuar; ose përdorues i të drejtës së ndihmës së vazhdueshme në të holla, si dhe në rastet kur përdoruesi i të drejtës nuk është në gjendje për t'i plotësuar detyrimet e

35 Raporti për paralajmërim në kohën e duhur, UNDP, 2007.

36 Rrugës drejt BE-së, Kontributi i shoqërisë civile në përpilimin e politikës për përfshirjen sociale në Republikën e Maqedonisë, MPPS, viti 2008

tij (persona joadekuat për shkak të analfabetizmit, alkoolizmit, narkomanisë, sjelljes së dhunshme, përfshirjes në aktivitetet kriminale etj.). Në këtë mënyrë prezantohet qartë gjendja e grave në familjet që kanë nevojë për ndihmë sociale. Nëse përqindja e grave përdoruese të kësaj të drejte, në periudhën midis viteve 2004 dhe 2006 ka qenë 19 % dhe 21 %, mund të konstatojmë se në numrin më të madh të familjeve ato nuk paraqiten si persona të punësuar, pensionist ose persona të papunë. Por, të dhënat e MPPS për statusin ekonomik të përdoruesve tregojnë se në vitin 2005, si përdorues të kësaj të drejte janë paraqitur 3.1 % persona të punësuar, nga të cilat 0.1 % kanë qenë pensionist, ndërsa 93.5 % kanë qenë persona të papunësuar. Gjatë këtij viti nuk janë evidentuar përdorues të ndihmës së vazhdueshme në të holla, të cilët janë shfaqur si përdorues të kësaj të drejte, ndërsa 3.3% kanë qenë përdorues të ndihmave të tjera. Në vitin 2006³⁷, 2% të përdoruesve kanë qenë të punësuar, nuk ka pasur pensionist, 97.2 %, kanë qenë persona të papunësuar, 0,1% kanë qenë përdorues të ndihmës së vazhdueshme në të holla, ndërsa 2,9% kanë qenë përdorues të ndihmave të tjera. Fakti që numri i personave të papunësuar që paraqiten si përdorues të ndihmave arrin në 95% në vitin 2006, e vërteton tezen për rolet tradicionale të burrave dhe grave në familje. Më saktë, edhe në rastet kur të dy gjinitë e përjetojnë në mënyrë të njëjtë varfërinë, rolet e tyre ndahen në mënyra të ndryshme.

Megjithatë, edhe kundrejt mungesës së të dhënave empirike lidhur me arsyet për dallimin a qartë në strukturën gjinore të përdoruesve të ndihmës sociale në të holla, shifrat tregojnë se gratë dhe burrat nuk kanë akses të barabartë si përdorues të kësaj të drejte. Në këtë drejtim duhen ndërmarrë aktivitete për përcaktim të balancuar të përdoruesve të ndihmës sociale në të holla. Sipas Rregullores për ndihmë sociale në të holla, i sjellë në shtator të vitit 2009, në nenin 7 është paraparë që, nëse nuk ka peron të punësuar, përdoruesi i të drejtës duhet ta konfirmoj statusin e personit të papunë për vetveten dhe për anëtarët e familjes së tij. Kjo do të thotë se, për shembull, nëse bëhet fjalë për bashkësi martesore, të dy bashkëshortët duhet rregullisht të evidentohen si të papunë. Prandaj, parashtrohet pyetja për sensibilizimin gjinor të punonjësve të Qendrave të punëve sociale, të cilët janë në komunikim direkt me përdoruesit potencial dhe të cilët duhet ta detektojnë rëndësinë e dimensionit gjinor. Edhe pse e gjithë familja duhet të ekzistoj nëpërmjet realizimit të kësaj të drejte (ato arrijnë në emrin e tij dhe vetëm ai mund t'i tërheq), akses në këto mjete financiare ka përdoruesi i të drejtës, por nuk ekzistojnë të dhëna për ndarjen e këtyre mjeteve në kuadër të familjes.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

- ◆ Ekzistimi i disparitetit të madh gjinor tek përdoruesit e ndihmës sociale në të holla rezulton me mendimin se burrat dhe gratë nuk kanë akses të barabartë si përdorues të ndihmës sociale në të holla. Për t'u tejkaluar kjo situatë, nevojitet që punonjësit e Qendrave për punë sociale të kenë ndjenjë të fortë për komponentin gjinor gjatë sjelljes së vendimeve. Me qëllim që të bëhet zgjidhja e drejtë e përdoruesit të kësaj të drejte, nevojitet të trajnohen kuadrot e Qendrave për punë sociale për sensibilizim lidhur me çështjet gjinore në familjet përdoruese të ndihmave sociale dhe në familjet potenciale.

Ligji për mbrojtje sociale paraqet bazë për transferim nga përdorimi pasiv i ndihmës sociale drejt aktivizimit të përdoruesve të ndihmës sociale.

³⁷ Edhe pse MPPS disponon me të dhëna të tilla edhe për vitin 2007, këto të dhëna nuk janë marrë parasysh sepse të dhënat e ESHS për përdoruesit e ndihmës, të ndara sipas gjinive, ekzistojnë vetëm për periudhën e viteve 2004-2006.

Me qëllim që masat e ndërmarra të përshtaten ndaj nevojave dhe mundësive të përdoruesve, si shumë e rëndësishme shfaqet nevoja për sigurim të të dhënave të ndara sipas gjinive.

- ◆ Edhe pse ekzistojnë të dhëna për përdoruesit e ndihmës sociale në të holla sipas parametrave të ndryshme, të cilat janë me rëndësi të madhe, siç janë: përkatësia etnike, statusi ekonomik i përdoruesve të ndihmës, arsimi dhe numri i viteve të përdorimit të ndihmës sociale, nuk ekzistojnë të dhëna statistikore të ndara sipas strukturës gjinore të përdoruesve. Nga ana tjetër, mungojnë të dhënat analitike për profilin e përdoruesve të ndihmës sociale në të holla.
Bëjmë thirrje që të vazhdohet me hulumtime, të cilat duhet ta përcaktojnë profilin e grupeve qëllimore, t'i detektojnë nevojat gjinore dhe interesat e përdoruesve, me qëllim që të sigurohen mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët.
- ◆ Politikat aktive për punësim në masë të madhe duhet t'u mundësojnë përdoruesve të ndihmës sociale në të holla integrim sa më të shpejtë në tregun e punës. Në këtë drejtim, nevojitet bashkëpunim dhe koordinim më i madh midis të gjitha institucioneve kompetente që janë përfshirë në këtë proces, me qëllim që të mundësohet barazi gjatë angazhimit në punë të grave dhe të burrave.
- ◆ Ekziston mundësi ligjore për angazhimin e përdoruesve të ndihmës sociale në të holla për realizim të punëve publike deri në pesë ditë në muaj, si dhe punë sezonale dhe punë të tjera të përkohshme.
- ◆ Duke e pasur parasysh këtë gjë, rekomandojmë koordinim maksimal midis Kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjeve publike dhe Qendrave të punëve sociale, me qëllim që në spektrin e punëve sezonale dhe komunale të ofruara, të parashihen edhe angazhime, të cilat nuk kanë të bëjnë vetëm me punët tradicionale "mashkullore", për të cilat nevojitet forcë më e madhe fizike dhe në atë mënyrë edhe gratë përdoruese të ndihmës sociale në të holla, për të cilat nuk vlen lirimi nga angazhimi i tillë për shkak të shtatzënisë ose lejes së lindjes, do të kenë trajtim të njëjtë me burrat.

5. POLITIKA AKTIVE PËR PUNËSIM

Procesi i afrimit të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian kërkon standarde të caktuara dhe kualitete në të gjitha sferat e jetës shoqërore, sidomos në sferën e punësimit dhe arsimit, të cilat Republika e Maqedonisë duhet t'i plotësoj gjatë periudhës në vijim.

Standardet dhe kualitetet në sferën e punësimit dhe arsimit, të cilat duhet të sigurojnë reforma ekonomike dhe sociale, si pjesë të strategjive pozitive për përmirësim të punësisë, përgjegjësisë dhe kohezionit social në Evropë, ja definuar në një numër të madh Kartash, Strategjish dhe Dokumentesh. Për ne, me interes primar janë Kartat në të cilat promovimi i mundësive të barabarta është koncepti i integruar i politikave të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, ndërsa iniciativat janë orientuar drejt tejkalimit të (pa)barazive ekzistuese: Karta e Amsterdimit, Strategjia e Lisbonës dhe Strategjia evropiane për punësim.

Në këtë mënyrë, në sferën e punësimit është bërë revolucion kur vendet evropiane, nëpërmjet Marrëveshjes në Amsterdam, në vitin 1999, e parashtruan problemin e papunësisë si problem "evropian" duke theksuar se ai duhet zgjidhur në

nivel të vendeve anëtare, sepse nuk mund të zgjidhet vetëm në nivel nacional për shkak të përmasave të mëdha. Shqetësimi i përbashkët shfaqet në nenin 126, sipas të cilit vendet anëtare obligohen se do të punojnë në zhvillimin e Strategjisë së koordinuar të punësimit dhe të aftësive në tregun e punës, i cili do të përshtatet ndaj ndryshimeve ekonomike. çështjet gjinore të përmabjtura në Marrëveshjen e Amsterdanit definojnë mundësi të barabarta dhe eliminim të pabarazive në tregun e punës dhe punësimit, duke i përfshirë parimet e rrogës së njëjtë për punë të njëjtë, përkatësisht parimet për punë me vlerë të njëjtë.

Në të njëjtin vit është pranuar edhe Strategjia evropiane për punësim (SEP), e bazuar në katër shtylla kryesore: punësimi, sipërmarrja, përshtatja dhe barazia. Më tej, SEP u zhvillua si përmbledhje parimesh, të cilat çdo vend anëtar duhet t'i përfshij në Programet vjetore nacionale të reformave (PNR), të definuara më parë si Plane nacionale aksionare (PNA) për punësim.

Në drejtim të përmirësimit të punësisë dhe ndërtimit të ekonomisë së bazuar në njohuritë, si përgjigje të gjendjeve të BE-së në vitin 2000, kur janë regjistruar 15 milionë banorë të papunë të Evropës, gjatë mbledhjes së Këshillit të Evropës në Lisbon (në mars të vitit 2000), Bashkimi Evropian e solli Deklaratën e Lisbonës, me qëllime të reja strategjike: të zhvillohet në ekonomi më kompetente dhe dinamike e bazuar në njohuritë, e cila do të jetë e aftë të siguroj prosperitet stabil ekonomik me më shumë vende pune, me vende më të mira pune dhe me kohezion më të mirë social.

Këshilli, si një nga indikatorët për matje të suksesit, ka përcaktuar rritje të shkallës së punësisë për 70% dhe rrije të numrit të grave në procesin e punës për më shumë se 60%, gjatë vitit 2010. Arsyet për indikatorët e defnuar në këtë mënyrë qëndrojnë në shkallën e ulët të punësisë, e cila karakterizohet me përfaqësim të dobët të grave dhe punonjësve të moshuar në tregun e punës, ndërsa zhvillimi i teknologjive informative mund të rezultojë me diferencë akoma më të madhe në mjeshtëritë në tregun e punës.

Në drejtim të afrimit në Bashkimin Evropian, Republika e Maqedonisë edhe gjatë viteve të kaluara ka shprehur vullnet dhe gatishmëri politike në promovimin e standardeve dhe vlerave evropiane, nëpërmjet rritjes së punësisë së popullatës së papunë dhe pjesëmarrjes së tyre aktive në tregun e punës, me ndihmë të masave të përdorura në kuadër të Politikave aktive në tregun e punës (PATP), qëllimi kryesor i të cilave është rritja e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe zvogëlimi i numrit të përdoruesve joaktiv të shërbimeve sociale (në dallim nga masat pasive, të cilat i përfshijnë beneficionet sociale, kompensimet në rast papunësie dhe pensionimin e hershëm)³⁸.

Politikat aktive të punësimit, për të cilat janë ndarë mjete financiare (në vitin 2007, 0,08% të PVB, në vitin 2008, 0,16% dhe në vitin 2009, 0,28%), duhet të ndihmojnë në mënjanimin e papunësisë, krijimin e ekonomisë dinamike dhe në investimet në kapitalin njerëzor, si dhe në rritjen e shkallës së punësisë së grave.

ÇËSHTJET GJINORE NË POLITIKAT DHE STRATEGJITË PËR PUNËSIM NË RM

³⁸ Sipas të dhënave të APRM për vitet 2007 dhe 2008, nga numri i përgjithshëm i personave të evidentuar si të papunë, rreth 80% kërkojnë punë në mënyrë aktive. Në vitin 2007, nga 357.166 persona të evidentuar si të papunë, 75.508 janë paraqitur vetëm për ta realizuar të drejtën e sigurimit shëndetësor, ndërsa 281.658 (80,1%) kanë kërkuar punë në mënyrë aktive. Në vitin 2008, nga 343.363 persona të evidentuar si të papunë, 71587 janë paraqitur vetëm për ta realizuar të drejtën e sigurimit shëndetësor, ndërsa 271.774 (79,2%) kanë kërkuar punë në mënyrë aktive. Në vitin 2009, nga 349879 persona të evidentuar si të papunë, 71.235 janë paraqitur vetëm për ta realizuar të drejtën e sigurimit shëndetësor, ndërsa 278.644 (79,6%) kanë kërkuar punë në mënyrë aktive. Burimi: Paraqitja e personave të papunë të evidentuar në Agjencinë e punësimit të RM. Tabela 4: persona të evidentuar të papunë nga 01.01.2007 deri në 31.12.2007, 01.01.2008 deri në 31.12.2008 dhe në fund të prillit të vitit 2009 (www.avrm.mk)

Në drejtim të integritit të koncepteve gjinore në politikat për punësim, në përputhje me marrëveshjet, standardet dhe praktikat e mira evropiane, Republika e Maqedonisë bën përpjekje për integrimin dhe përfshirjen e tyre në të gjitha dokumentet strategjike dhe në programet e ndryshme të vendit.

Dokument kryesorë dhe kornizë në të cilën janë definuar politikat për punësim është Strategjia nacionale për punësim (SNP) 2010, dokument i aprovuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Strategjia i përfshin politikat për punësim të strategjisë së reviduar të Lisbonës dhe drejtimet e BE-së dhe i përcakton qëllimet e saj, midis të cilave gjendet edhe rritja e shkallës së punësisë së grave në Republikën e Maqedonisë, nga 31,1%, sa ka qenë në vitin 2005, në 38% në vitin 2010.

Mënyrat në të cilat do të realizohen këto qëllime, thuhet në Strategjinë, (kapitulli 2.6.3 Mundësi të barabarta të gjinive) janë: (1) vazhdimi i procesit të harmonizimit dhe përshtatjes së legjislacionit vendas me atë të BE-së në sferën e mundësive të barabarta, (2) përgatitja e programeve për arsim dhe trajnim, me pjesëmarrje më të madhe të grave, të cilat do të krijojnë mundësi më të mëdha për përfshirjen e grave në sektorët në të cilat janë më pak të pranishme; (3) reformat për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe inkurajimi i sipërmarrjes së grave; (4) zhvillimi dhe avancimi i rrjetit të institucioneve publike dhe private për përkujdesje të fëmijëve, me anë të të cilit do të rritet përqindja e fëmijëve me përkujdesje, deri në moshën e arsimimit të detyruar.

Dokumenti kryesor i radhës, i cili ka për qëllim ta siguroj implementimin e Strategjisë për punësim 2010, është Plani nacional aksionar për punësim (PNAP) 2006-2008. Në analizën e gjendjes aktuale, lidhur me pozitën e gruas, është konstatuar se ekzistojnë trende pozitive nëpërmjet rritjes së numrit të grave të punësuarra dhe se "dallimi i theksuar midis grave dhe burrave në shkallët e papunësisë, ndër të tjerash është si pasojë e aktiviteteve më të vogla të grave të nacionalitetit shqiptar, rom dhe turk". Edhe në këtë dokument qëllimet janë orientuar drejt rritjes së punësisë së grave në 38% gjatë vitit 2010.

Plani nacional aksionar për punësim (PNAP) 2009-2010, në pjesën e politikave për punësim dhe çështjeve gjinore, paraqet vazhdim të PNAP 2006-2008. Ai përmban përshkrim të shkurtër të arritjeve të Programit operativ 2007-2008 dhe brenda tij janë parashtruar qëllimet dhe strategjia-shkalla e punësisë së grave të rritet në 38%, deri në vitin 2010. Edhe në këtë dokument, si PNAP të mëparshëm, theksohet se shkalla e pasivitetit të grave është më e theksuar midis bashkësive etnike shqiptare, rome dhe turke. Në aktivitetet e planifikuara përmendet se brenda programeve operative do të përfshihet një numër më i madh i grave, në kuadër të programeve dhe masave të veçanta për punësim. Plani nacional aksionar bazohet në Programin operativ për zhvillim të resurseve njerëzore 2007-2013, Komponenti 4 i Instrumentit të ndihmave financiare të fondeve IPA, në të cilin do të përkrahen masat e orientuara drejt mënjanimit të pabarazisë dhe promovimit të barazisë midis burrave dhe grave. Në aktivitetet e planifikuara të PNAP 2009-2010, janë paraparë edhe një sërë masash dhe aktiviteteve për përmirësim të gjendjes së gruas në tregun e punës, si pjesë e Strategjisë nacionale për barazi gjinore dhe Planit nacional aksionar për barazi gjinore (PNABGJ).

Plani nacional aksionar për barazi gjinore (PNABGJ) bazohet në moton e Deklaratës së Pekinit, në të cilën qeverive u bëhet thirrje ta përfshijnë barazinë gjinore në rrjedhat kryesore, politikat, programet dhe praktikat. Më saktë, para se të sillen vendimet, të bëhet analizë të efekteve ndaj burrave dhe grave.

Në PNABGJ bëhet thirrje për përdorim të ashtuquajturit akses i dyfishtë (dual track approach), që në thelb paraqet akses korektiv ose model i barazisë thelbësore, i cili nuk merret vetëm me mundësitë e njëjta, por më shumë merret me rezultatet e

përfaqësimit të drejtë dhe nuk përqendrohet në trajtimin e barabartë por në aksesin e njëjtë dhe në beneficinet e njëjta.

Një nga dhjetë sferat strategjike të veprimit të PNABGJ është Gruaja dhe punësimi, e cila e paraqet sferën e gjashtë strategjike. Edhe ky program është i orientuar drejt përmirësimit të punësisë së grave, në përputhje me dokumentet strategjike.

Me fitimin e statusit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Republikës së Maqedonisë iu ofrua mundësia për përdorim të Fondeve evropiane që ndahen para pranimit të vendeve candidate në BE. Këto fonde janë dedikuar për përforcimin dhe zhvillimin e kapaciteteve administrative dhe për arritjen e standardeve evropiane, në sfera të caktuara të jetës shoqërore. Komponenti i katërt nga pesë komponentët, që është relevante për këtë problematikë, është Programi operativ për zhvillim të resurseve njerëzore (POZHRNJ 2007-2013), fondi i përgjithshëm i të cilit arrin në 55.000.000.000 denarë dhe i cili është kompatibil me udhëzimet e Fondit social evropian (FSE).

Në këtë program janë paraparë tre qëllimet kryesore: rritja e punësisë, zvogëlimi i papunësisë dhe mbajtja e personave në tregun e punës, nëpërmjet përmirësimit të funksionimit të tregut të punës dhe të mundësive për punësim, sidomos për grupet sensibile (të rinjtë, gratë, personat e papunë për një periudhë të gjatë, të moshuarit, bashkësitë etnike etj.)

Në bazë të proceseve konsultative të POZHRNJ për periudhën e viteve 2007-2013, përmendet se në program janë paraparë sugjerime për përfshirjen e grave, përmirësimin e analizave socio-ekonomike, analizat gjinore gjithëpërfshirëse dhe zgjerim të aktiviteteve aktuale të grave.

Shpresojmë se konstatimet e kësaj analize do të kontribuojnë edhe ndaj planifikimit dhe shfrytëzimit më efikas të Fondeve IPA të kësaj komponente dhe se do të mundësojnë akses të barabartë për gratë dhe burrat, por edhe ndarje të drejtë të beneficioneve të këtyre instrumenteve.

MASAT NË POLITKAT PËR PUNËSIM

Politikat aktive për punësim realizohen nëpërmjet një sërë programesh dhe masash (Tabela nr. 12), të cilat i përgatisin dhe i implementojnë një sërë institucionesh, midis të cilave gjendet edhe Ministria e punës dhe politikës sociale (MPPS), Agjencia e punësimin të RM (APRM), nëpërmjet Qendrave të punësimin, Agjencia për përkrahje të sipërmarrjes (APS) etj., për të cilat ndahen mjete nga buxheti shtetëror dhe nga ana e organizatave ndërkombëtare, UNDP dhe USAID.

Në tabelën në vijim është dhënë prezantimi i të gjitha masave nga politikat aktive për punësim. Objekti i analizës në këtë pjesë të hulumtimit janë çështjet gjinore dhe aspektet buxhetore në katër masave të politikave aktive për punësim: Vetëpunësimi, Formalizimi i bizneseve ekzistuese, Subvencionimi i punësimin dhe Përgatitja për punësim në periudhën e viteve 2007 dhe 2008 (me disa sugjerime edhe për vitin 2009).

Tabela nr. 12. Paraqitje të programeve të politikave aktive për punësim (PAP), mjetet financiare të planifikuara dhe shpenzuara për çdo program.

Lloji i programit	Buxheti për programin në vitin 2007	Buxheti për programin në vitin 2008	Buxheti për programin në vitin 2009	Pjesëmarrje në buxhetin e përgjithshëm të MPPS (në %)		
				2007	2008	2009
Programi për vetëpunësim	73.300.000,00 të planifikuara 99.506.490,00 të realizuara	97.235.600,00 të planifikuara 102.487.500,00 të realizuara	122.407.300,00 të planifikuara	0,37 0,54	0,51 0,54	0,53 -
Programi për formalizim të bizneseve aktuale	-	18.136.500,00 të planifikuara 19.153.500,00 të realizuara	47.000.000,00 të planifikuara	-	0,09 0,10	0,20 -
Programi për përgatitje për punësim	-	61.363.600,00 të planifikuara 50.776.000,00 të realizuara	21.546.560,00 të planifikuara	-	0,32 0,27	0,93 -
Programi për subvencionim të punësimit	111.800.000,00 të planifikuara 76.338.400,00 të realizuara	110.150.000,00 të planifikuara 94.436.000,00 të realizuara	339.006.000,00 të planifikuara	0,57 0,41	0,57 2,70	1,46 -
Programi për praktikë	-	360.000.000,00 të planifikuara 1.692.000,00 të realizuara	13.500.000,00 të planifikuara	-	1,87 0,00	0,06 -
Programe aktive për punësim (infrastruktura lokale dhe ndihma) në punët publike të Njësisve të vetëqeverisjes lokale (NJVL)	27.600.000,00 të planifikuara 19.797.915,00 të realizuara	-	228.980.000,00 të planifikuara	0,14 0,11	-	
Angazhimi i personave të papunë të rajoneve të ndryshme në realizimin e punëve ndërtimore, projekteve ekologjike etj.	19.000.000,00 të planifikuara 20.180.970,00 të realizuara	-	-	0,10	-	-
Trajnime dhe këshilla për personat e papunë lidhur me rikualifikimin, trajnimet kompjuterike etj.	50.000.000,00 të planifikuara 50.000.000,00 të realizuara	-	-	0,26 0,26	-	-
Anketa pilot për vende të lira pune	-	-	730.000.000,00 të planifikuara	-	-	3,15 -
Përforcimi ekonomik i grave viktime të dhunës familjare	-	-	35.000.000,00 të planifikuara	-	-	0,15 -
Programi për përkrahje të punësimit të Romëve	-	-	4.800.000,00 të planifikuara	-	-	0,02 -

Në tabelën nr. 12a janë paraqitur mjetet e politikave aktive për punësim, për periudhën e viteve 2007-2009, në të cilat mund të vërehet rritje e vogël e mjeteve të dedikuara për implementimin e politikave aktive.

Tabela nr. 12a Paraqitja e numrit të përgjithshëm të punësimeve-angazhimeve të planifikuara dhe të mjeteve të planifikuara të shpenzuara nëpërmjet politikave aktive për punësim (PAP)

Viti	Të planifikuara - Të realizuara	Buxheti i përgjithshëm i MPPS	Buxheti për PAP	Pjesëmarrja e PAP në Buxhetin e përgjith- shëm të MPPS, në %
2007	Të planifikuara	19.575.720.000,00	297.600.000,00	1,52
2007	Të realizuara	18.413.733.633,00	265.823.779,00	1,44
2008	Të planifikuara	19.251.681.000,00	294.191.921,00	1,53
2008	Të realizuara	18.810.076.840,00	275.560.821,00	1,47
2009	Të planifikuara	23.205.711.000,00	825.102.860,00	3,56

Burimi: MPPS, shërbimi i llogarive. Paraqitja e punësimeve-angazhimeve të planifikuara dhe të mjeteve të planifikuara dhe të shpenzuara nëpërmjet programeve aktive për punësim (28.7.2009).

Vërejtje: Në të dhënat për vitet 2007 dhe 2008 nuk janë përfshirë programet për punësim të Romëve. Në buxhetin për PAP janë përfshirë edhe mjetet e donacioneve dhe agjencive kompetente për implementimin e tyre, APRM dhe APS.

5.1 PROGRAMI PËR VETPUNËSIM

Emri i programit

PROGRAMI PËR VETPUNËSIM (BIZNES FAMILJAR, program i iniciuar në vitin 2007 dhe i realizuar gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009)

Institucionet kompetente për realizim

Ministria e punës dhe politikës sociale (MPPS), Agjencia e punësimit të Republikës së Maqedonisë (APRM), Regjistri Qendror (RQ), Agjencia për përkrahje të sipërmarrjes të Republikës së Maqedonisë (APSRM), UNDP.

Qëllimet (qëllimet eksplicite dhe implicite)

Qëllimet e PROGRAMIT PËR VETPUNËSIM për vitet 2007, 2008 dhe 2009 janë orientuar drejt zvogëlimit të varfërisë dhe papunësisë, nëpërmjet fillimit të bizneseve të reja. Qëllimi i drejtpërdrejt është që të mundësohen 500 vetëpunësime/biznese familjare në vitin 2007, 600 punësime/biznese familjare në vitin 2008 dhe 600 punësime/biznese familjare në vitin 2009.

Përshkrim i shkurtër

Programet realizohen nëpërmjet trajnimeve të personave të interesuar të papunë për sipërmarrjen, për përgatitjen e biznes-planeve, ndihmën gjatë regjistrimit të biznesit privat dhe subvencionimit për fillim të biznesit. Qëllimet e programit mbeten të pandryshuara gjatë tre viteve, ndërsa procesi i seleksionimit është ndryshuar për vitin e parë, krahasuar me vitin e dytë dhe të tretë, siç është shpjeguar më poshtë.

Grupet qëllimore

Grupet qëllimore të Programit për vetëpunësim janë definuar në planet operative për vitet 2008 dhe 2009. Me këtë masë parashihet të përfshihen: (1) 250 të rinj të papunë, persona deri në moshën 27 vjeçare; (2) gratë të papunësuar dhe të evidentuara në APRM mbi një vit (100 gra në vitin 2008 dhe 150 në vitin 2009); dhe (3) persona të papunësuar për një periudhë të gjatë dhe të evidentuar në APRM mbi 2 vjet (150 persona në vitin 2008 dhe 200 persona në vitin 2009)³⁹.

Me këtë masë, në vitin 2007 ishte paraparë të përfshihen personat e rajoneve të pazhvilluara, të papunësuar për një periudhë të gjatë (mbi 5 vjet), përdoruesit e ndihmës sociale për shkak të papunësisë dhe të rinjve deri në moshën 27 vjeçare.

³⁹ Nuk ekziston përcaktimi i saktë të përdoruesve në vitin 2007.

Gratë si grup qëllimor nuk janë përmendur në Planin operativ të vitit 2007.

Në Programin operativ për vitet 2008 dhe 2009 definohej qartë synimet për përfshirje më të madhe të grave të bashkësive etnike, në përputhje me dokumentet e tjera strategjike.

Aktivite dhe masa

Masat e këtij programi kanë të bëjnë me: përgatitjen e planeve individuale për punësim; realizimin e testeve lidhur me orientimin profesional, zhvillimin e ideve të biznesit, seleksionimin e kandidatëve më adekuat dhe më të interesuar; me trajnimet rreth sipërmarrjes; përgatitjen e planeve të biznesit, në bashkëpunim me APRM, me marketingun; mbulimin e shpenzimeve për blerje të pajisjeve ose sigurimin e mjeteve bazë për fillim të biznesit; participimin financiar në shpenzimet për regjistrim të firmës; participimin financiar në kontributet për rrogë, gjatë tre muajve të parë; përkrahjen nëpërmjet trajnimeve, këshillave dhe informatave të tjera, gjatë vitit të parë nga ana e APRM. Masat janë shpjeguar në planet operative.

Implementimi i këtij programi realizohet nëpërmjet qendrave rajonale të Agjencisë së punësimit të Republikës së Maqedonisë. Përkrahja financiare e projektit arrin në 2.500 euro për një vetëpunësim, mjete që nuk kthehen.

ANALIZA GJINORE E PROCESIT DHE BUXHETIT

Procesi i seleksionimit

Programi për vetëpunësim realizohet në tre faza kryesore dhe 12 hapa, në të cilat janë shpjeguar proceset e përgatitjes, seleksionimit të kandidatëve, realizimi dhe vlerësimi i Programit. Fazat e shpjeguara në Udhëzimet operative për operacionalizim të vetëpunësimit, si pjesë e Planit operativ për politikat aktive për vetëpunësim për vitin 2007, ka të bëjë me: (1) promovimin, pranimin, zgjedhjen dhe seleksionimin e pjesëmarrësve; (2) trajnimin dhe zgjedhjen e ideve më të mira për biznes dhe planeve të biznesit si dhe regjistrimin e kompanive dhe (3) dhënien e granteve fillestare për blerje të pajisjeve/mallrave⁴⁰.

Hapat e tre viteve (2007, 2008 dhe 2009), që janë definuar në Udhëzimet operative, të cilat paraqesin dokumente që e shpjegojnë të gjithë procesin e seleksionimit të kandidatëve, përfshijnë: (1) Përgatitje të Udhëzimeve operative; (2) Shpalljen publike; (3) Regjistrimin e aplikimeve nga ana e Qendrave për punësim dhe seleksionim fillestar sipas grupeve qëllimore; (4) Informimin e kandidatëve lidhur me masat dhe nënshkrimin e deklaratave për pëlqim për pjesëmarrje në projekt; (5) Trajnimin "Nga ideja në biznes"; (6) Sistemin këshill-dhënës për përgatitje të planeve të biznesit; (7) Klasifikimin e 500 planeve më të mira të biznesit, të cilat do të fitojnë mjete për vetëpunësim; (8) Klasifikimin e bizneseve familjare dhe të punësimeve; (9) Nënshkrimin e marrëveshjeve për ndihma në pajisje; (10) Furnizimin e pajisjeve/repromaterialeve për vetëpunësim; (11) Pjesëmarrjen në kontributet e rrogës për çdo vetëpunësim, gjatë tre muajve të para; (12) Realizimin e programit.

Në vazhdim, analiza tërësisht do t'u përkushtohet mënyrave, në të cilat aspektet gjinore janë integruar në këto hapa dhe në implikimet e tyre në procesin e implementimit dhe vëzhgimit të programit.

(1) Hapi i parë tepër i rëndësishëm nga aspekti i integritit të çështjeve gjinore është përgatitja e Udhëzimeve operative për operacionalizim të masave, të parapara në Planet operative.

⁴⁰ Operacionalizimi i vetëpunësimit, si pjesë e Planit operativ të politikave aktive për vetëpunësim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për vitin 2007, Udhëzimet operative, viti 2007.

Udhëzimet operative për operacionalizim të masave, të parapara në planet operative, paraqesin dokument strategjik në të cilin janë definuar metodologjia, aktivitetet, mënyra e veprimit dhe kriteret për vlerësim të kandidatëve të Programit për vetëpunësim. Këto udhëzime bashkërisht i përcaktojnë institucionet kompetente për implementimin e tyre të mëtejshëm, MPPS, APRM, APSRM dhe UNDP.

Udhëzimet operative, pas definimit të tyre, parashtrihen në Qendrat e punësimit, të cilat janë përgjegjëse për procedimin e mëtejshëm dhe për seleksionimin e kandidatëve.

Analiza e planeve operative dhe Udhëzimeve operative për vitin 2007 vërtetoi se çështjet gjinore ose masat specifike të orientuara drejt grave, si grup qëllimor, nuk janë paraparë në të njëjtat, edhe pse dokumentet qeveritare strategjike i konsiderojnë si të rëndësishme gjatë përpilimit të masave për punësim. Masa e vetme inkurajuese është pjesa e Udhëzimeve operative për operacionalizim të masave (2007), e cila gjendet në kapitullin Seleksionimi i kandidatëve dhe në të cilën qëndron: "Prioritet do të kenë gratë që aplikojnë dhe që nuk i plotësojnë deri në fund kriteret e duhura".

Edhe pse ky formulim është i rëndësishëm dhe e qartëson aspektin gjinor të politikave të punësimit, ai nuk mjafton për të siguruar pjesëmarrje të barabartë të grave dhe ndarje të barabartë të buxhetit dhe të dobisë së politikave. Hapa të mëtejshëm për mënyrat në të cilat kjo pjesë do të operacionalizohet në praktikë nuk janë paraparë në Udhëzimet operative dhe në dokumentet e tjera operative.

Avancim mund të vërehet në planet operative për vitet 2008 dhe 2009, në të cilat gratë janë definuar si grup i veçantë qëllimor, bashkë me dy grupet e tjera qëllimore, të rinjtë dhe personat e papunë për një kohë të gjatë. Në këto plane nuk është paraparë pjesa e cila parasheh që gratë të kenë prioritet.

Gratë e bashkësive etnike përmenden si grupe qëllimore kritike, por nuk janë paraparë masa të veçanta për inkurajimin e tyre dhe për përfshirje në tregun e punës.

Më poshtë, nëpërmjet analizës, do të sqarohen implikimet dhe përfitimet e këtyre masave.

(2) Hapi i dytë është shpallja publike

Duke u nisur nga supozimi se proceset e komunikimit me përdoruesit potencial janë tepër të rëndësishme si vegël për implementimin e suksesshëm dhe shfrytëzimin e mundësive që i ofrojnë masat e politikave aktive për punësim, me interes primar ishte ta kuptojmë mënyrën dhe masën e informimit të kategorive të ndryshme të përdoruesve, duke e përfshirë edhe çështjen e përdorimit të gjuhës gjinore senesitive që përdoret gjatë komunikimit.

Udhëzimet operative i definojnë mënyrat dhe procedurat për publikim të informatave, ndërsa bashkëbiseduesit tanë i konfirmuan përpjekjet e Qendrave të punësimit (30 Qendrave), në drejtim të përmirësimit të informimit të qytetarëve lidhur me mundësitë që i ofrojnë masat e Politikave aktive për punësim.

Shpalljet publikohen më shumë herë në media të ndryshme publike, në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe. Përveç shpalljeve, të gjitha qendrat e punësimit në hapësirat e tyre i publikojnë masat në tabelat e shpalljeve, lëshojnë njoftime, paraqiten në mediat lokale, në të cilat sqarohen procedurat për aplikim dhe japin njoftime të tjera, informata, materiale propaganduese.

Në shpalljet, ato të vitit 2008 dhe 2009, gratë janë ndarë si grup i veçantë qëllimor. Konsiderojmë se aksesit i atillë është me shumë rëndësi për sensibilizim të opinionit, për identifikimin e kategorisë gra si përdorues potencial të masave dhe për inkurajimin e tyre të paraqiten në shpalljet.

Megjithatë, mbetet dilema nëse këto masa për informim janë të mjaftueshme për t'i inkurajuar përdoruesit potencial, sidomos përdoruesit joaktiv, të përfshihen në tregun e punës dhe nëse janë të mjaftueshme për të arritur deri tek shtresat dhe kategoritë e ndryshme të popullatës, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e bashkësive etnike.

Raportet e Ministrisë së punës dhe politikës sociale tregojnë se interesimi i përdoruesve lidhur e shpalljet, në situata të caktuara ka qenë i dobët dhe prandaj janë marrë masa plotësuese, duke e përfshirë këtu edhe vazhdimin e afatit të shpalljes. Kjo na inkurajon të propozojmë aktivitete të orientuara drejt përgatitjes së strategjisë gjithëpërfshirëse për informim, e cila do ta përfshij edhe popullatën që ka vështirësi ose nuk i përdor mënyrat bashkëkohore të informimit.

(3) Hapi i tretë, regjistrimi i aplikimeve nga ana e Qendrave të punëve sociale dhe seleksionimi fillestar sipas grupeve qëllimore, realizohet në Qendrat e punëve sociale (30) të Republikës së Maqedonisë.

Procedura për regjistrim dhe seleksionim të kandidatëve për punësim në vitet 2007 dhe 2008 është zhvilluar në formën e pyetësorit⁴¹ për vetëvlerësim, i cili përfshin disa grupe kriteresh: (1) grupin e kriterëve diskualifikuese, në të cilin përdoruesve u është dhënë mundësia të kualifikohen në një nga grupet qëllimore—persona të papunësuar për një periudhë të gjatë⁴², gra të papunësuar dhe të rinj të papunësuar deri në moshën 27-vjeçare; (2) grupin e çështjeve për identifikim të aftësive dhe mundësive preliminare; dhe (3) grupin e çështjeve për identifikim të aktiviteteve sipërmarrëse.

Që në fillim, në procesin e regjistrimit, kandidati që e plotëson fletëparaqitjen ka për detyrë ta zgjedh njërin nga grupet qëllimore, të cilit i takon dhe ta dëshmoj përkatësinë. Në këtë pjesë të fletëparaqitjes figuron edhe pyetja për përkatësinë etnike.

Në grupet e definuara në këtë mënyrë ekziston mundësia të përfshihen pothuajse të gjitha kandidatët e interesuar. Vetëm kategoria e personave të papunësuar për një kohë të gjatë (mbi një vit) përbën 79,7% të numrit të përgjithshëm të personave të evidentuar si të papunë⁴³.

Në rastet kur paraqiten kandidatë që mund të kualifikohen në të tre kategoritë e grupeve qëllimore (për shembull, person i papunësuar deri në moshën 27-vjeçare i gjinisë femërore, që është paraqitur në APRM më shumë se 1 vit), ato e zgjedhin njërin nga grupet qëllimore, softueri automatikisht i kategorizon në një nga grupet qëllimore, ndërsa më vonë, në varrësi të interesit të përdoruesve, ato mund të transferohen në kategoritë përkatëse të grupeve qëllimore.

Grupi i dytë dhe i tretë i pyetjeve për seleksionim kanë të bëjnë me identifikimin e aftësive dhe mundësive preliminare dhe afiniteteve sipërmarrëse të kandidatëve. Në bazë të përgjigjeve të këtyre pyetjeve përcaktohet aftësia e kandidatit për pjesëmarrje në procedurën e mëtejshme të seleksionimit. Ky grup pyetjesh nuk përmbajnë masa provizore ose inkurajuese, nëpërmjet të cilave, grupet qëllimore të ripërcaktuara mund të kenë përparësi të caktuar⁴⁴.

Nga ana tjetër, edhe pse nuk jemi të informuar rreth vlerësimit të përgjigjeve të pyetësorit, vëmë në dukje disa aspekte sensitive në përdorimin e instrumenteve të

41 Ky pyetësor paraqet zgjidhje softueri në të cilën çdo pyetje, në varësi të përgjigjes së dhënë, mundëson numër të caktuar pikash.

42 Në Programin operativ për vitin 2009 janë ndryshuar kushtet dhe si persona të papunësuar për një kohë të gjatë janë definuar personat e papunësuar, të regjistruar në evidencat zyrtare mbi një vit. E njëjta gjë vlen edhe për kategorinë gra.

43 Raporti nacional i Analizës së nevojave për kuadro në tregun e punës në RM, për vitin 2008, Agjencia e punësimit e RM, Shkup, qershor i vitit 2008.

44 Praktika e këtyre të përdorimit të masave inkurajuese ekziston vetëm në rastin e personave të papunë që jetojnë në rajonet e pazhvilluara, për vitin 2007, është e përcaktuar me Vendim të Qeverisë, të publikuar në Gazetën Zyrtare 17/2006. *Përkatësia e përdoruesve në këtë kategori, gjatë proceseve të seleksionimit, atyre u mundëson pika plotësuese.*

ridefinura për seleksionim. Mënyrat në të cilat individët (të rinjtë, gratë, burrat, personat e papunësuar për një periudhë të gjatë, përfaqësuesit e grupeve të ndryshme etnike) i kuptojnë ose ballafaqohen me situata dhe gjendje të caktuara, të cilat janë dhënë në pyetësorin, dallohen dhe varen nga një sërë faktorësh psikologjik, ekonomik dhe social (pa/siguria materiale, shkalla e vetëbesimit, perceptimi, mjetet financiare, dhe resurset e tjera, toka, prona etj).

Prandaj mund të konstatojmë se përkatësia në një grup të caktuar qëllimor dhe/ose përkatësia etnike, në procedurën fillestare por dhe në proceset e mëtejshme të seleksionimit, nuk ndikojnë në rezultatin e fundit dhe në përfshirjen e përdoruesve. Kuptohet se përkatësia etnike ose përkatësia në grupet qëllimore ka një ndikim të caktuar në drejtim të përforsimit të vetëdijes për kategoritë qëllimore, të marginalizuara dhe kritike (të rriturit, personat e papunësuar për një periudhë të gjatë, gratë, gratë e bashkësive etnike, të rinjtë etj.) dhe në drejtim të sigurimit të pjesëmarrjes së tyre në politikat e punësimit.

(4/5) Hapi i katërt dhe i pestë kanë të bëjnë me informimin e kandidatëve me masat dhe me nënshkrimin e deklaratës për pjesëmarrje në trajnimin për sipërmarrje "Nga ideja në biznes".

Kandidatët të cilët nuk e kanë kaluar hapin e tretë dërgohen në trajnime për sipërmarrje në Qendrat për punësim. Sipas rezultateve të prezantuara në hulumtimin e APSRM, përdoruesit i kanë vlerësuar trajnimet si të suksesshme⁴⁵. Kandidatët, të cilët pas përfundimit të trajnimit edhe më tej dëshirojnë të fillojnë biznes ose të regjistrojnë firmë, vazhdojnë në fazën në vijim, përkatësisht e përdorin sistemin për përgatitje të planit të biznesit.

Pas seleksionimit fillestar të kandidatëve, procesi i seleksionimit vazhdon edhe në këtë fazë. Komisioni seleksionues, i përbërë nga përfaqësues të institucioneve kompetente për implementimin e programit, në bazë të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara më parë, vendos se cili nga aplikantët do të vazhdojë më tej.

Edhe në këtë fazë nuk ekzistojnë masa inkurajuese për kategori të caktuara të përdoruesve. Masa inkurajuese, gjatë seleksionimit të kandidatëve, nuk ekzistojnë as për gratë. Komisionet dhe trajnuesit, të cilët e realizojnë seleksionimin, vlerësimin e bëjnë në bazë të kriterëve të përcaktuara më parë, për të cilat nuk ekzistojnë indikatorë se janë sensitiv ndaj çështjeve gjinore dhe çështjeve të përkatësive të ndryshme.

Informatat e fituara gjatë intervistave, tregojnë se një pjesë e përdoruesve potencial janë tërhequr nga pjesëmarrja e mëtejshme në program, gjatë trajnimeve ose pas përfundimit të tyre. Arsyet për tërheqjen janë të shumta: dekurajimi, ndjenja e frikës nga mosuksesi, mungesa e gatishmërisë për t'i plotësuar detyrimet dhe përgjegjësitë me të cilat do të ballafaqohen në tregun e punës etj. Megjithatë, nuk është siguruar evidencë sistematike dhe analizë kualitative e arsyeve për vendimin e tillë, sidomos tek grupet e ndryshme të përdoruesve, të cilat mund të jetë e rëndësishme në përshtatjen dhe përmirësimin e politikave.

Sipas *Raportit për analizën e suksesit të projektit Vetëpunësim 2007, me propozime për përmirësim*, këshillimet sipërmarrëse janë vlerësuar si shumë të suksesshme dhe kanë ndikuar në rritjen e ndërmarrjes. Përdoruesit, në masë të madhe, kanë shprehur gatishmëri për të marrë pjesë me mjetet e tyre në pjesën e këshillimit.

Kjo na inkurajon që në rekomandimet të propozojmë masa akoma më intensive për përkrahje nëpërmjet trajnimeve dhe këshillimeve të përdoruesve, por jo vetëm në procesin e regjistrimit dhe të fillimit të bizneseve, por edhe në aktivitetet e mëtejshme

⁴⁵ Raporti i analizës për suksesin e projektit Vetëpunësim 2007, me propozime për përmirësim, APSRM, mars, viti 2008

zhvilluese.

(6/7) Hapi i gjashtë dhe i shtatë janë: sistemi këshilldhënës për përgatitje të planeve të biznesit dhe klasifikimi i 500 planeve më të mira për biznes, të cilat do të fitojnë mjete për vetëpunësim.

Pas përfundimit me sukses të trajnimeve për sipërmarrjen “Nga ideja në biznes”, kandidatët drejtohen në këshillime në gjashtë Qendrat rajonale/Organizatave për përkrahje afariste. Nga Katalogu ekzistues i këshilluesve (të zgjedhur nëpërmjet shpalljes publike), zgjidhen konsulentët e autorizuar për përgatitje të planeve për biznes dhe/ose për regjistrim.

Pas përgatitjes së planeve për biznes me ndihmë të konsulentëve, klasifikimin e bën Komision profesional, i cili është i obliguar të përpiloj rang listë me planet më prioritare për biznes.

Edhe në këtë rast, parimi i vlerësimit është i orientuar drejt tregut (vlerësohet vetëm leverdia ekonomike dhe mundësitë për realizim të planeve të biznesit), pa i marrë parasysh kategoritë e ndryshme të përdoruesve që duhet të përfshihen me masat.

Me anë të procedurës për seleksionim të kandidatëve, e përmendur më sipër, mund të arrijmë në konkluzionin se, për përdoruesit e grupeve qëllimore drejt të cilëve janë orientuar politikatat për punësim (të rriturit, personat e papunësuar për një periudhë të gjatë, gratë, gratë e bashkësive etnike, të rinjtë etj.), edhe pse formalisht janë paraparë në programet dhe dokumentet strategjike të vendit, mungojnë mekanizmat konkret për përfshirjen e tyre të tërësishme.

Në mungesë të mekanizmave, kriterëve kryesore dhe/ose masave inkurajuese në proceset e seleksionimit dhe në kushte kur kriteret për zgjedhje të përdoruesve janë përqendruar vetëm në efikasitetin ekonomik dhe nuk e përfshijnë dimensionin gjinor, nuk mund të presim që programet dhe masat t'i plotësojnë qëllimet e planifikuara në dokumentet strategjike qeveritare (për shembull, rritje të punësisë së grave në 38% gjatë vitit 2010).

Prandaj, theksojmë se punësimi i grave nuk duhet lënë mënjanë, por nevojitet të bëhen përpjekje plotësuese për përfshirjen e grave në tregun e punës.

Hapat në vijim janë: (8) Regjistrimi i biznesit familjar dhe punësimet; (9) Nënshkrimi i kontratës për ndihmë në pajisje; (10) Furnizimi me pajisje/repromateriale për të vetëpunësuarit; (11) Pjesëmarrja në kontributet e rrogës gjatë tre muajve të parë, për çdo person të vetëpunësuar.

Kandidatët që do t'i kalojnë procedurat e seleksionimit dhe do të regjistrojnë biznes familjar, do ta humbin statusin e personit të papunë për një periudhë 3-vjeçare.

Çdo kandidat, për të filluar dhe/ose për të regjistruar një biznes fiton përkrahje, e cila arrin deri në 2.500 euro, për blerje të pajisjeve/repromaterialeve dhe për pjesëmarrje në pagimin e kontributeve sociale të rrogës, gjatë tre muajve të parë pas vetëpunësimit, nga ana e APRM.

(12) Evoluimi

Në kuadër të Programit të politikave aktive për punësim, ekziston sistem për vëzhgim dhe evidentim të punësimeve, nëpërmjet të cilit mund të vërtetohet se cilët përdorues të masave janë kthyer në evidencat e papunësisë pas periudhës së caktuar dhe cilët përdorues kanë vazhduar me realizimin e ideve të tyre. Megjithatë, të dhënat për bizneset e regjistruara dhe të dhënat e kryqëzuara për realizuesit e bizneseve, sipas gjinisë, përkatësisë etnike, rajonit dhe sektorëve, në të cilët dominojnë gratë dhe

burrat, nuk mund të sigurohen lehtë.

Nga ana tjetër, gjatë përgatitjes së këtij Raporti, nuk konstatuam hulumtime më gjithëpërfshirëse për efektete dhe ndikimin e masave të politikave për punësim. I vetmi hulumtim për të cilin mendojmë se është i rëndësishëm, lidhur me konstatimet dhe përmbajtjen, është hulumtimi i realizuar nga Agjencia për përkrahje të sipërmarrjes⁴⁶, i cili përfshiu 120 ndërmarrje nga 500 bizneset e përkrahura në vitin 2007.

Në këtë hulumtim, dimensionin gjinor nuk është objekt i interesit dhe përveç të dhënës për përfshirjen e 31% gra të anketuara, nuk ekzistojnë të dhëna të tjera statistikore të ndara sipas gjinive, nëpërmjet të cilave mund të kuptohet dhe mësohet struktura e personave, bizneset e të cilëve rezistuan në tregun e punës dhe të atyre bizneset e të cilave janë shuar; ndarja gjinore sipas sferave (sfera e prodhimit, tregtia, bujqësia dhe shërbimet), rajoneve dhe përbërjes etnike; gjendja e të rinjve nga aspekti gjinor, përbërja etnike dhe të dhënat kualitative, lidhur me problemet me të cilat ballafaqohen në tregun e punës.

Dimensionin rajonal, i cili përmendet në Raport, edhe pse nuk është i shoqëruar me statistika të ndara sipas gjinisë, paraqet dimension tepër i rëndësishëm në përgatitjen e politikave, në përputhje me profesionet, strukturën e popullatës, nivelin e arsimit etj.

Ekzistimi i evidencës gjithëpërfshirëse me të dhëna të kryqëzuara, e shoqëruar me analizë, mund të jetë me rëndësi të madhe gjatë identifikimit dhe përcaktimit të aktiviteteve të mëtejshme kur, bëhet fjalë për masat dhe politikat aktive të punësimit.

Metodologjia e këtyre hulumtimeve dhe hulumtimeve të ngjashme, në të ardhmen patjetër duhet ta përmbaj aspektin gjinor dhe t'i marr parasysh specifikat e kategorive të ndryshme të përdoruesve, sipas gjinisë, rajonit, përbërjes etnike, profesionit, arsimit etj.

ANALIZA E BUXHETIT

Tabela 14: Buxheti i Planit operativ për Planin aksionar për punësim në vitet 2007, 2008 dhe 2009 dhe pjesëmarrja në Programin për vetëpunësim (pa e përfshirë Programin për përkrahje të Romëve gjatë punësimit dhe Programin për vetëpunësim, nëpërmjet kreditimit, të cilët, gjatë vitit 2008 nuk kanë qenë pjesë e PO)

Buxheti	Viti	Buxheti për Programin për vetëpunësim	Mjetet për Planin operativ (PO)	Pjesëmarrja e Programit për vetëpunësim në PO
E planifikuar	2007	88.300.000,00	297.600.000,00	29,67%
E realizuar	2007	99.506.490,00	265.823.779,00	37,43%
E planifikuar	2008	97.235.600,00	294.191.921,00	33,05%
E realizuar	2008	102.487.500,00	275.560.821,00	37,19 %
E planifikuar	2009	122.407.300,00	825.102.860,00	14,84%

Nga të dhënat për buxhetin në vitet 2007, 2008 dhe 2009, në Tabelën 14 mund të vërehet rritja e mjeteve në shifra absolute, për të gjitha programet dhe masat, duke e përfshirë edhe Programin për vetëpunësim. Pjesëmarrja me përqindje më të ulët të Programit për vetëpunësim për vitin 2009 është si rezultat i rritjes së numrit të masave të politikave aktive për punësim dhe të shpërndarjes së ndryshme të mjeteve.

Tabela 15. Paraqitja e shpenzimeve të buxhetit për vitet 2007 dhe 2008

Programin për vetëpunësim	Buxheti	Nr. i përdoruesve	Shpenzime për njësi	Shpërndarja e mjeteve sipas gjinisë	
				Gra	Burra
2007	84.506.490,00	558	151.445,00	21.052.245,00	63.455.455,00
2008	102.487.500,00	529	193.738,20	39.522.589,00	62.964.910,00

⁴⁶ Analiza për suksesin e Projektit për vetëpunësim 2007, me propozimet për përmirësim, APSRM, mars i vitit 2009

Tabela 16. Paraqitja e ndarjes sipas gjinive, për vitet 2007 dhe 2008

Programin për vetëpunësim	Nr. i njëjësive dhe përdoruesve	Nr. i grave	Nr. i burrave	% e grave	% e burrave
2007	558	139	419	25%	75%
2008	529	204	325	39 %	61%

Shumat e përgjithshme të parapara në buxhetet i paraqesin vlerat mesatare për çdo pjesëmarrës.

Tabela nr. 15 i paraqet shpenzimet dhe shpërndarjen e mjeteve midis burrave dhe grave, gjatë viteve 2007 dhe 2008.

Në programet për vitin 2007, procedura për blerje të pajisjeve, në varësi të planit për biznes dhe konstruksionit financiar, parasheh shpërndarje të ndryshme të buxhetit sipas pjesëmarrësve. Të dhëna të tilla të detajuara nuk arritëm të fitojmë. Prandaj, paraqitja tabelare (Tabela nr. 15) e tregon vlerën mesatare e masës për përkrahje të vetëpunësimit, sipas përdoruesve.

Në tabelën 16, Paraqitja e ndarjes sipas gjinive, është i dukshëm përmirësimi i përfshirjes së grave si përdorues të mjeteve dhe rritja e përqindjes së grave në Programin për vetëpunësim.

Numri i grave që kanë shprehur interes për pjesëmarrje është më i madh se mundësitë që i ofron kjo masë, por kriteret e seleksionimit të kandidateve nuk mundësojnë përfshirje më të madhe të grave në projektin.

Edhe pse dokumentet strategjike e kanë për qëllim përfshirjen e përdoruesve të bashkësive etnike, shpërndarja e mjeteve në bazë të kësaj kategorie të përdoruesve, nuk ishte e mundur të realizohet, për shkak të mungesës së të dhënave statistikore.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Kreatorët e politikave është me rëndësi të kuptojnë se çështja e barazisë dhe përfshirjes së perspektivave gjinore në rrjedhat kryesore nuk është vetëm çështje e barazisë gjinore, por ajo është me rëndësi të madhe gjatë ballafaqimit me varfërinë dhe papunësinë, sigurimit të mundësive të barabarta dhe jetës kualitative për të gjithë.

- ◆ Për këto arsye, nevojitet të kuptohet lidhja midis gjinive, varfërisë dhe punësisë dhe njëkohësisht nevojitet të kuptohet se aritja e barazisë më të madhe gjinore dhe ballafaqimi me pabarazitë e vazhdueshme, shumë shpesh nënkupton që të punohet në mënyra të ndryshme me gratë dhe me burrat, me qëllim që të detektohen pengesat e ndryshme me të cilat ballafaqohen ato, por edhe nevojat, prioritetet dhe mundësitë.
- ◆ Politikat aktive për punësim e përfshijnë vetëm kategorinë e qytetarëve të paraqitur në APRM, të cilët kërkojnë punë. Me këto politika nuk është përfshirë popullata joaktive, pjesën më të madhe të së cilës e përbëjnë gratë. Barazia gjinore është parim fundamental i Strategjisë evropiane për punësim, qëllimi kryesor i të cilës është “të integrohen sa më shumë qytetarë në tregun e punës” dhe ta përmirësojnë pozitën e grupeve dhe individëve, sidomos të atyre që gjenden në margjinat e tregut të punës. Prandaj, një nga aspektet kryesore të përfshirjes së çështjeve gjinore në politikat për punësim është që ato të mos jenë restriktive, por të jenë të hapura për të gjithë qytetarët, duke i përfshirë edhe qytetarët joaktiv.
- ◆ Në këtë drejtim, rekomandojmë se ekziston nevoja për hapje të politikave aktive

të punësimit edhe ndaj qytetarëve joaktiv dhe për implementimin e aktiviteteve me të cilat do të inkurajohet popullata joaktive, sidomos gratë, që të marrin pjesë në tregun e punës.

Përfshirja e perspektivave gjinore në rrjedhat kryesore nuk i përjashton politikat, programet dhe masat e dedikuara vetëm për gratë. Ekzistimi i grupit qëllimor gra, nuk duhet ta përjashtoj pjesëmarrjen e tyre në kategoritë e tjera të grupeve qëllimore.

Rekomandojmë të merret parasysh praktika e shumë vendeve evropiane, që të përdoret akses i dyfishtë: grupi qëllimor gra dhe gratë e përfaqësuara me të paktën 40% në kategoritë e tjera të grupeve qëllimore. Në këtë mënyrë edhe ndarja e mjeteve buxhetore për përdoruesit do të jetë shumë më e drejtë, krahasuar me ndarjen e tanishme.

- ◆ Institucionet në të ardhmen duhet të zhvillojnë metodologji, të cilat do të jenë në favor të qëllimeve dhe grupeve qëllimore të cilat dëshirojmë t'i realizojmë. Rekomandojmë të vlerësohet metodologjia e seleksionimit dhe kriterëve për vlerësim të kandidatëve, në përputhje me qëllimet e dokumenteve strategjike dhe të sigurohet mundësia për implementimin e masave provizore dhe të mekanizmave të tjerë, të cilët do të mundësojnë akses më të lehtë të grupeve qëllimore ndaj masës në fjalë.
Nevojitet përforsim, trajnim dhe sensibilizim të të gjitha palëve dhe institucioneve të involvuara në implementimin e politikave për punësim, komisioneve dhe trajnuesve. Trajnimet duhet t'i përfshijnë çështjet e përkatësive të ndryshme, mundësive të barabarta, aksesit të njëjtë të kategorive të ndryshme të përdoruesve dhe vlerësimin e beneficioneve të përdoruesve.
- ◆ Politikat aktive për punësim duhet të shoqërohen me Strategji gjithëpërfshirëse për informim, e cila do t'i marr parasysh kategoritë e ndryshme të përdoruesve (të rinjtë, gratë, personat e papunësuar për një periudhë të gjatë etj). Format dhe mënyrat e informimit dhe inkurajimit duhen përshtatur në përputhje me grupet qëllimore dhe me specifikimet rajonale, etnike dhe gjinore. Kjo gjë është me rëndësi të madhe nëse dëshirojmë të arrijmë deri tek pjesa joaktive e popullatës.
- ◆ Politikat aktive për punësim duhet të shoqërohen me fushata për përforsim të vetëdijes, lidhur me fuqinë e sipërmarrjes dhe krijimin e vizionit për jetë më të mirë dhe më kualitative. Këto fushata duhet të përshtaten ndaj kategorive të ndryshme të përdoruesve, ndërsa koncepti gjinor dhe konceptet e përkatësive të ndryshme duhet të bëhen pjesë e pandarë e planifikimit, implementimit dhe vëzhgimit të tyre.
- ◆ Ndihamë e shumëhershme dhe më e shpeshtë gjatë zhvillimit të bizneseve, nëpërmjet trajnimeve me përmbajtje të ndryshme (për lidhshmëri dhe sipërmarrje, deri në marketing dhe kontabilitet), këshillimeve dhe tutorisë, jo vetëm gjatë proceseve të fillimit të bizneseve, por edhe në fazat e mëvonshme të zhvillimit, mund të ndihmojë në përforsimin e vetëbesimit të përdoruesve dhe përdoruesve potencial që të rezistojnë në tregun e punës.
- ◆ Formimi i rrjeteve dhe grupeve për përkrahje duhet të jetë një nga mënyrat për inkurajim dhe përkrahje të personave që kanë filluar biznes por edhe të atyre të cilët akoma nuk kanë vendosur të fillojnë biznes. Akses i këtillë është shumë i rëndësishëm për gratë të cilat për shkak të rolit tradicional dhe dobësisë ekonomike nuk marrin guxim të ballafaqohen me sfidat e kohës së re.
- ◆ Të gjitha politikat dhe dokumentet strategjike të institucioneve, raportet dhe analizat, sidomos ato që kanë të bëjnë me politikat aktive për punësim, duhet të përmbajnë të dhëna statistikore të ndara sipas gjinive dhe të dhëna të kryqëzuara sipas përbërjes

etnike, vendbanimit, moshës dhe arsimit, duke i përfshirë edhe informatat analitike lidhur me gjinitë, të cilat i shpjegojnë dallimet statistikore. Të dhënat statistikore të ndara dhe të kryqëzuara në këtë mënyrë, duhet të jenë pjesë e pandarë të çdo analize qeveritare. Ato janë tepër të rëndësishme gjatë proceseve të planifikimit, por edhe të vëzhgimit dhe vlerësimit të politikave dhe programeve të realizuara. Në këtë kontekst, tepër i rëndësishëm është aksesin rajonal dhe lokal.

- ◆ Patjetër duhet të mundësohen mekanizma për vëzhgim dhe vlerësim të efekteve dhe ndikimit të politikave, strategjive dhe programeve për punësim, të cilat nuk duhet të jenë neutrale nga aspekti gjinor dhe të cilat duhet t'i marrin parasysh të dhënat statistikore të ndara sipas gjinive si dhe të dhënat e kryqëzuara sipas përbërjes etnike, vendbanimit, moshës, arsimit etj.
- ◆ Në kushte kur, potenciali më i madh i politikës shtetërore maqedonase është e orientuar drejt reformave ekonomike dhe ballafaqimin me varfërinë, nevojitet të mendohet edhe për mënyra të tjera alternative, të cilat do të inkurajojnë iniciativa në sferën e sipërmarrjes dhe do t'i inkurajojnë burrat dhe gratë që në mënyrë më aktive të inkuadrohen në tregun e punës.
Strategjitë për përkrahje dhe inkurajim të organizatave civile, iniciativave dhe/ose grupeve, misioni kryesor i të cilave është zvogëlimi i varfërisë, analizimi i tregut të punës, trajnimet dhe informimi në sferën e sipërmarrjes dhe në tema të tjera, mund të kontribuojnë në masë të madhe drejt zhvillimit të shoqërisë në tërësi. Organizatat civile nganjëherë i identifikojnë më mirë problemet dhe janë më të afërta me popullin, në krahasim me institucionet shtetërore. Përkrahja e grupeve femërore në këtë drejtim, gjithashtu është me rëndësi të madhe.
Programet për vetëpunësim financohen me të holla publike dhe prandaj nevojitet që të gjithë përdoruesit të kenë dobi të njëjtë nga realizimi i tyre.
- ◆ Prandaj rekomandojmë që Qeveria gjatë përgatitjes dhe implementimit të pakove financiare stimuluese, t'i identifikoj vështirësitë me të cilat ballafaqohen gratë e kategorive të ndryshme sociale, etnike, të moshave të ndryshme dhe të rajoneve të ndryshme në tregun e punës dhe ta përdor aksesin e dyfishtë: 1) të zhvilloj politika specifike për gratë si grup qëllimor (sipërmarrja femërore, programe për trajnim të grave, kredi për gratë si grup qëllimor etj.) dhe 2) t'i përfshij çështjet gjinore në të gjitha politikën, programet, strategjitë dhe planet zhvilluese.

Korniza nr. 1 Paraqitja e eksperiencave⁴⁷ të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, gjatë proceseve të inkuadrimin të çështjeve gjinore në programet reformuese nacionale, të bazuara në Strategjinë evropiane për punësim.

Spanja, në programin e saj për vetëpunësim parasheh përkrahje prej 3000 deri në 5000 euro për personat e papunë, të cilët do të fillojnë biznes privat. Në rastet e papunësisë së grave, kjo shumë arrin deri në 7000 euro.

Greçia ka paraparë sistem për inkurajim dhe përkrahje të sipërmarrjes së personat e rinj dhe të diplomuar. Ky sistem parasheh kuotë për pjesëmarrje të grave deri në 60%.

Italia ka paraparë një sërë masash fiskale për përkrahje të sipërmarrjes nëpërmjet zvogëlimit të tatimeve për sipërmarrësit dhe implementimit të masave të veçanta dhe tatimeve akoma më të vogla për punëdhënësit që do të sigurojnë marrëveshje pune me gratë. Kjo në veçanti vlen për rajonet e Italisë në të cilat papunësia e grave është 100% më e madhe nga përqindja e Bashkimit Evropian.

Luksemburgu ka paraparë sistem për akses në institucionet për përkujdesje të fëmijëve për familjet që gjenden në rrezik nga varfëria. Në këtë mënyrë bëhen përpjekje për inkurajim të punësimit të grave.

Slllovakia ka paraparë punë në shtëpi, me qëllim që të siguroj fleksibilitet më të madh për personat me detyra familjare.

Gjermania ka paraparë agjenci për sipërmarrjen femërore, e financuar nga Qeveria federale gjermane, nëpërmjet programeve për kreditim të ndërmarrjeve të vogla që udhëhiqen nga gratë.

Një pjesë e madhe e vendeve anëtare të BE-së bëjnë përpjekje të sigurojnë siguri fleksibile gjatë punës (flexicurity), e cila rezulton nga mundësitë për lidhje të aranzhmaneve me orar fleksibil të punës. Njëkohësisht mundësohen sisteme për mbrojtje dhe siguri sociale.

Sqarim: Siguria fleksibile (flexicurity) si term ka filluar të përdoret gjatë kryesisë së Bashkimit Evropian nga ana e Portugalisë, gjatë debateve për përmirësim të dialogut social dhe për reforma në strategjitë për punësim. Implementimi i sigurisë fleksibile bazohet në ligjet moderne të punës dhe në sistemin modern për mbrojtje sociale dhe arsimim të përjetshëm.

5.2 FORMALIZIMI I BIZNESEVE EKZISTUESE

Emri i programit

Formalizimi i bizneseve ekzistuese. Ka filluar në vitin 2008 dhe ka vazhduar në vitin 2009.

Institucionet kompetente për realizimin e projektit

Ministria e punës dhe politikës sociale (MPPS), Agjencia e punësimit të Republikës së Maqedonisë (APRM), Regjistri Qendror (RQ), Agjencia për përkrahje të sipërmarrjes të Republikës së Maqedonisë (APSRM), Programi për zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe USAID, të cilat janë kompetente për implementimin e programit me PO për vitin 2009.

Qëllimet (qëllimet eksplicite dhe implicite)

Qëllimet e programit për formalizim të bizneseve që drejtohen nga ana e personave të papunë dhe inkuadrimi i tyre legal në tregun e punës është në funksion

⁴⁷ Programet nacionale reformuese 2008 dhe aspektet gjinore të Strategjisë evropiane për punësim, Komisioni Evropian, Raporti, Mars i vitit 2009

të zvogëlimit të ekonomisë së zeze. Programi realizohet nëpërmjet ndihmës gjatë regjistrimit të biznesit të personave që kanë eksperiencë joformale dhe të cilëve u nevojiten subvencione për formalizim të biznesit.

Përshkrim i shkurtër i programit

Programi për formalizim të bizneseve aktuale është në funksion të zvogëlimit të ekonomisë së zeze dhe realizohet nëpërmjet ndihmës së personave që kanë eksperiencë joformale dhe të cilëve u nevojiten subvencione për formalizim të biznesit⁴⁸. Përkrahja nënkupton mbulim të shpenzimeve për regjistrim të firmës, deri në 3000,00 denarë; mjete financiare të pakthyeshme për blerje të pajisjeve/repromaterialeve dhe mjeteve të tjera, të nevojshme për biznesin, në shumë prej 153.000,00 denarë, pjesëmarrje në kontributet për sigurim social në bazë minimale, për rrogën neto në sfera të caktuara, në shumë prej 13.500,00 denarë, gjatë tre muajve të parë. Me këtë program përkrahen personat e evidentuar si të papunë, të cilat nuk mund të kthehen në evidencat e APRM gjatë tre viteve pas formalizimit të biznesit⁴⁹.

Grupet qëllimore

Personat që ushtrojnë veprimtari joformale dhe ato që janë të papunësuar mbi një vit.

Aktivite dhe masa

Masa do të realizohet nëpërmjet ndihmës për regjistrim të bizneseve aktuale të personave që kanë eksperiencë joformale dhe të cilëve u nevojiten subvencione për formalizim të biznesit.

ANALIZA GJINORE E PROCESIT DHE BUXHETIT:

Analiza e procesit

Aktivitetet dhe udhëzimet operative të Programit për formalizim të bizneseve aktuale realizohen në dy faza dhe në tetë hapa⁵⁰.

Faza e parë i përfshin aktivitetet e katër hapave të para, të cilat janë përfshirë edhe në Programin për vetëpunësim. Këto aktivitete janë: (1) Përgatitja e udhëzimeve operative, të cilat paraqesin dokument për Drejtimet operative, të përgatitura nga ana e grupit teknik dhe të pranuar nga ana e PNO⁵¹; (2) Shpallja publike; (3) Regjistrimi dhe seleksionimi i kandidatëve të paraqitur, sipas kriterëve të përcaktuara lidhur me përkatësinë në grupet qëllimore, duke e marrë parasysh përkatësinë etnike dhe raportin midis personave të papunë në kuadër të komunës me numrin e përgjithshëm të popullatës së komunës. Regjistrimi bëhet në Qendrat e punësimit, ndërsa seleksionimi bëhet me ndihmë të Regjistrimit Qendror (RQ)⁵²; (4) Zgjedhja e planeve më të mira për biznes bëhet nga ana e ekspertëve të bankave të zgjedhura (Komisioni i pavarur), të cilët i klasifikojnë planet më të mira për numrin e përcaktuar të përdoruesve të grupit adekuat qëllimor.

Pas kësaj fillon faza e dytë e aktiviteteve të projektit për formalizim të bizneseve. (5) Përkrahje për regjistrim dhe formalizim të bizneseve të sektorit joformal, për planet

48 Gjendja sociale e Maqedonisë, MPPS, Shkup, 2008

49 Plani operativ për programet aktive dhe masat për punësim për vitin 2008, MPPS, Shkup, janar i vitit 2008 faqja 8.

50 APRM, APSRM, UNDP "Vetëpunësimi 2 dhe Ndihma teknike për përkrahje të Planit operativ të Qeverisë për vitin 2008, lidhur me masat aktive të tregut të punës", mars i vitit 2008,

51 Drejtimet operative kanë të bëjnë me dy masat: vetëpunësimi (biznesi familjar) dhe formalizimi i biznesit aktual. Në Raportin, të dyja masat janë paraqitur në pikën 3, si 3.A-Vetëpunësimi dhe 3.B-Formalizimi

52 Fletëparaqitja e plotësuar dhe e nënshkruar mbetet në Qendrën përkatëse për punësim dhe paraqet dokument valid për klasifikimin e mëvonshëm të kandidatëve. Lista e kandidatëve të seleksionuar kontrollon në Regjistrin Qendror. Nëse do të konstatohet se kandidati ka regjistruar firmë, ai nuk do të merret parasysh për përfshirje të mëtejshme në programin.

më të mira për biznes, nga ana e UNDP, Regjistrimit Qendror dhe APRM, me anë të të cilëve mundësohet punësim (M1-M2)⁵³.

(6) Nënshkrim të kontratës; (7) Mundësim të grantit fillestar (mjeteve të pakthyeshme) për blerje të pajisjeve dhe materiale për fillim të biznesit formal. Gjithashtu janë përcaktuar edhe procedurat për sigurim të granteve në shumë prej 2 500 euro me kundërvlerë në denarë, deri në shumën prej 153 000 denarë. Procedurat janë definuar qartë nga aspekti i përshkrimit të veprimtarisë, pjesëmarrësve, përgjegjësia dhe korniza kohore për blerje, në shumë deri në 2500 dollarë dhe për blerje mbi 2500 dollarë⁵⁴.

(8) Hapi i fundit nga formalizimi i biznesit është participimi, i cili e nënkupton mbulimin e shpenzimeve të kontributeve për sigurim social nga ana e APRM, për rrogë në periudhë tremujore, në shumë prej 13.500,00 denarë.

Përshkrimi i shkurtër i këtij programi tregon se ai bazohet në Programin për vetëpunësim të vitit 2007.

Gjatë shqyrtimit të aplikimeve dhe vlerësimit të aplikuesve është arritur në konstatimin se disa prej tyre kanë biznese private, të cilat renditen në sferën e ekonomisë së zezë dhe prandaj të njëjtat janë përjashtuar nga Programi për vetëpunësim. Gjatë vitit në vijim u hap Programi për formalizim të bizneseve aktuale, në të cilin ofrohen pothuajse kushte të njëjta si ato në Programin për vetëpunësim. Përjashtim bëjnë shërbimet e paguara lidhur me përgatitjen e planeve për biznes, sepse drejtuesit e atyre bizneseve kanë përvojë dhe vetë i përgatisin planet. Kushtet e tjera janë të njëjta⁵⁵.

Në programet për vitet 2008 dhe 2009 nuk janë përmendur problemet gjinore edhe pse ato janë paraparë dhe rekomanduar nëpërmjet akteve nacionale⁵⁶. Grupi qëllimor i programit për formalizim të bizneseve aktuale është definuar vetëm në bazë të papunësisë dhe dijenisë për përvojë në biznesin joformal. Sipas kushteve të përgjithshme të Programit, nuk ekziston ndarje e veçantë të çështjeve gjinore. Megjithatë, rezultatet tregojnë se ekziston interesim i madh dhe aftësi nga ana e grave, që ato të udhëheqin biznes, sepse fakti që gratë udhëheqin me një të tretat e bizneseve të formalizuara, nuk është për t'u nënvlerësuar.

Edhe në Programin për formalizim, ashtu si në Programin për vetëpunësim, në të gjithë procesin, që nga paraqitja e deri në seleksionimin, mungojnë të dhënat sipas gjinisë (edhe pse e dhëna për gjininë është e shënuar në fletëparaqitjen e parë). Megjithatë, në bazë të kërkimeve të fundit të të dhënave për bizneset e formalizuara sipas gjinisë, analiza tregon se burrat janë të përfaqësuar me 69% në krahasim me gratë, të cilat janë të përfaqësuara me 31%, nga gjithsej 107 formalizimet e planifikuara dhe të realizuara në vitin 2008. Për shkak të interesit të madh për Programin u realizuan

53 Regjistri Qendror është në procedurë e sipër për t'i hequr shpenzimet për regjistrim të firmës për personat e vetëpunësuar me këtë projekt. MPPS siguron kushte që procedura e filluar të realizohet deri në fund, siç është paraparë në buxhetin e këtij projekti, ndërsa APRM do t'u ndihmoj personave të papunë të regjistrohen si persona të punësuar, nëpërmjet sigurimit të formularit M1-M2. Burimi njësoj si në fusnotën 4, faq.

54 APRM, APS dhe UNDP: "Vetëpunësimi 2 dhe ndihma teknike për përkrahje të Planit operativ të Qeverisë për vitin 2008, lidhur me masat aktive të tregut të punës" Udhëzimet operative, mars i vitit 2008

55 Duke u thirrur në aktivitetet e Programit për vetëpunësim, mund të konstatohet se nuk janë përcaktuar qartë kushtet dhe dallimet e Programit për përkrahje të formalizimit të bizneseve aktuale dhe për vetëpunësim. Të dyja programet kanë të bëjnë me vetëpunësimin, por mbi baza të ndryshme. Gjithashtu, ato nuk janë përmendur në veçanti as në Planin operativ për vitin 2008, në të cilin gjenden nën titullin 2. Programi për përkrahje të bizneseve aktuale qëndron "aktivitetet e programit 1 kanë të bëjnë edhe me këtë program, me përjashtim të aktiviteteve 4.1 dhe 5.1". MPPS: Plani operativ për programet aktive dhe masat për punësim për vitin 2008, Shkup, janar i vitit 2008, Aneksi 1, faqja 23, ndërsa në PO për vitin 2009 qëndron: aktivitetet e programit 1 kanë të bëjnë edhe me këtë program, përveç aktivitetit 4.1, ndërsa ndryshohet aktiviteti 5.1—i cili do të jetë si në vijim: Përgatitja-plotësimi i formularit për plan të vogël për biznes, në të cilin është prezantuar i gjithë biznesi, me të gjitha fazat dhe indikatorët e nevojshëm.

MPPS: Plani operativ për programet aktive dhe masat për punësim për vitin 2009, Shkup, janar i vitit 2009

56 Plani nacional aksionar për barazi gjinore 2006-2012 e shpreh rëndësinë jo vetëm të aksesit në mundësitë e barabarta, por edhe të rregullshmërisë së rezultateve. Të njëjtën gjë e parasheh edhe qëllimi strategjik për politikën aktive për vetëpunësim.

rorientime të mjeteve financiare për 6 formalizime plotësuese, me anë të të cilave, numri i përgjithshëm i formalizimeve u rrit në 113. Gjithashtu u ndryshua edhe raporti midis burrave dhe grave, i cili arriti në 32,7% formalizime të realizuara nga gratë dhe 67,3 % nga burrat. Në këtë kontekst, mungojnë të dhënat sipas përkatësisë etnike. Për shkak të mungesës së të dhënave nuk mund të realizohet analizë e kombinuar për përkatësinë gjinore dhe etnike, as për kandidatët e paraqitur dhe as për kandidatët e zgjedhur, e cila mund të jetë me rëndësi të madhe si për aspektin gjinor ashtu edhe për aspektin etnik.

Edhe në këtë Program, ashtu si në Programin për vetëpunësim, duhet theksuar fakti se instrumentet për vlerësimin e aftësisë personale, psikike, ekonomike dhe sipërmarrëse, të parapara në Pyetësorin për vetëvlerësim të afiniteteve sipërmarrëse, nuk janë përshtatur për gratë dhe nuk përmbajnë elemente inkurajuese për inkurajimin e tyre. Kjo në veçanti ka të bëjë me qëndrimet ose pyetjet e karakterit ekonomik (për pjesëmarrjen në të holla, për punësim të personave të tjerë, për sigurinë personale në aktivitetet e ndërrmarra etj.), në kushte të pabarazisë së gruas pikërisht në këtë sferë dhe në rolin e saj tradicional në familje dhe në shoqëri.

Edhe pse në politikat janë paraparë edhe aktivitete për vëzhgim të realizimit të masave aktive, nuk mund të fitohen përgjigje adekuate për plotësimin dhe mirëmbajtjen e programeve, përveç kontrollit të realizuar në kuadër të zbatimit të Programit, me anë të të cilit u konstatua se 113 bizneset e formalizuara gjatë vitit 2008 punojnë në përputhje me kushtet e formalizimit. Kjo gjë, në mënyrë indirekte, flet për shkallën e plotësimin dhe të suksesit të biznesit, por periudha kohore është shumë e shkurtër që të vërtetohet indikator i suksesit. Nevojiten të paktën hulumtime të vogla të grupit qëllimor, që të konstatohet gjendja. Nga bisedat me implementuesit, mund të arrihet në konkluzionin se projekti ka arritur sukses.

ANALIZA E BUXHETIT

Nga të dhënat për buxhetin e viteve 2008 dhe 2009 vërehet rritja e mjeteve për të gjitha programet dhe masat. Gjatë realizimit të Programit për formalizim të bizneseve aktuale në vitin 2008, u bë rindarje të mjeteve financiare nga programe të tjera (fëmijë pa prindër dhe prindër kryefamiljar), hap i cili ndikoi që mjetet e realizuara të jenë më të mëdha se mjetet e planifikuara. Ndryshimi i tillë është i mirë nga aspekti i punësimit, por jo edhe nga aspekti i implementimit të Programeve të caktuara. Vërehet qartë suksesi në zvogëlimin e pjesëmarrjes në ekonominë e zezë, nëpërmjet Programit për formalizim të bizneseve. Prandaj, nevojitet që mjetet për këtë qëllim të dyfishohen. Gjatë analizimit të Programit, janë shqyrtuar të dhënat për vitet 2008 dhe 2009 sepse Programi për formalizim filloi në vitin 2008, ndërsa duke i marrë parasysh mjetet e planifikuara i njëjti u realizua. Në vitin 2009, shumë e përgjithshme për pjesëmarrja në Planin operativ është zvogëluar. Arsytet për një gjë të tillë qëndrojnë në sjelljen e programeve të reja. Prandaj nuk mund të parashtrahet pyetja për suksesin e realizimit të Programit. Duke e marrë parasysh qëllimin kryesor, në vitin 2008 Programi është maksimalisht i suksesshëm. (Tabela nr. 17)

Tabela nr. 17: Buxheti i Planit operativ për Planin aksionar për punësim, në vitet 2008 dhe 2009 dhe pjesëmarrja në Programin për formalizim të bizneseve aktuale (pa e paraqitur Programin për përkrahje të Romëve gjatë punësimit dhe Programin për vetëpunësim nëpërmjet kreditimit, të cilat në vitin 2008 nuk kanë qenë pjesë të PO).

Buxheti	Viti	Buxheti për Programin për formalizim, në vitin 2008	Buxheti për PO për PAP, për vitin 2008	Pjesëmarrja e Programit për formalizim në buxhetin e përgjithshëm të PO për PAP
I planifikuar	2008	18.136.500,00	294.191.921,00	6,16 %
I realizuar	2008	19.153.500,00	275.560.821,00	6,95 %
I planifikuar	2009	47.000.000,00	825.102.860,00	5,69 %
I realizuar	2009	-	-	-

Tabela nr. 18. Përdoruesit e ndarë sipas gjinisë, në programin për vitin 2008

Lloji i masës	Nr. i përdoruesve	Nr. i grave	Nr. i burrave	% e grave	% e burrave
Formalizimi	113	35	78	33 %	67%

Barazia gjinore është inkuadruar në përdorimin e mjeteve, nga aspekti se çdo person, pa dallim të gjinisë, fiton mjete të barabarta. Por, duke e pasur parasysh shumën e mjeteve, gratë në këtë Program marrin pjesë me 1/3 dhe prandaj e përdorin edhe për gratë të tretat e mjeteve.

Në këtë kontekst duhet theksuar fakti se në fillim të përdorimit të mjeteve për formalizim (dhe për vetëpunësim) jepet shumë prej 2500 euro. Prandaj, nëpërmjet të dhënave mund të konstatohet me siguri se përqindja është e barabartë si për burrat ashtu edhe për gratë dhe prandaj është dhënë sipas personave. Aspekti gjinor anashkalohet.

Tabela 19. Buxheti i ndarë sipas gjinive për Programin për përkrahje të formalizimit të bizneseve aktuale

Lloji i masës	Buxheti në denarë	Nr. i përdoruesve	Shpenzimet për njësi	Ndarja e buxhetit sipas gjinive Gra Burra
Formalizimi	19.153.500,00	113	169.500,00	5.932.500,00 13.221.000,00

Sipas kësaj, shpenzimet për burrat dhe për gratë, si multiplikim të numrit të përdoruesve, sipas shpenzimeve për njësi, janë të barabarta dhe nuk mund të konstatohen dallime, përveç në shumën e përgjithshme, sepse burrat janë të përfaqësuar me 2/3 dhe prandaj atyre u takojnë 2/3 e mjeteve të përgjithshme financiare (Tabela 19).

Kontrolli i stabilitetit të firmave të reja është realizuar brenda një periudhë të shkurtër pas formimit të tyre dhe është konstatuar se ato punojnë në përputhje me veprimtarinë të cilën e kanë regjistruar.

Duke e pasur parasysh përkatësinë etnike, mund të konstatohet se është punuar shumë pak në promovimin e programit nga aspekti gjinor, etnik dhe rajonal. Prandaj, duhet nënvizuar se për pjesëmarrje më të madhe në këtë program, nevojitet të punohet më intensivisht në informimin, promovimin dhe popullarizimin e tij, sepse këtë fakt e tregojnë të dhënat e vitit 2008, sipas të cilave nga 384 persona të paraqitur (gjatë hapit të parë) vetëm 120 prej tyre kanë kaluar në procedurë të mëtejshme, për shkak se vetëm ato i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e seleksionimit.

Tabela 20. Buxheti i Programit për formalizim të bizneseve aktuale sipas përkatësisë etnike.

Përkatësia etnike	Nr. i përdoruesve	Ndarja e buxhetit sipas përkatësisë etnike
Maqedonas	101	17.119.500,00
Shqiptarë	4	678.000,00
Serbë	1	169.500,00
Të panjohur	7	1.186.500,00
Gjithsej	113	19.153.500,00

Përdorues të shërbimeve dhe të hollave, sipas të dhënave të paraqitura më sipër në formë tabelare, janë gjithsej 113 persona, 78 prej të cilëve janë burra, ndërsa 35 janë gra. Nuk ekzistojnë të dhëna të ndara sipas vjetërsisë dhe rajonit rural-urban, ndërsa sipas përkatësisë etnike të përdoruesve, 101 prej tyre janë maqedonas, 4 janë shqiptarë, 1 serb, ndërsa për 7 përdorues të tjerë nuk ekzistojnë të dhëna për përkatësinë etnike dhe për gjininë.

Numri i përgjithshëm i personave që kanë parashtruar kërkesa është 384, ndërsa të dhënat nuk janë ndarë sipas gjinisë.

Të dhënat sipas gjinisë i kemi fituar në bazë të raporteve të implementuesve dhe nëpërmjet kontrolleve të masave aktive për punësim, të cilat në raste të caktuara nuk përputhen.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME⁵⁷

Analizimi i masës aktive të quajtur Formalizimi i bizneseve aktuale, në kuadër të politikave aktive qeveritare për zvogëlim të varfërisë së popullsisë, realizohet nga viti 2008 dhe prandaj është vështirë të vërtetohet efikasiteti dhe stabiliteti i saj. Megjithatë, të dhënat e periudhës së shkurtër të deritanishme tregojnë se masa në fjalë e arsyeton qëllimin e saj kryesor, përkatësisht rritjen e numrit të personave të punësuar dhe zvogëlimin e pjesëmarrjes së ekonomisë së zezë në tregun e punës. Për këtë fakt flet edhe interesi i personave të papunë dhe pjesëmarrja e tyre në realizimin e masës, e cila e tejkalon numrin e paraparë, që nga ana tjetër e shpreh dëshirën e popullatës për ta legalizuar punën e saj dhe statusin punues, nëse ekzistojnë përpjekje dhe ndihmë minimale shoqërore.

- ◆ Megjithatë, në bazë të analizimit të Programit nuk mund të konstatohet aspekti gjinor i masës në fjalë. Në këtë rast mungon akses i gjinor dhe i njëjti u është lënë rastësisë. Aspekti gjinor nuk është planifikuar as gjatë përgatitjes së masës, që rezulton me mungesë të mundësisë që përdoruesit të ndahen dhe paraqiten sipas gjinisë, pa përpunim plotësues të materialeve.
- ◆ Pjesëmarrja e grave dhe burrave në punën e papaguar dhe në ekonominë e zezë është e madhe dhe nuk kontribuon në zhvillimin ekonomik dhe në zhvillimin e vendit. Prandaj rekomandojmë të sigurohen mekanizma për përfshirje sa më të madhe, sidomos të grave, në fuqinë punuese dhe të rritet shkalla e tyre e aktivizimit. Rekomandohet të merren parasysh veprimtaritë specifike, të cilat janë karakteristike për rajone të caktuara të vendit, përkatësisht të merren parasysh resurset rajonale natyrore dhe njerëzore në Programet për formalizim dhe vetëpunësim.
- ◆ Rekomandohet që MPPS të formoj bazë me të dhëna për të gjitha sferat e saj, në rastin konkret për APRM dhe për mbrojtjen sociale sipas gjinive.

⁵⁷ Pjesa më e madhe e konkluzioneve dhe rekomandimeve të masave për vetëpunësim dhe formalizim përputhen. Prandaj, nevojitet vëzhgimi i tyre i detajuar. Në këtë pjesë i paraqesim vetëm konkluzionet dhe rekomandimet më të rëndësishme.

- ◆ Rekomandohet që të gjitha implementuesit e Programeve të kujdesen për respektimin e konceptit të barazisë gjinore, të paktën në pjesët të cilat janë të rregulluara me ligj, ndërsa ndarja e të dhënave sipas gjinisë, përkatësisë etnike, vendbanimit, moshës etj. të respektohet nga fillimi deri në fund të procesit të seleksionimit.
- ◆ Nevojiten hulumtime të mëtejshme, të ndara sipas gjinive, për vëzhgimin e punës së bizneseve të legalizuara dhe hulumtime të veçanta për arsyet që e mundësojnë ose e vështirësojnë funksionimin e biznesit, në një afat të gjatë dhe për arsyet e zgjidhjes së përhershme të papunësisë.

5.3 PROGRAMI PËR SUBVENCIONIM TË PUNËSIMIT

Emri i programit

Subvencionimi i punësimit në vitet 2007, 2008 dhe 2009.

Institucionet kompetente për realizimin e projektit

Ministria e punës dhe politikës sociale (MPPS), Agjencia e punësimit të Republikës së Maqedonisë (APRM), Qendrat e punëve sociale (QPS).

Qëllimet (qëllimet eksplicite dhe implicite)

Programi parasheh edhe masa në sferën e mbrojtjes sociale, me qëllim që të krijoj sistem efikas të mbrojtjes sociale dhe të mundësoj angazhim produktiv të kategorive të popullatës së rrezikuar nga aspekti social, për zvogëlim të varfërisë dhe për inkuadrimin e tyre në tregun e punës dhe në jetën normale.

Përshkrim i shkurtër

Me Programin e Qeverisë së RM për vitet 2006-2012, me masat aktive, janë përfshirë kategoritë e rrezikuara nga aspekti social⁵⁸. E atillë është masa e paraparë, e cila ka të bëjë me subvencionimin e punësimit dhe e cila ka filluar të zbatohet në vitin 2007 dhe ka vazhduar gjatë viteve 2008 dhe 2009, duke pasur disa ndryshime dhe plotësime të caktuara. Në vitin 2007, ky Program u implementuar nëpërmjet tre masave, në kuadër të të cilave është paraparë subvencionimi i punësimit të personave të papunë të kategorive të rrezikuara nga aspekti social (personat me invaliditet, prindërit kryefamiljar dhe fëmijët pa prindër). Në vitin 2008, Programi për subvencionim është zgjeruar me grupin për punësim të personave të moshuar (personat nga 55 deri në 64 vjet). Të katër masat kanë vazhduar edhe në vitin 2009, me më shumë mjete financiare.

Grupi qëllimor

Personat e evidentuar si të papunë, statusi i të cilëve është si në vijim: fëmijë pa prindër pas daljes nga institucioni për përkujdesje; persona me invaliditet, në përputhje me Ligjin për punësim të personave me invaliditet; prindër kryefamiljar; persona të moshuar, nga 55 deri në 64 vjet, të evidentuar si të papunë (nga vitet 2008 dhe 2009), të rinj deri në moshën 27 vjeçare dhe persona të papunë, të cilëve marrëdhëniet e punës u janë ndërprerë për shkak të falimentimit të ndërmarrjeve në cilat shteti ka mbi 50% të aksioneve. Subvencionimi i punësimit të këtij grupi fillon nga viti 2008.

Aktivitete dhe masa

Agjencia e punësimit shpall thirrje publike për punëdhënësit, për t'i punësuar grupet e rrezikuara dhe të papunësuarat të qytetarëve. Subvencionimi i personave me invaliditet është paraparë në Planin operativ për Politikat aktive në vitin 2007 dhe i njëjti edhe më tej paraqet pjesë e aktiviteteve të APRM.

Subvencionimi i punësimit të personave me hendikep (invaliditet) bëhet në përputhje me Ligjin për punësim të personave me invaliditet, në shumë prej 20-30 rroga

58 Gjendja sociale në RM, në vitin 2008, MPPS, faqja 58

mesatare mujore për punësim të një personi me invaliditet nga ana e firmave, për të cilat janë paraparë edhe ndihma të tjera financiare, në bazë të Ligjit.

Në vitin 2007, për përkrahje të punësimit të 500 prindërve kryefamiljar dhe 100 fëmijëve pa prindër, është paraparë subvencionim të punësimit nëpërmjet ndihmave financiare nga ana e shtetit, shuma e të cilave arrin në 11.200 denarë në muaj (rrogë dhe kontribute, ushqim dhe transport, por jo më shumë se 11.200 denarë në muaj), për një periudhë 6-mujore. Punëdhënësi obligohet që peronat e punësuar, për të cilat pranon ndihmë, t'i mbaj në punë të paktën edhe 18 muaj të tjerë pas kalimit të afatit 6-mujor, gjatë të cilit ka pranuar subvencione.

Në vitin 2008 janë ndryshuar përfshirja dhe kushtet. Subvencionet janë paraparë për 50 fëmijë pa prindër, nëpërmjet përkrahjes financiare për rrogë, kontribute për rrogë, ushqim dhe transport, në shumë prej 15.000,00 denarë në muaj, për nëntë muaj, me detyrim që punëdhënësi, këto personi t'i mbaj në punë të paktën 18 muaj pas subvencionimit, ose gjithsej 27 muaj.

Për përkrahje të punësimit të 200 prindërve kryefamiljarë është paraparë ndihmë financiare për punëdhënësit në shumë prej 12.000,00 denarë në muaj, për rroga, kontribute për rrogë, ushqim dhe transport, për një person, për një periudhë 6-mujore.

Për përkrahje të punësimit të 150 personave moshuar të papunësuar është paraparë ndihmë financiare për punëdhënësit në shumë prej 12.000,00 denarë në muaj, për rroga, kontribute për rrogë, ushqim dhe transport, për një person, për një periudhë 9-mujore.

Subvencionimi për punësim të të rinjve deri në moshën 27-vjeçare dhe të personave të papunë, të cilëve marrëdhëniet e punës u janë ndërprerë për shkak të falimentimit të ndërmarrjeve në të cilat shteti ka mbi 50% të aksioneve.

Nëpërmjet kësaj mase, gjatë 18 muajve të parë të punësimit, është paraparë të sigurohet përkrahje financiare për kontributet për sigurim shëndetësor për punëdhënësit që do të punësojnë persona deri në moshën 27-vjeçare të evidentuar si të papunë dhe persona të papunë, të cilëve marrëdhëniet e punës u janë ndërprerë për shkak të falimentimit të ndërmarrjeve në të cilat shteti ka mbi 50% të aksioneve. Punëdhënësi është i detyruar që personat e punësuar me ndihmë të kësaj përkrahjeje financiare t'i mbaj në punë të paktën 2 vjet pas punësimit. Shpenzimi mujor për një person është paraparë të arrijë në 2.234 denarë, ose 11.170,00 denarë për 5000 persona.

ANALIZA GJINORE E PROCESIT DHE BUXHETIT

Procesi i implementimit dhe koordinimi midis institucioneve

Në programin për subvencionim të punësimit të kategorive të rrezikuara të qytetarëve të papunë, ballafaqohemi me një situatë të veçantë të raporteve të ndërsjella midis institucioneve shtetërore, si implementues të Programit nga njëra anë, punëdhënësve dhe përdoruesve nga ana tjetër. Problemi qëndron në definimin e grupeve qëllimore sepse me masat e Politikës për subvencionim, ndaj tyre ndikohet nëpërmjet masave për subvencionim, që kanë të bëjnë me nevojat e punëdhënësve, ndërsa ndikimi ndaj përdoruesve është indirekt. Punëdhënësit janë ndërmjetësues për një periudhë të caktuar, ndërsa pagesa gjatë periudhës në fjalë bëhet nga ana e APRM. Prandaj, aktivitetet dhe promovimi duhen orientuar edhe ndaj punëdhënësve si hallkë ndërmjetësuese midis subvencionuesit dhe përdoruesit të fundit. Motivi i punëdhënësit është që ai të fitoj kualitet adekuat gjatë punës dhe nevojën për plotësim të vendeve të punës ta zgjidh për një afat më të gjatë kohor. Nëse arrihet që Programi dhe masat

të popullarizohen tek pjesa më e madhe e punëdhënësve, implementimi do të jetë i suksesshëm edhe për përdoruesit indirekt, të cilët në këtë rast janë definuar si grupe qëllimore të rezikuara nga aspekti social. Në këtë rast, shpallja e vendeve të punës është orientuar drejt punëdhënësve dhe grupeve kritike të popullatës, për të cilët, të dhënat që i nevojiten Qendrave të punësimit i sigurojnë Qendrat e punëve sociale. Punëdhënësit i zgjedhin kandidatët adekuat për nevojat e tyre, në bazë të të dhënave të Qendrave të punësimit.

Gjatë rekrutimit për Programet për punësim marrin pjesë më shumë institucione: APRM, Qendrat e punëve sociale dhe MPPS. Agjencia e punësimit i ndërmerr të gjitha aktivitetet standarde për subvencionim të punësimit të personave me hendikep (në vitin 2008, të karakterizuar si persona me invaliditet), në përputhje me Ligjin për punësim të personave me invaliditet.

MPPS (Sektori për mbrojtje sociale) nga Qendrat e punëve sociale kërkon të dhëna për fëmijët pa prindër dhe për prindërit kryefamiljar. Qendrat janë të detyruara të sigurojnë të dhëna për prindërit kryefamiljar sipas numrit të tyre, kualifikimeve, aftësive, vendbanimit (vendi, qyteti etj. në të cilët ato mund të angazhohen në punë), numrit të fëmijëve, moshës dhe të dhëna të tjera relevante, si dhe të dhëna për fëmijët pa prindër (numri, kualifikimet, aftësitë, vendbanimi) dhe të dhëna të tjera relevante (vendi, qyteti etj. në të cilët ato mund të angazhohen në punë). Të dhënat i dorëzohen MPPS.

Në bazë të listave dhe të dhënave që i dorëzohen MPPS nga ana e Qendrave të punëve sociale, Sektori për mbrojtje sociale përgatit rang listë për prindërit kryefamiljarë dhe rang listë për fëmijët pa prindër dhe të njëjtat i dorëzon në APRM.

Në bazë të rang listës për prindërit kryefamiljarë (të papunësuar) APRM publikon shpallje për thirrje publike për punëdhënësit e interesuar për angazhim të prindërve kryefamiljarë, në përputhje me kushtet e parapara më këtë masë, ndërsa punëdhënësit i zgjedhin punonjësit sipas nevojave të tyre.

Në bazë të shpalljes së publikuar, APRM me punëdhënësit e interesuar dhe të paraqitur, lidh marrëveshje për angazhim të personave për një periudhë 6-mujore, në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese dhe kushtet dhe mënyra e financimit për punësimin e prindërve kryefamiljarë.

APRM i paguan rregullisht shumat e parapara mujore për angazhimin e prindërve kryefamiljarë nëpërmjet kësaj mase, në bazë të raportit të parashtruar, lidhur me punën e realizuar nga ana e punëdhënësve, tek të cilat janë angazhuar këto persona.

Nëse nevojitet, APRM siguron kurse dhe trajnime plotësuese për fëmijët pa prindër dhe trajnime për prindërit kryefamiljarë, të përfshirë me këtë masë.

Efektiviteti i implementimit të Programit

Të dhënat për implementimin e Programit janë të pakta dhe informatat kryesore janë fituar nga Raporti për realizimin e politikave-masave aktive për punësim të Planit operativ për politikat aktive për punësim, për vitin 2007; të cilat janë paraparë me Programin për punësim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për vitet 2006-2010 (gjendja më 31.12.2007); nga Informata për implementimin e masave dhe programeve aktive për punësim, për vitin 2008 dhe nga udhëzimet për përgatitje të Planit operativ për masat dhe programet aktive për punësim, për vitin 2009, të përpiluara nga ana e MPPS dhe APRM.

Nga këto të dhëna arrihet në konkluzionin se bëhet fjalë për një masë unike, e cila njëkohësisht është edhe e pasuksesshme, sidomos kur bëhet fjalë për fëmijët pa prindër dhe për prindërit kryefamiljar, për shkak të numrit të vogël të punësimeve të realizuara në vitin 2007. Për shembull, pas thirrjes së parë dhe të dytë publike drejtuar

punëdhënësve kanë filluar dhe janë realizuar me sukses një numër i vogël punësimesh: 69 punësime nga gjithsej 500 punësimet e planifikuara për prindërit kryefamiljar dhe 3 nga 100 punësimet e planifikuara për fëmijët pa prindër, përkatësisht, vetëm 12% nga 600 punësimet e planifikuara për vitin 2007 u punësuan nëpërmjet subvencionimit. Prandaj, konsiderohet se numri i punësimeve të planifikuara për 500 prindër kryefamiljar dhe 100 fëmijë pa prindër nuk mund të realizohet.

Disa nga arsytet më kryesore që ndikojnë në mosrealizimin e këtij qëllimi janë: grupi qëllimor nuk është atraktiv për punëdhënësit, sepse ato janë me nivel të ulët të arsimit, strukturës kualifikuese, kanë status të ulët social, janë nëna më fëmijë të vegjël etj⁵⁹. Nga njëra anë ekzistojnë mendime sipas të cilave numri i planifikuar prej 600 persona (500 prindër kryefamiljar dhe 100 fëmijë pa prindër) nga numri i përgjithshëm prej 2500, të cilat janë të evidentuara në MPPS, është shumë ambicioz, ndërsa nga ana tjetër, përvojat tregojnë se sektori privat nuk i pranon me lehtësi këto grupe qëllimore.

Prandaj, sfida e radhës duhet të jetë inkurajimi i sektorit privat që të mundësoj punësim të këtyre grupeve qëllimore, duke mundësuar shumë më të madhe mujore, të cilën do t'ua siguroj shteti punëdhënësve për punësimin e këtyre personave. Një gjë e tillë është realizuar në Planin operativ për vitin 2009⁶⁰.

Gjithashtu, sipas informatave të fituara nga APRM, shuma që jepet si subvencionim për punësimin e personave të këtyre grupeve qëllimore nuk është mjaft tërheqëse për punëdhënësit.

Në prezantimin në vijim⁶¹ është dhënë gjendja për punësimet sipas grupeve të veçanta, të realizuara në vitin 2008, pas përfundimit të dy thirrjeve publike:

Subvencionimi për punësim të fëmijëve pa prindër: janë lidhur 4 kontrata për punësim.

Subvencionimi për punësim të personave me invaliditet: janë punësuar 12 ose 56% nga 200 personat e planifikuar, me shpresë se deri në fund të vitit do të punësohen të gjithë personat.

Subvencionimi për punësim të prindërve kryefamiljar: janë punësuar 80 ose 48% nga 200 personat e planifikuar.

Subvencionimi për punësim të personave të moshuar (nga 55 deri në 64 vjet): Janë lidhur 142 kontrata për punësim nga 150 ose 95% të punësimeve të planifikuara.

Subvencionimi për punësim të të rinjve deri në moshën 27-vjeçare dhe personave të papunësuar, të cilëve marrëdhëniet e punës u janë ndërprerë për shkak të falimentimit të ndërmarrjeve, në të cilat shteti ka marrë pjesë me mbi 50% të aksioneve. Sipas informatave të Fondit për sigurim shëndetësor, mjete financiare për sigurim shëndetësor⁶² janë kërkuar vetëm për 50 persona.

Problemet gjinore nuk janë dhënë as në Planin operativ dhe as në realizimin e programit dhe të masave për punësim. Për sa u përket personave me hendikep, të njëjtat punësohen sipas kushteve të përcaktuara me Ligj të veçantë. Nga numri i përgjithshëm i personave me hendikep të evidentuar si të papunë në APRM në vitin

59 Raport për realizimin e politikave-masave aktive për punësim të Planit operativ për politikat aktive për punësim, për vitin 2007, të cilat janë paraparë me Programin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për punësim, për vitet 2006-2010 (gjendja më 31.12.2007), faqja 23

60 Raport për realizimin e politikave-masave aktive për punësim të Planit operativ për politikat aktive për punësim, për vitin 2007, të cilat janë paraparë me Programin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për punësim, për vitet 2006-2010 (gjendja më 31.12.2007), faqja 21

61 Informata për implementimin e masave dhe programeve aktive për punësim, për vitin 2008 dhe udhëzimet për përgatitje të Planit operativ për masat dhe programet aktive për punësim, për vitin 2009, të përpiluara nga ana e MPPS dhe APRM

62 E njëjta faqe

2007, 34,9% janë gra, ndërsa në vitin 2008⁶³ numri i grave të evidentuara ka qenë 34,1%. I njëjtë është raporti edhe gjatë punësimit, por në kontekstin shoqëror, krahas shkallës së invaliditetit, duhet të merret parasysh edhe dimensionin gjinor të personave me invaliditet.

Ajo që është me rëndësi nga aspekti gjinor për prindërit kryefamiljarë është pikërisht pyetja, pse burrat dhe gratë të cilët kujdesen vetë për fëmijët, nuk e pranojnë masën ose e pranojnë atë me një përqindje shumë të vogël prej 48% dhe pse punëdhënësit nuk i pranojnë prindërit kryefamiljarë. Supozimi i parë, i cili ka të bëjë me gratë kryefamiljare, është se gruaja që jeton vet me fëmijë, pa dallim të arsyeve të gjendjes së atillë (nënë jashtëmartesore, ve, e divorcuar), është e eksponuar në ndikimin e stereotipave të caktuara në ambientin jetësor dhe punësor, ndërsa supozimi i dytë, i cili vlen për të gjithë, ka të bëjë me lidhjen specifike midis të ardhurave që fitohen si ndihmë sociale dhe të ardhurave që fitohen nga punësimi, përkatësisht bëhet fjalë për vlerësim të dobisë nga punësimi, krahasuar me ndihmën sociale. Vlerësimi i atillë bëhet sepse vet punësimi ka edhe shpenzime plotësuese për prindërit kryefamiljarë, siç janë: organizimi i ruajtjes së fëmijëve, shpenzimet rrugore për të shkuar në punë etj. Kur bëhet fjalë për politikën aktive për punësim, është me interes shoqëror t'i përkushtohet vëmendje sa më të madhe grupeve të sipërpërmendura të popullsisë, sidomos prindërve kryefamiljarë dhe personave të moshuar, për të cilët aspekti gjinor i buxhetimit rrjedh nga elemente të caktuara biologjike ose demografike.

Gjithashtu, mund të supozohet se punëdhënësit nuk janë të interesuar për të punësuar prindër kryefamiljarë sepse janë skeptik për efikasitetin e tyre, si për shembull, lidhur me mungesën në punë për shkak të fëmijës së sëmurë, pamundësinë për punë jashtë orarit e të tjera. Ndoshta kjo masë duhet të parashikoj edhe lloje të tjera të përkrahjes/inkurajimit, siç janë shpenzimet më të vogla për ruajtjen e fëmijëve ose lehtësime të tjera për fëmijët. Në këtë mënyrë, prindërit kryefamiljarë do të fitojnë stimulime plotësuese për të kërkuar punë në mënyrë aktive dhe të mos mbështeten vetëm në përkrahjen pasive që e fitojnë nga shteti, përkatësisht në të ardhurat nga ndihma sociale. Kjo ndihmë është më e lirë për prindërit kryefamiljarë, por njëkohësisht më e shtrenjtë për shtetin sepse nga aspekti financiar ajo paraqet vetëm shpenzim. Përkrahja në fjalë nga pikëpamja shoqërore, paraqet pamundësi për inkuadrim të grupeve kritike në shoqëri.

Nga aspekti gjinor, gjithashtu u konstatua fakti se gjatë fillimit të implementimit të të masave për subvencionim dhe gjatë rekrutimit të grupeve qëllimore, i cili realizohet nëpërmjet Qendrave për punë sociale, ndërsa listat përcaktohen nga ana e MPPS, nuk merret parasysh gjinia për cilindo hap gjatë seleksionimit ose gjatë ofrimit të mëtejshëm të fuqisë punëtore tek punëdhënësit. As punëdhënësit nuk kanë ndonjë përparësi, nëse punësojnë gra. Respektohen vlerat e tregut, kështu që punëdhënësit gjatë zgjedhjes së punëtorëve për nevojat e tij, udhëhiqet nga kriteret e tregut. Kjo do të thotë se përkatësia etnike nuk ka asnjë ndikim në inkurajimin, rekrutimin, klasifikimin gjatë seleksionimit, ofertën ndaj punëdhënësve dhe nuk ka avancim të perspektivës gjinore në Programin për subvencionim të punësimit.

Prandaj, rekomandohet që në politikën aktive për punësim të sigurohen mekanizma për implementim të aksesit gjinor dhe për avancimin e perspektivës gjinore, sidomos kur politikën realizohen në nivel institucional.

⁶³ E dhënë e përlogaritur nga Paraqitja e numrit të personave invalidë të evidentuar si të papunësuar sipas moshës së tyre, gjendja në 31.12.2007 dhe në 31.12.2008.

ANALIZA E BUXHETIT

Para fillimit të analizës së buxhetit, duhet t'i përkushtohet vëmendje gabimeve gjatë prezantimit të të dhënave, për shkak të mungesës së të dhënave të ndara sipas gjinisë gjatë dy viteve të analizuara dhe në të gjitha kategoritë e grupeve qëllimore. Prandaj, për vitin 2007 nuk janë paraqitur në mënyrë tabelare, ndërsa për vitin 2008 nuk ekzistojnë të dhëna të ndara sipas gjinive për kategorinë Persona me invaliditet dhe prandaj, nuk mungojnë të dhëna sipas gjinisë edhe për masën e subvencionimit në përgjithësi. Në tabelat, mungesa e të dhënave është theksuar në veçanti, por në rastet kur ka qenë e mundur analiza ka përfshirë edhe aspektin gjinor.

Në tabelën numër 21 është paraqitur ndarja sipas gjinisë së personave të angazhuar sipas kategorizimit të grupeve qëllimore të paraparë në Programin për subvencionim dhe buxhetit të ndarë sipas gjinive, në rastet kur një gjë e tillë është e mundur. Edhe një herë duhet theksuar se ndaj gjendjes së paraqitur në tabelat mund të parashtrohen vërejtje, për shkak të mungesës së të dhënave konzistente, por nga aspekti gjinor ajo nuk mund të ndryshoj shumë. Nëpërmjet tabelës mund të vërehet pjesëmarrja më e madhe e burrave të punësuar në të gjithë kategoritë, përveç në kategorinë e prindërve kryefamiljarë. Sipas të dhënave për familjet/amvisëritë, të fituara nëpërmjet Regjistrimit të popullatës në vitin 2002, numri i familjeve/amvisërive nëna me fëmijë është pothuajse katër herë më i madh, krahasuar me familjet e përbëra nga baballarë me fëmijë. Sipas këtyre të dhënave sqarohet ndarja e vendeve të lira të punës. Edhe tek personat me invaliditet, gjendja është proporcionale me raportin ekzistues, edhe pse është me rëndësi që edhe në këtë rast të merren parasysh rrethanat lidhur me gjendjes e grave në familjet dhe në shoqëri.

Tabela 21. Punësime të ndara sipas gjinisë dhe buxheti për punësimet e planifikuara dhe të realizuara sipas Programit për subvencionim të vitit 2008, i shprehur në denarë për një person.

Lloji i masës	Punësimet e planifikuara	Punësimet e realizuara					Mjetet e shpenzuara, në denarë
		Gjithsej	Nr. i burrave	Nr. igrave	Burra %	Gra %	
Subvencionim për punësim të:	600	338	-	-	-	-	94.436.000,00 për 1 person: 279.396,50
Fëmijë pa Prindër	50	4	3	1	75,0	25,0	540.000,00 për 1 person: 135.000,00
Persona me Invaliditet	200	112	-	-	-	-	72.800.000,00 për 1 person: 650.000,00
Prindër Kryefamiljarë	200	80	15	65	18,8	81,2	5.760.000,00 për 1 person: 72.000,00
Persona të Moshuar (55-64 vjet)	150	142	74	68	52,1	47,9	15.336.000,00 për 1 person: 108.000,00

Tabela 22. Buxheti i ndarë sipas gjinive për programin për subvencionim të punësimit, për vitet 2007 dhe 2008.

Lloji i masës	Viti	Buxheti në denarë	Nr. i përdoruesve	Shpenzimet për njësi	Shpërndarja e buxhetit sipas gjinisë	
					Gra	Burra
Subvencionimi i punësimit	2007	76.338.400,00	348	219.363,00	--	
	2008	94.436.000,00	338	279.396,50	--	
Prindër Kryefamiljarë	2007	4.636.800,00	69	67.200,00	-	
	2008	5.760.000,00	80	72.000,00	1.080.000,00 burra 4.680.000,00 gra	
Fëmijë pa Prindër	2007	201.600,00	3	67.200,00	-	
	2008	540.000,00	4	135.000,00	405.000,00 burra 135.000,00 gra	
Persona me Invaliditet	2007	71.500.000,00	276	259.058,00	-	
	2008	72.000.800,00	112	650.000,00	-	
Persona të Moshuar (55-64 vjet)	2007	-	-	-	-	
	2008	15.336.000,00	142	108.000,00	9.612.000,00 burra 5.724.000,00 gra	

Vërejtje: Shenja I

Lloji i Programit dhe masat për punësim	Punësimet-angazhimet e planifikuara		Mjetet e planifikuara		Punësimet-angazhimet e realizuara		Mjetet e shpenzuara	
	Viti	Numri	Shuma në denarë	%	Numri	%	Shuma në denarë	%
Subvencionimi i prindërve kryefamiljarë, personave me invaliditet dhe fëmijëve pa prindër								
Prindër Kryefamiljarë	2007	500	33.600.000,00	100	69	14	4.636.800,00	14
	2008	200	14.400.000,00	100	80	40	5.760.000,00	40
Fëmijë pa Prindër	2007	100	6.700.000,00	100	3	3	201.600,00	3
	2008	50	6.750.000,00	100	4	8	540.000,00	8
Persona me Invaliditet	2007	200	71.500.000,00	100	276	138	71.500.000,00	100
	2008	200	72.800.000,00	100	112	56	72.800.000,00	100
Persona të Moshuar (55-64 vjet)	2007	-	-	-	-	-	-	-
	2008	150	16.200.000,00	100	142	95	15.336.000,00	95
Gjithsej për subvencionime	2007	800	111.800.000,00	100	348	44	76.338.400,00	68
	2008	600	110.150.000,00	100	338	56	94.436.000,00	86
Gjithsej për Planin Operativ (PO)	2007	8400	297.600.000,00	100	7889	94	265.823.779,00	89
	2008	7165	294.191.921,00	100	6822	95	275.560.821,00	94

Burimi: MPPS, Paraqitja e gjendjes së masave aktive për punësim, buxheti për vitin 2007 dhe rezultatet e arritura, Paraqitja e punësimeve-angazhimeve të planifikuara dhe mjeteve të planifikuara dhe të shpenzuara, nëpërmjet Programeve aktive për punësim, Planit operativ 2008 dhe Planit operativ 2009, MPPS, 28.07.2009, me vërejtje: Programi për punësim të Romëve ne vitin 2008 nuk ka qenë pjesë e Planit operativ. E njëjta gjë vlen edhe për tabelën e viti 2007.

Në vitin 2007, shpenzimet për një person të punësuar kanë qenë: 67,200 denarë për një përdorues nga kategoria Prindër kryefamiljarë; 67,200 denarë për një përdorues nga kategoria Fëmijë pa prindër dhe 267,790 denarë për një përdorues nga kategoria Persona me invaliditet.

Në vitin 2008 është realizuar me sukses masa e re për punësim të personave të moshuar (në moshë 55-64 vjet). Në vitin në fjalë janë realizuar 95% të punësimeve të

personave të moshuar, ndërsa masat për prindërit kryefamiljarë dhe fëmijët pa prindër kanë shënuar realizim më të madh (40% dhe 8%), krahasuar me vitin e kaluar, por të njëjtat janë larg realizimit të planifikuar. Masa për subvencionim të personave me invaliditet, sipas numrit të punësimeve të realizuara, nuk e arriti nivelin e planifikuar pro nga aspekti i mjeteve financiare e tejkaloi të njëjtin.

Gjatë këtij viti, shpenzimet për një persona kanë qenë: për prindërit kryefamiljarë 72.000,00 -12.000,00 denarë në muaj për 6 muaj; për fëmijët pa prindër 135.000,00 -15.000,00 denarë në muaj për 9 muaj, për personat me invaliditet 616.118,00 denarë në muaj, ndërsa për personat në moshën 55-64 vjeçare kanë qenë 110.000,00-12.000,00 denarë në muaj për 9 muaj për çdo përdorues. Shuma e përgjithshme për prindërit kryefamiljarë është më e vogël, krahasuar me kategoritë e tjera, edhe pse ato kanë shpenzime më të mëdha gjatë inkuadrimin në tregun e punës. Gjendja e tillë është si rezultat i kohëzgjatjes së subvencionimit për rrogë, i cili arrin në 12.000,00 për 6 muaj, në dallim nga kategoritë e tjera, siç janë fëmijët pa prindër, të cilët subvencionohen me 15.000,00 për 9 muaj, personat në moshë 55-64 vjeçare, të cilët subvencionohen me 12.000,00 denarë për 9 muaj dhe personat me invaliditet. Ndoshta dallimi në shumën dhe në kohën e subvencionimit është arsyeja për interesimin e vogël dhe prandaj subvencionimi nuk është motivues për punëdhënësit, as për prindërit kryefamiljarë, si përdorues të Fondit.

Në vitin 2008, mjetet e Programit për subvencionim kanë shënuar një rritje të vogël, ndërsa është rritur edhe shfrytëzimi i tyre, i cili ka arritur në 95 %, e dhënë e cila flet për stabilitetin dhe perspektivën e Programit.

Për sa u përket mjeteve buxhetore, të parapara me këtë program, mund të theksohet suksesi i Programit në tërësi, nëse mjetet financiare do të rindahen në kuadër të grupeve qëllimore. Është e qartë se masa për personat me invaliditet është më e suksesshme për shkak të përvojës më të gjatë dhe mënyrës së paraqitjes për përdorimin e të njëjtës. E njëjta gjë mund të konstatohet për grupin e personave në moshën 55-64 vjeçare. Por, për prindërit kryefamiljarë dhe për fëmijët pa prindër duhet të sigurohet bashkëpunim më i mirë midis të gjitha institucioneve relevante që e implementojnë Programin: Agjencia e punësimit, sidomos Qendrat e punëve sociale dhe punëdhënësit. Kreatorët e politikave duhet të gjejnë mënyrë, nëpërmjet të cilës do të motivohen për sa më shumë punësime.

E dhëna e APRM për personat e evidentuar si të papunë në vitet 2007, 2008 dhe 2009 tregojnë se 80% prej tyre ose 277360 persona në mënyrë aktive kanë kërkuar punë (ndërsa 20% të personave të evidentuar si të papunë janë paraqitur nga nevoja për të fituar ndonjë lloj beneficioni, siç është sigurimi shëndetësor, për të cilin si kusht është paraparë që personi të jetë i evidentuar si i papunë)⁶⁴.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- ◆ Analiza e Programit për subvencionim të grupeve të rrezikuara nga aspekti social është me rëndësi të madhe për zgjidhjen e problemeve ekzistenciale të personave dhe familjeve të tyre dhe për integrimin e tyre në tregun e punës. Prandaj rekomandohen edhe aksese dhe beneficione të veçanta për punëdhënësit. Interesi dhe përpjekjet duhen të jenë më të mëdha ndaj punëdhënësve, që ato të sigurojnë më shumë punësime. Në fakt, ato janë realizuesit e politikës, ndërsa

64 Paraqitja e personave të papunë, të evidentuar në Agjencinë e punësimit të Republikës së Maqedonisë, persona të evidentuar si të papunë nga 01.01.2007 deri në 31.12.2007; 01.01.2007 deri në 31.12.2008 dhe në fund të muajit prill të vitit 2009.

vendi, nëpërmjet tyre ndikon në përmirësimin e gjendjes së punësimit të personave me nevoja të veçanta dhe atyre që janë të rrezikuara nga aspekti social. Në vitin 2009, me ndryshimet në Planin operativ për vitin 2009, falë beneficioneve më të mëdha, u evidentua interes më i madh tek punëdhënësit.

- ◆ Mangësi paraqet pamundësia për vëzhgim të të gjitha procedurave dhe implementimi i tyre.
Prandaj rekomandohet që për çdo masë të ndërmarrë të regjistrohet gjendja që të bëhet i mundur detektimi i pengesave gjatë realizimit të masave.
Rekomandohet dhe sugjerohet rëndësia e aspektit gjinor dhe të përfshirjes së tij në të gjitha fazat e sjelljes së politikave, në realizimin e tyre dhe kontrollimin, sidomos për grupet e rrezikuara të popullatës, të cilat me çështjet e zgjidhura ekzistenciale mund të organizojnë një jetë më dinjitoze, duke dhënë kontribut për shoqërinë dhe njëkohësisht pa shkaktuar shpenzime të mëtejshme. Deri më tani dihet se grupe më kritike janë gratë dhe fëmijët, të cilët gëzojnë mbrojtje të veçantë ligjore, të garantuar në Kushtetutë.
- ◆ Duhet bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për inkuadrimin e perspektivës gjinore në politikat aktive për punësim, me qëllim që të sigurohen mekanizma për aksesin gjinor dhe për avancim të perspektivës gjinore, sidomos kur ato realizohen në nivel institucional.
- ◆ Rekomandohet të bëhet evoluim pas realizimit të Programit, me qëllim që të mënjanohej mangësitë dhe realizim të analizave për përdoruesit, lidhur me eksperiencat e tyre që kanë të bëjnë me paraqitjen, njohjen, inkuadrimin dhe me vështirësitë gjatë përdorimit të programeve.
- ◆ Për Programet e dedikuara për grupet kritike të popullatës, prindërit kryefamiljar dhe fëmijët pa prindër, rekomandohet të realizohet bashkëpunim intensiv midis të gjitha institucioneve relevante që e implementojnë programin, sidomos bashkëpunim midis Qendrave të punëve sociale, të cilat edhe më parë janë marrë me grupet kritike të popullatës dhe të sigurohet mundësi maksimale për grupet kritike që ato të kenë përparësi gjatë përdorimit të Programeve të këtylla.
- ◆ Në këtë drejtim është edhe rekomandimi që mjetet dhe kushtet të barazohen për të gjitha grupet qëllimore ose të shpjegohet dhe argumentohet shuma dhe perioda më e vogël e subvencionimit të disa grupeve, siç janë prindërit kryefamiljarë.
- ◆ Aksesin ndaj punëdhënësve duhet të jetë adekuat, që të rritet interesi i tyre për punësime në bazë të perspektivës gjinore. Rekomandohet të mendohet në drejtim të rrethanave lehtësuese lidhur me punësimin e grupeve kritike dhe me motivimin e veçantë të aksesit gjinor, si për shembull fitimi i pikave plotësuese ose dhënia e përparësisë gjatë zgjedhjes së punëdhënësve, kur behet fjalë për punësimin e subvencionuar, në rast të punësimit të grave.
- ◆ Në veçanti rekomandojmë bashkëpunim intensiv midis të gjitha institucioneve relevante që e implementojnë Programin: Agjencia e punësimit, sidomos Qendrat e punëve sociale dhe punëdhënësit. Këto krijues të politikave të gjejnë mënyrë, që me anë të ndihmës së shërbimeve profesionale, praktikave pozitive të vendeve me eksperiencë të ndryshme dhe nëpërmjet njohurive të tjera relevante, të motivohen për sa më shumë punësime.

5.4 PROGRAMI PËR PËRGATITJE PËR PUNËSIM

Emri i programit:

Program për përgatitje për punësim (për vitet 2007 dhe 2008).

Institucioni kompetent për realizimin e projektit

Ajencia e punësimit të Republikës së Maqedonisë (APRM)

Qëllimet (qëllimet eksplicite dhe implicite):

Qëllimet e Programit për përgatitje për punësim janë drejtuar ndaj përmirësimit të konkurrencës së personave të papunësuar në tregun e punës, nëpërmjet trajnimeve, rikualifikimeve ose kualifikimeve dhe këshillimeve.

Përshkrim i shkurtër

Trajnimet, rikualifikimet ose kualifikimet e personave të papunë realizohen kur është i njohur punëdhënësi, i cili e ka konstatuar nevojën për persona me profesione dhe kualifikime të caktuara.

Masat e këtij Programi realizohen nëpërmjet: trajnimeve, rikualifikimeve dhe kualifikimeve për punëdhënësin e njohur; trajnimeve në Klube pune, në të cilat fitohen njohuritë dhe mjeshtëritë (gjuhët e huaja dhe kompjuterët); pilot projekteve për trajnime për mjeshtëri dhe njohuri të cilat janë deficitare në tregun e punës, edukimeve për fillim të biznesit.

Grupet qëllimore

Personat e evidentuar si të papunë.

Aktivitete dhe masa

Aktivitetet dhe masat për përkrahje të këtij programi janë përshkruar në detaje në Planet operative për vitet 2007, 2008 dhe 2009. Në Planet janë paraparë edhe procedurat dhe mënyrat nëpërmjet të cilave përdoruesit inkuadrohen në këto masa.

ANALIZA GJINORE E PROCESVE DHE BUXHETEVE

Tregu i punës në Republikën e Maqedonisë, në pjesën më të madhe të hulumtimeve, duke i përfshirë edhe ato të APRM, është karakterizuar si joprofesional dhe jo konkurrentë, ndërsa struktura e personave të evidentuar si të papunë, sipas shkallës së arsimit, karakterizohet si e pakualifikuar dhe gjysmë e kualifikuar.

Të dhënat e fundit të provimeve të pjekurisë, të realizuara në Republikën e Maqedonisë gjatë vitit 2009, tregojnë për sistemin e dobët të arsimit formal, në të cilin ekziston disparitet i madh lidhur me rajonet dhe zonat urbane dhe suburbane.

Arsimi joformal dhe arsimit i të rriturve akoma nuk është inkuadruar tërësisht në sistemin arsimor të Republikës së Maqedonisë dhe as në vetëdijen e qytetarëve, në mase e cila do të siguronte plotësim të standardeve evropiane. Qendra për arsim dhe trajnim profesional (QATP), e cila duhet të jetë një nga institucionet kryesorë në këtë sferë, akoma nuk është funksionale në tërësi. Edhe pse roli i saj është që të përgatis programe në përputhje me nevojat e tregut të punës, lidhja midis Ministrisë, QATP dhe APRM në përgatitjen e Programeve dhe Planeve për trajnime në pjesën e Politikave aktive për punësim dhe më gjërë, është shume e dobët.

Edhe raporti i fundit i Komisionit Evropian⁶⁵ e thekson mungesën e Planit për arsim dhe aftësim profesional, i cili do t'i pasqyroste në mënyrë adekuate kushtet e tregut të punës.

Nga analizimi i dokumenteve dhe raporteve që ofrojnë numër të kufizuar të

65 Raporti lidhur me përparimin e RM-së

dhënash, mund të konstatojmë se Programet për përgatitje për punësim përbëhen nga trajnime për kualifikim dhe rikualifikim, për punëdhënësit e njohur ose të panjohur, trajnime për aftësim (gjuha angleze dhe kompjuterët) dhe nga trajnimet pilot për profesionet që janë deficitare në tregun e punës. Me këto trajnime, janë përfshirë personat e regjistruar në APRM.

Trajnimet e definuara në këtë mënyrë nuk i detektojnë pabarazitë gjinore dhe nuk sigurojnë mënyra nëpërmjet të cilave popullata joaktive do të inkurajohet që të inkuadrohet në tregun e punës.

Trajnime për rikualifikim ose kualifikim për punëdhënësit të njohur

Trajnimi për rikualifikim ose për kualifikim për punëdhënësit e njohur realizohet nëpërmjet participimit mujor në shpenzimet e punëdhënësit, në shumë prej 2.000,00 denarë dhe nëpërmjet ndihmave në të holla për personat e papunësuar, në shumë prej 4.000,00 denarë për afat 3-mujor. Në raste të tilla punëdhënësi ka për detyrë që personin e trajnuar ta mbaj në punë një vit.

Sipas të dhënave të APRM, në Program janë përfshirë 2.543 persona, 1.829 ose 72% prej të cilëve kanë themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar.

Megjithatë, në asnjë Raport të APRM nuk mund të konstatojmë se për çfarë lloj trajnimi, rikualifikimi ose kualifikimi bëhet fjalë, për cilat sfera bëhen trajnimet dhe as të dhënat të ndara sipas gjinisë, profesionit, përbërjes etnike ose rajonit.

Nuk arritëm të fitojmë të dhëna se sa persona të punësuar gjatë vitit 2007 e kanë vazhduar punën dhe sa persona të trajnuar, rikualifikuar ose të kualifikuar kanë rezistuar në tregun e punës.

Trajnime në Klubet punuese për fitim të njohurive dhe aftësive (gjuhë të huaja dhe kompjuterë)

Me këtë Program realizohen trajnime për fitim të aftësive të gjuhës angleze dhe kompjuterëve.

Në bazë të interesit dhe inkuadrimit të përdoruesve, mund të konstatojmë se ekziston interes për këto trajnime.

Me rëndësi është e dhëna se pas përfundimit të trajnimeve janë punësuar 13,6% të personave të trajnuar, 11,7% të të cilëve janë gra.

Trajnimi pilot për profesione dhe aftësime të caktuara, të cilat janë deficitare në tregun e punës.

Me këtë masë sigurohet trajnimi i 108 personave për profesionet në vijim: elektroinstalues dhe elektromontues, instalues dhe mirëmbajtës të instalimeve për furnizim me gaz dhe me ujë, servisues dhe mekanik dhe saldatorë.

Buxheti i përgjithshëm për realizim të këtyre trajnimeve arrin në 5.313.600,00 denarë ose 86.681,00 euro. Nga ky buxhet në vitin 2008 janë realizuar 2.952.000,00 denarë. Në Programin për trajnim nuk është inkuadruar asnjë grua.

Analizimi i nevojave të tregut të punës për vitet 2007 dhe 2008 i prezanton trendet dhe nevojat për fuqi punuese në Republikën e Maqedonisë, në sfera të caktuara, duke i përfshirë edhe profilet e kuadrove deficitare në veprimtaritë në të cilat ka më shumë nevojë për fuqi punuese–industrinë e përpunimit.

Këtu janë përmendur teknikët e konfeksioneve, teknikët grafik, teknikët për përpunim të drurit, rrobaqepësit e lëkurës, këpucarët, muratorët, punonjësit për armatura dhe saldatorët, rrobaqepësit e konfeksioneve të lehta dhe të rënda, punonjësit

e vreshtave, përpunuesit e frutave dhe perimeve, në varësi të përgatitjes profesionale dhe shkallës së arsimit⁶⁶.

Nuk arritëm të fitojmë dhëna të detajuara për shkaqet e zgjedhjes së këtyre profesioneve si deficitare në tregun e punës, të cilët propozohen në masat e Politikave aktive për punësim dhe për mënyrën e inkurajimit të grave, për t'u inkuadruar në veprimtaritë në të cilat janë pak të pranishme (sipas dokumenteve të Programeve).

ANALIZA E BUXHETIT

Për shkak të mungesës së të dhënave, nuk mund të ofrohet paraqitje tabelare të buxhetit dhe paraqitje të shpenzimeve për vitin 2007, as të dhëna të ndara sipas gjinisë.

Paraqitja e buxhetit dhe shfrytëzimi i mjeteve për trajnime, kualifikime dhe rikualifikime gjatë vitit 2008 (Tabela nr. 24), i tregon arritjet solide në këtë segment, ndërsa pjesëmarrja e grave në këto masa është e madhe, rreth 80% në kualifikimet dhe rikualifikimet dhe në trajnimet për gjuhë të huaja dhe kompjuterë.

Akoma nuk janë hulumtuar arsytet për interesin e këtyre dhe efektet afatgjata të zbatimit të këtyre masave.

Tabela 24. Paraqitja e buxhetit të vitit 2008. Ndarja sipas gjinive

	Nr. i përdoruesve	Nr. i grave	Nr. i burrave	% e grave	% e burrave
Programi për përgatitje për punësim					
1. Trajnime, rikualifikime ose kualifikime të personave të papunë për punëdhënës të njohur	2543	2020	523	79,43	20,57
Trajnime në Klubet punuese për të fituar njohuri dhe aftësi (gjuhë të huaja dhe kompjuterë)	2278	1603	675	70,37	29,63
Trajnime pilot për profesione dhe aftësime të caktuara, të cilat janë deficitare në tregun e punës	60	0	60	0	100

Burimi: APRM

Tabela 25. Paraqitja e shpenzimeve të buxhetit të vitit 2008

	Buxheti	Nr. i përdoruesve	Shpenzimet për njësi	Ndarja e buxhetit
Programi për përgatitje për punësim				
1. Trajnime, rikualifikime ose kualifikime të personave të papunë për punëdhënës të njohur	45.774.000,00	2543	18.000,00	36.360.000,00 gra 9.414.000,00 burra
Trajnime në Klubet punuese për të fituar njohuri dhe aftësi (gjuhë të huaja dhe kompjuterë)	1.900.000,00	2287	830,00	1.337.006,15 gra 562.993,85 burra
Trajnime pilot për profesione dhe aftësime të caktuara, të cilat janë deficitare në tregun e punës	2.952.000,00	60	49.200,00	0 gra 2.952.000,00 burra

Burimi: APRM

Nga ana tjetër, analiza buxhetore-gjinore tregon se një pjesë e konsiderueshme e mjeteve financiare (mjetet e ndara sipas përdoruesve), të dedikuara për trajnime në

⁶⁶ Raporti nacional i analizimit të nevojave për profesione në tregun e punës të Republikës së Maqedonisë për vitin 2008, APRM, Shkup, qershor, viti 2008

të cilat është inkuadruar një numër i madh grave, është shumë më e vogël, krahasuar me masat e tjera.

Nga masat për vetëpunësim mund të konstatojmë se, atje ku vlera e trajnimit është më e vogël, siç është rasti me trajnimin për 860 denarë për çdo pjesëmarrës, dominojnë gratë. Atje ku vlera e trajnimit për çdo përdorues është shumë më e madhe, si për shembull 193.738,00 denarë, në rastin e masës së vetëpunësimit ose të formalizimit të bizneseve, dominojnë burrat. E njëjta gjë vlen edhe në sferën e punëve publike lokale (20.516,00 për përdorues), në sferën e realizimit të punëve ndërtimore dhe projekteve ekologjike (47.542,00 denarë për përdorues) dhe për trajnimet për kualifikime deficitare (49.200,00 denarë për përdorues).

Me rikualifikimet dhe kualifikimet, për të cilat shpenzimet për një pjesëmarrës janë 18.000,00 denarë, janë përfshirë më shumë gra. Megjithatë, informata analitike rreth realizimit efektiv të programeve për trajnim, kualifikim dhe rikualifikim dhe rreth efekteve afatgjata të masës, nuk arritëm të fitojmë.

Së fundi, për shkak të mungesës së informatave, nuk mund të ofrojmë paraqitje tabelare të shpenzimeve të ndara sipas gjinisë, për të gjitha programet dhe masat. Megjithatë, jemi të mendimit se është me rëndësi të theksojmë disa konstatime kryesore të analizës së buxheteve të masave nga Politikat aktive për punësim dhe masave që janë objekt direkt i analizës.

Me masën 1, *Punët publike*, të programeve aktive për punësim, si ndihmë për njësitë e vetëqeverisjes lokale në vitin 2007 është paraparë pagimi i mjeteve për angazhim në punë të personave në gjithsej 51 projekte të realizuara në njësitë e vetëqeverisjes lokale. Me këtë masë janë realizuar 965 punësime afatshkurtra dhe është realizuar buxheti në shumë prej 19.797,915 denarë. Shifrat e atilla nënkuptojnë se çdo person i angazhuar mesatarisht ka fituar nga 20.516 denarë.

Edhe masa aktive 3, në vitin 2007 parasheh angazhim të personave të papunë të rajoneve më pak të zhvilluara, në realizimin e punëve ndërtimore, projekteve ekologjike etj. Me këtë masë janë përfshirë 419 persona të papunësuar dhe është realizuar buxhet në shumë prej 19.920.000,00 denarë ose çdo person i angazhuar mesatarisht ka fituar nga 47.542,00 denarë.

Sipas llojit të punëve, të realizuara në infrastrukturën, pastrimin e rrjeteve të kanalizimit, pyllëzimin, rekonstruktimin e ujësjellësve, shtrimin e sipërfaqeve me pllaka, ndërtimin e rrugicave etj. dhe për shkak të mungesës së të dhënave, vetëm mund të supozojmë se përdorues të mjeteve kryesisht janë burrat. Edhe nëse supozimi ynë nuk do të jetë i saktë, përqindja e pjesëmarrjes së grave mund të jetë e vogël. Prandaj, sugjerojmë që në përgatitjen e programeve dhe masave për punësim, në rastin konkret lidhur me punët publike, rëndësi u duhet kushtuar çështjeve gjinore dhe mundësive për përkrahje të punëve që nuk kanë të bëjnë vetëm me infrastrukturën. Gjithashtu, sugjerojmë që rëndësi t'u kushtohet edhe programeve në të cilat mund të përfshihen edhe gratë (për shembull, kujdesi për personat e moshuar etj.)

Ky sugjerim është me rëndësi të madhe nga aspekti i implementimi i masës së ngjashme në vitin 2009, me buxhet të përgjithshëm prej 228,980.000 denarë.

Së fundi, këto sugjerime kanë për qëllim të hapin debate dhe ta inkurajojnë vetëdijen për ndarje të mjeteve dhe buxheteve midis grave dhe burrave. Gjithashtu, këto sugjerime kanë për qëllim të hapin debate edhe për ndarje të drejtë të mjeteve financiare edhe gjatë proceseve të planifikimit dhe realizimit të politikave.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- ◆ Institucionet kanë përgjegjësi dhe detyrim të madh për t'i përmirësuar sistemet e arsimit formal, arsimit të personave të rritur dhe edukimit të vazhdueshëm profesional. Reformat e fundit në sferën e arsimit dhe implementimi i lëndës së detyrueshme "Biznes dhe sipërmarrje" në programin e arsimit të mesëm, janë me rëndësi të madhe në drejtim të përgatitjes së gjeneratave të reja, lidhur me kërkesat dhe ndryshimet në tregun e punës. Megjithatë, këto përpjekje nuk do t'i tejkalojnë gjendjet aktuale, në të cilat një pjesë e madhe e qytetarëve janë joaktiv, ndërsa pjesa më e madhe e atyre që kërkojnë punë janë të pakualifikuar ose gjysmë të kualifikuar.
- ◆ Institucionet shtetërore, midis të cilave gjenden edhe Qendrat e punësimit dhe Qendrat për arsim të personave të rritur, në bashkëpunim me Qendrat lokale ose rajonale për trajnim dhe/ose Organizatat civile, duhet të fillojnë proces gjithëpërfshirës për edukim, nëpërmjet Programeve adekuate të përshtatura, për përkrahje të grave, të rinjve dhe kategorive të tjera, për t'i aftësuar në drejtim të nevojave të tregut.
- ◆ Konstatimet nëpërmjet hulumtimeve, lidhur me mundësitë dhe pengesat me të cilat ballafaqohen grupet e caktuara, burrat, gratë, të rinjtë (djemtë dhe vajzat) në tregun e punës, duke e përfshirë edhe analizën e nevojave për njohuri dhe aftësi specifike, mund të jenë material i rëndësishëm, nëpërmjet të cilit mund të përshtaten politikat e ardhshme të vendit dhe të merren masa me potencial të madh për transformimin e gjendjes aktuale dhe për integrim më të shpejtë dhe më të lehtë të të rinjve dhe grave në tregun e punës.
- ◆ Nevojitet implementimi i programeve të veçanta për trajnim, këshillim dhe formave të tjera të përkrahjes dhe inkurajimit të grave, që ato të aktivizohen në tregun e punës.
- ◆ Gjithashtu e theksojmë nevojën që të gjitha politikat dhe strategjitë të përmbajnë analizë solide të ndarjes financiare të mjeteve, ndërsa buxhetimi gjinor të bëhet pjesë kryesore e planifikimit, implementimit dhe vëzhgimit të buxheteve të politikave dhe strategjive të vendit. Gjatë ndarjes së mjeteve buxhetore, rëndësi i duhet kushtuar ndarjes së barabartë të mjeteve për përkrahje të kategorive të ndryshme të përdoruesve.

Eksperiencat e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian sugjerojnë akses serioz gjatë realizimit të Programeve nacionale reformuese, të bazuara në Strategjinë evropiane për punësim, në të cilat çështjet gjinore janë në qendër të vëmendjes, ndërsa edukimi paraqet një nga mekanizmat kryesorë për ballafaqim me papunësinë dhe me përjashtimin social të kategorive të caktuara të qytetarëve.

Hungaria, në kuadër të Programeve nacionale reformuese, në pjesën e punësimit dhe integritit të grave në tregun e punës, organizon trajnime dhe shërbime/këshillime, të cilat do t'u ndihmojnë grave të kthehen në tregun e punës si të punësuarat ose si sipërmarrëse.

Qeveria e Suedisë ndan mjete për formimin e rrjetit të ambasadorëve për sipërmarrjen femërore, i cili ka për detyrë që nëpërmjet trajnimeve, konsultimeve dhe prezantimit të eksperiencave individuale, t'i inkurajojnë gratë e tjera të inkuadrohen në tregun e punës.

Sllovenia në programin e saj për promovim të vetëpunësimit dhe sipërmarrjes, parasheh trajnime dhe motivime të sipërmarrëseve potenciale midis studenteve.

Estonia, për ta inkurajuar punësimin midis të rinjve dhe për t'i përmirësuar investimet në kapitalin njerëzor, përgatit Strategji shtatëvjeçare për punësim të të rinjve. Si rezultat i kësaj strategjie zhvillohet programi i quajtur Sistemi i këshillimit për karrierë, në të gjitha komunat e Estonisë. Strategjia parasheh, punë vullnetare dhe pjesëmarrje në edukimin joformal, duke zhvilluar kulturë të sipërmarrjes, punë praktike midis të rinjve dhe ndihmë nëpërmjet edukimit, gjatë zgjedhjes së profesionit të ardhshëm.

PËRMBLEDHJE TË KONSTATIMEVE, KONKLUZIONEVE DHE REKOMANDIMEVE KRYESORE

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe të gjitha institucionet e tjera relevante, të përfshira në procesin e krijimit dhe implementimit të politikave aktive për punësim dhe programeve për ndihmë sociale, demonstrojnë vullnet politik, kuptim dhe gatishmëri për përfshirjen e kategorive dhe përdoruesve të ndryshëm socialë në tregun e punës dhe në atë mënyrë të ndihmojnë në uljen e varfërisë dhe papunësisë, në sigurimin e kohezionit social dhe jetës më të mirë dhe më kualitative për të gjithë.
- Ministria e punës dhe politikës sociale, Sektori për mundësi të barabarta, në drejtim të përkrahjes së politikave, të cilat do ta avancojnë barazinë gjinore, demonstroi gatishmëri të realizoj analizë buxhetore gjinore të politikave (politikat aktive për punësim dhe ndihma sociale) dhe buxheteve të tyre, si hap i parë i një aksesit sistematik drejt çështjeve për barazi dhe për mundësi të njëjta për burrat dhe gratë. E sipërpërmendura paraqet një tregues tjetër se çështjet e barazisë gjinore nuk janë çështje marginale dhe se të njëjtat kanë rëndësi të madhe në krijimin e politikave të mëtejshme.
- Megjithatë, një nga vështirësitë kryesore me të cilat u ballafaquam gjatë analizës buxhetore gjinore të politikave aktive për punësim dhe ndihmës sociale, është mungesa e të dhënave statistikore, të ndara sipas gjinive. Këto të dhëna janë shumë të rëndësishme dhe paraqesin burim informatash për kumtimin e gjendjeve aktuale dhe planifikimin më efikas të aksioneve të ardhshme, kështu që shoqëria më në fund do t'i ndjej përfitimet që rrjedhin nga të njëjtat.

⁶⁷ Programet nacionale reformuese 2008 dhe aspektet gjinore të Strategjisë evropiane për punësim, Komisioni Evropian, Raporti, Mars i vitit 2009.

- Prandaj sugjerojmë se proceset e planifikimit dhe implementimit të politikave, strategjive dhe analizave, si dhe mekanizmat për vëzhgimin dhe vlerësimin e tyre, nuk duhet të jenë neutrale nga aspekti gjinor. Nevojitet që ato të kenë të dhëna statistikore, të ndara sipas gjinive dhe të dhëna të kryqëzuara mbi bazën e parametrave të ndryshme, duke i përfshirë edhe informatat gjinore-analitike të cilat i shpjegojnë dallimet statistikore. Të dhënat statistikore, të ndara dhe të kryqëzuara në mënyrë të tillë, duhet të jenë pjesë rutine e çdo iniciative qeveritare.
- Barazia gjinore është parimi fundamental në Strategjinë evropiane për punësim, postulati kryesor i të cilës është “të tërhiqen sa më shumë njerëz në tregun e punës” dhe të përmirësohet pozita e grupeve dhe individëve, në veçanti të atyre që gjenden në margjinat e tregut të punës. Këto qëllime janë shprehur qartë në të gjitha dokumentet strategjike, programuese dhe operative, në të cilat janë definuar masat dhe aktivitetet e politikave aktive për punësim si dhe kategoritë e përdoruesve—gratë, të rinjtë, personat e papunësuar për një periudhë më të gjatë, përdoruesit e ndihmës në të holla, prindërit kryefamiljar, fëmijët pa prindër, fëmijët me nevoja të veçanta, personat e moshuar etj. Megjithatë, në bazë të analizës buxhetore gjinore të politikave aktive për punësim, mund të konstatojmë se ekzistojnë dallime të konsiderueshme midis planeve ambicioze strategjike dhe zbatimi i tyre në praktikë, lidhur me çështjet e gjinisë dhe prandaj nuk jemi në gjendje ta vërtetojmë sensibilizimin gjinor të masave. Aksesi gjinor është i rastësishëm dhe nuk përkrahët me mekanizma dhe masa plotësuese, duke i përfshirë në këtë kontekst edhe programet ku gratë janë të definuara si grup qëllimor specifik.
Në mungesë të kriterëve thelbësorë, masave inkurajuese dhe mekanizmave të tjera për përkrahje dhe përfshirje të një grupi të caktuar përdoruesish, politikat aktive për punësim nuk do të jenë në gjendje t’i arrijnë qëllimet e dëshiruara, të definuara në dokumentet strategjike.
- Institucionet në të ardhme duhet të përpilojnë metodologji, të cilat do të jenë në favor të qëllimeve dhe grupeve qëllimore, që duam t’i realizojmë dhe të gjejmë mënyra për implementimin e masave provizore dhe mekanizmave të tjera, të cilët do t’i mundësojnë akses më të mirë grupeve qëllimore në masat.
- Një nga aspektet kryesore të përfshirjes së çështjeve gjinore në politikat për punësim është që ato të mos jenë restriktive, por të jenë të hapura për të gjithë qytetarët.
Politikat aktive për punësim e përfshijnë vetëm kategorinë e qytetarëve që janë të regjistruara në APRM dhe të cilët kërkojnë punë. Sugjerojmë për nevojën e hapjes së politikave aktive për punësim edhe për qytetarët joaktiv, si dhe për implementimin e aktiviteteve për inkurajim dhe përfshirje të popullatës joaktive, sidomos gratë në tregun e punës.
- Në procesin e krijimit, implementimit dhe vëzhgimit të politikave aktive për punësim, me rëndësi të madhe është të merren parasysh diskriminimi i dyfishtë dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen gratë e rajoneve rurale dhe të grupeve të ndryshme etnike në tregun e punës.
- Nevojiten hulumtime të mëtejshme për vëzhgimin e punës së bizneseve të legalizuara dhe hulumtime të veçanta për arsyet që e mundësojnë ose e vështirësojnë funksionimin e biznesit, në një afat të gjatë dhe për arsyet e zgjidhjes së përhershme të papunësisë. Këto hulumtime duhet të përfshijnë edhe vlerësimet për efektet dhe ndikimin e politikave, strategjive dhe programeve ndaj burrave dhe grave, grupeve etike dhe sociale, të rinjve dhe kategorive të tjera të përdoruesve, sipas gjinisë.

- Duke e pasur parasysh faktin se politikat aktive për punësim duhet t'u mundësojnë integrim sa më të shpejtë në tregun e punës edhe përdoruesve të ndihmës në të holla, nevojitet bashkëpunim dhe koordinim të të gjithë institucioneve kompetente, që janë të përfshira në këtë proces, që të mundësohet akses i balancuar për angazhim në punë për si për gratë ashtu edhe për burrat.
- Ndihma sociale është aspekt shumë i rëndësishëm në sistemin e ndihmës sociale, nëpërmjet të cilit shteti e shpreh kujdesin dhe ndihmën për kategoritë më të rrezikuara të qytetarëve. Megjithatë, në pjesën e ndihmës sociale, nuk janë marrë parasysh në mënyrë të mjaftueshme prioritetet dhe interesat e ndryshme të grave dhe burrave, të cilat kanë implikime të mëdha ndaj statusin social të qytetarëve. Prandaj, është me rëndësi thelbësore përfshirja e dimensionit gjinor në krijimin, zbatimin dhe vlerësimin e efekteve të politikave për ndihmë sociale, me qëllim që t'i plotësoj nevojat dhe interesat e ndryshme të përdoruesve.
- Personat e përfshirë në krijimin, zbatimin dhe vlerësimin e efekteve nga politikat e ndihmës sociale, dhe në veçanti punonjësit në Qendrat e punëve sociale, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë punojnë me përdoruesit aktual dhe potencial të ndihmës në të holla, duhet të jenë tepër sensitiv për çështjet gjinore tek secilën nga gjashtë kategoritë e ndryshme të përdoruesve. Në këtë drejtim, nevojitet trajnim i kuadrove, i cili do t'i përkushtohet nevojave specifike gjinore, me qëllim që të mundësohet akses i njëjtë deri tek shërbimet si dhe respektim të integritetit të të gjithë përdoruesve.
- Më tej, në kushtet kur potenciali më i madh i Republikës së Maqedonisë është drejtuar ndaj reformave ekonomike dhe zvogëlimit të varfërisë, duhet të gjenden mënyra të tjera alternative që do t'i inkurajojnë iniciativat nga sfera e sipërmarrjes dhe njëkohësisht do t'i inkurajojnë burrat dhe gratë të inkuadrohen sa më shumë në tregun e punës.
- Strategjitë për përkrahje dhe inkurajim të organizatave civile, iniciativave dhe/ose grupeve, misioni kryesor i të cilëve është zvogëlimi i varfërisë, analizat e tregut të punës, trajnimet dhe informimet nga sfera e sipërmarrjes dhe nga sfera të ngjashme, grupet për përkrahje dhe promovim të shembujve pozitiv të grave sipërmarrëse, këshillimet dhe krijimi i rrjeteve, mund të japin kontribut të madh drejt zhvillimit të shoqërisë në tërësi.
- Dhe së fundi, buxhetimi gjinor patjetër duhet të bëhet pjesë kryesore e planifikimit, implementimit dhe vëzhgimit të politikave dhe strategjive të shtetit, me analizë solide të ndarjes së mjeteve financiare, në mënyrë e cila do të mundësoj që ndarja e mjeteve buxhetore të jetë e barabartë për përdoruesit e kategorive të ndryshme.

BIBLIOGRAFI

1. *A learning Programme in Action: Unifem Gender Responsive Budgeting Programme Mid-term Review Summary Report*, February 2004,
2. Budlender.D., and Heëtt.G., *Engendering Budgets: A Practitioners Guide to Understanding and Implementing Gender-Responsive Budgets*, <http://www.gender-budgets.org-content-vieë-165-153->
3. Behner J. dhe Bianima V., *Parlamenti, Buxheti dhe gjinia, Doracak për deputetët*, IPU, UNDP, VBI, UNIFEM, Shkup, 2009.
4. *Gender Budgeting*, Directorate General of Human Rights, Strasbourg, 2005.
5. *Gender Mainstreaming Manual, A book of practical methods*
6. *from the Swedish Gender Mainstreaming Support Committee (JämStöd)*, Ann Boman Committee Chair, -Ulrika Eklund, Carina Löfgren
<http://www.regeringen.se-content-1-c6-08-19-82-3532cd34.pdf>
7. *Analiza qytetare, Zhvillimi rajonal, pushteti lokal dhe kualiteti i jetesës*, Raport, UNDP, Mars, viti 2009
8. *Burrat dhe gratë në Maqedoni*, Enti shtetëror i statistikave, Shkup, 2008
9. *Ligji i mbrojtjes sociale*, "Gazeta Zyrtare e RM" nr. 50-97
10. *Ligji i Mbrojtjes sociale*, "Gazeta Zyrtare e RM" nr. 79 nga 24 qershor të vitit 2009
11. *Ligji i vetëqeverisjes lokale*, "Gazeta Zyrtare e RM" nr. 5 nga 29.01.2002
12. *Raporti nga realizimi i politikave-masave aktive për punësim nga Plani operativ për politikën aktive për punësim për vitin 2007, të parapara me Programin për punë të Qeverisë së RM-së për vitet 2006-2010*
13. *Raporti për punën e Sektorit për kontroll inspektues rreth zbatimit të ligjeve dhe rregullave të tjera nga sfera e mbrojtjes sociale, në vitin 2008*, MPPS.
14. *Raporti për paralajmërimin në kohë*, UNDP, 2007
15. *Raporti nga Plani operativ për masat aktive për punësim për vitin 2007 dhe suksesi i tyre në vitin 2008, si dhe realizimi i deritanishëm i Planit operativ për programe dhe masa aktive për punësim, për vitin 2008*
16. *Informata për implementimin e Planit operativ për programe dhe masa aktive për punësim, për vitin 2008 dhe udhëzimet për përgatitjen e Planit operativ për programe dhe masa aktive për punësim, për vitin 2009*, janar i vitit 2009, MPPS dhe APRM
17. *Hulumtime dhe analiza, dokumente. Libri 2*, Enti i veprimtarive sociale, Shkup, 2007
18. *Në rrugën drejt BE-së, Kontributi i shoqërisë civile në krijimin e politikave për përfshirje sociale në Republikën e Maqedonisë*, MPPS, Shkup, 2008 Sarraf, *Gender Responsive Government Budgeting*, International Monetary Fund (2003)

19. *Ka rodnom budzetiranju, vodíc*, priredila Tatjana Duric Kuzmanovic Zenske studije i istrazivanja, Futura publikacije, Novi Sad, 2007.
20. *Plani nacional aksionar për punësim 2009-2010*, MPPS
21. *Plani nacional aksionar për barazi gjinore 2007-2012*, Shkup 2007.
22. *Strategjia nacionale për punësim 2010*.
23. *Plani nacional aksionar për punësim 2006-2008*
24. *Plani nacional zhvillues (2007-2009)*
25. *Raporti nacional nga analizimi i nevojave për profesione të ndryshme në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë, APRM, qershor i vitit 2007*
26. *Raporti nacional nga analizimi i nevojave për profesione të ndryshme në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë, APRM, qershor i vitit 2008*.
27. *Plani operativ për programe dhe masa aktive për punësim, për 2008*
28. *Planit operativ për programe dhe masa aktive për punësim, për vitin 2009*.
29. *Programi për punë të Qeverisë së RM-së për vitet 2006-2010*
30. Doracaku i komisioneve për mundësi të barabarta të njëjve të vetëqeverisjes lokale, Misioni vëzhgues i OBSE, Shkup 2007.
31. Puliz.V., *Social Protection and Social Inclusion in the former Yugoslav Republic of Macedonia*, European Commission, Directorate-General for Employment, Social Affairs and Equal Opportunities Unit E2 Manuscript completed in October 2007. Sharp.R., and Vas Dev.S., *Bridging the Gap between Gender Analysis and Gender-Responsive Budgets: Key Lessons from a Pilot Project in the Republic of the Marshall Islands*, Hawke Research Institute, University of South Australia, Magill, South Australia, 2004.
32. *Social Protection and Social Inclusion in the former Yugoslav Republic of Macedonia*, European Commission, Directorate-General for Employment, Social Affairs and Equal Opportunities Unit E2 Manuscript completed in October 2007
33. *Paraqitja statistikore: popullata dhe statistikat sociale, Mbrojtja sociale e fëmijëve, të rinjve dhe personave të rritur në Republikën e 2007-2008*, Enti shtetëror i statistikave, Shkup, tetor i vitit 2008.
34. *Plani strategjik i MPPS*
35. Amsterdam Treaty,1997, mund ta gjeni në faqen e Internetit: www.europa.eu.int/eur-lexh

Përktimi
Ad Verbum

Redaktimi
Ad Verbum

Dizajn dhe përgatitja për shtyp
Van Gog – Studio grafike

Shtypshkronja
Van Gog

CIP–Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

342.722.073.52(497.7)

ANALIZË buxhetore-gjinore e politikave aktive për punësim dhe mbrojtja sociale në RM. – Shkup :
Ministria e punës dhe politikës sociale. 2010.–80 стр. : табели 21 см

Фусноти кон текстот – Библиографија: стр. 79–80

ISBN 978-608-4595-07-6

а) Родова Еднаквост – Финансиски аспекти–Македонија
COBISS.MK – ID 81372938
